GJENDJA AKTUALE E INKLUZIONIT TË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE NË ARSIMÍN FILLOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

(PROJEKTI SHKENCOR - HULUMTUES)

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
Sektori i hulumtimit në arsim



Dhjetor, 2018

Hulumtimi i gjendjes aktuale të inkluzionit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është zbatuar në Programin vjetor për punën e Byrosë së zhvillimit të arsimit për vitin 2018, në fushën e planifikimit të Sektorit të hulumtimit në arsim.

Botues: Byroja e zhvillimit të arsimit

Për botuesin Zeqirija Hasipi, u.d. drejtor

Ekipi hulumtues:

Mr. Snezhana Trpevska, këshilltare në BZHA

Mr. Zhaneta Çonteva, këshilltare në BZHA

Bashkëpunëtor i jashtëm/evaluator:

Prof. dr. Zora Jaçova, Universiteti „Shën Cirili dhe Metodi", Fakulteti Filozofik – Instituti i defektologjisë, Shkup.

Ekipi për përgatitjen e raportit:

Zeqirija Hasipi, u.d. Drejtor në BZHA

Ajshe Ajrullai, udhëheqëse sektori në BZHA

Mr. Snezhana Trpevska, këshilltare në BZHA

Liljana Samarxhiska – Panova, udhëheqëse sektori në BZHA

Mr. Zhaneta Çonteva, këshilltare në BZHA

Përkthim dhe lekturë:

Lumnie Ajdari

Mivedete Mahmuti

Shkup, 2018

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

376-056.26/.36:373.3(497.7)(047.31)

АКТУЕЛНАТА состојба на инклузија на децата со посебни образовни потреби во основното образование во Република Северна Македонија :

(научно-истражувачки проект) / [тим за изработка на извештајот Зеќирија Хасипи ... и др.]. - Скопје : Биро за развој на образованието, 2019. -

225 стр. : табели ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Други автори: Ајше Ајрулаи, Снежана Трпевска, Љиљана Самарџиска-Панова, Жанета Чонтева. - Библиографија: стр. 201-203

ISBN 978-608-206-036-1

1. Хасипи, Зеќирија [автор] 2. Ајрулаи, Ајше [автор] 3. Трпевска, Снежана [автор] 4. Самарџиска-Панова, Љиљана [автор] 5. Чонтева, Жанета [автор]

а) Инклузивно образование - Деца со посебни потреби - Основни училишта - Македонија - Истражувања COBISS.MK-ID 110144778

FALËNDERIM mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional dhe drejtorëve të shkollave fillore të rregullta të cilët dhanë një kontribut të madh dhe na mundësuan mbledhjen e të dhënave të nevojshme për identifikim, elaborim dhe argumentim të përfshierjes së nevojshme problematike në këtë hulumtim.

Secili fëmijë posedon potencial të madh.
Fokusimi i pengesës e përkufizon potencialin e tillë.

PËRMBAJTJA

HYRJE

Hulumtimi i gjendjes aktuale i inkluzionit të fëmijëve me nevoja të veçanata arsimore në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në vendet tjera të Evropës ka dalur nga sfidat me të cilat ballafqohen fëmijët me nevoja të veçanat arsimore, prindërit e tyre, mësimdhënësit dhe të gjithë personat të cilët janë të përfshirë në procesin e arsimit inkluziv. Ishte e domosdoshme që të merren njohuri të argumentuara për përparësitë dhe mungesat e arsimit inkluziv në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa rezultatet e fituara nga hulumtimi, përkatësisht mbikëqyrjet përfundimtare dhe rekomandimet do t'i shërbejnë institucioneve relevante në marrjen dhe realizimin e ndryshimeve sistematike cilësore, në drejtim të përparimit të arsimit inkluziv dhe arsimit cilësor për secilin fëmijë.

Qëllimi i arsimit inkluziv është që secilit fëmijë t'i mundësohet pjesëmarrje aktive në aktivitetet shkollore dhe arritjet e përvojave pozitive përmes arsimit të rregullt

Qëllimi i arsimit inkluziv është që secilit fëmijë t'i mundësohet pjesëmarrje aktive në aktivitetet shkollore dhe arritjet e përvojave pozitive përmes arsimit të rregullt, e me atë edhe përgatitja për jetë dhe realizimi i potencialit të tërësishëm i cili mundëson që secili individ pjesëmarrje të tërësishme në rrjedhat e tërësishme, si anëtar i barabartë i shoqërisë.

Inklulzioni në arsim paraqet proces të reformave në drejtim të modifikimit të përmbajtjeve, metodave, qasjeve dhe strategjive në mësim si dhe ndërmarrja e masave adekuate dhe aktivitetet për shmangien e rëndësishme të pengesave, ekipimi i tërësishëm i shkollave me kuadër adekuat për ndihmën dhe përkrahjen e personave me nevoja të veçanta arsimore, rritja e resurseve të nevojshme dhe ndryshimi i vetëdijes së njerëzve në drejtim të pranimit në esencë të sintagmës se

,,Të gjithë jemi të njëjtë'' por njëkohësisht edhe të ndryshëm''. Në këtë mënyrë të gjithë nxënësit mësojnë bashkërisht,,duke i përfshirë edhe ata me çrregullime të dukshme në zhvillim dhe pavarësisht dallimet në stilin, mënyrën dhe ritmin e mësimit, të fitojnë shërbime efektive arsimore, me ndihmë dhe përkrahje të domosdoshme plotësuese, në klasën adekuate kronologjike që paraqet obligim shoqëror dhe të drejtë natyrore të pashmangshme për këta fëmijë.

Për vetëvlerësim, vlerësim dhe zhvillim të inkluzionit në shkolla përdoret **indeksi i inkluzionit.**[1]

Arsimi inkluziv ju mundëson fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të shkojnë në shkollat më të afërta njëjtë si edhe fëmijët tjerë dhe të jetojnë me familjet e tyre, që është me rëndësi të veçantë për zhvillimin e tyre. Mosrespektimi i një qasje të tillë mund të na shpie në pasoja të mëdha nga vetë pengesa.

Tre grupet kryesore sipas OECD (nxënës me prejardhje të ndryshme, nxënës me pengesa në zhvillim dhe të margjinalizuar apo nxënës ekonomikisht të jofavorizuar) janë të përfshirë në politikat e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me një përjashtim të dukshëm të fëmijëve me pengesa mesatare deri në pengesa të vështira në zhvillim, pothuajse secilës popullatë në shkollat e rregullta proklamohen politika, me të cilët përkrahet përfshierja apo inkluzioni."[2]

Parimi i arsimit për të gjithë e pranon të drejtën e arsimit adekuat në pajtim me mundësinë e fëmijëve dhe të rinjve pavarësisht shkallën e pengesës së tyre apo nevojat e tyre të veçanta arsimore.

1 Indeksi i inkluzionit është fryt i bashkëpunimit ndërmjet Qendrës për studimin e arsimit inkluziv - Bristol, Qendra e nevojave edukative – Mançesteri dhe Qendra e hulumtimit edukativ – Kenterberë. Versioni i parë ka dalë në vitin 2000 dhe është përdorur vetëm në Britaninë e Madhe. Në vitin 2002 është botuar versioni i avancuar në të cilin janë implementuar sugjerimet e dhëna nga shkollat britanike, ku është përdorur Indeksi, ndërsa sot përdoret në disa shtete të botës. Për përdorimin e indeksit për Inkluzionin nuk ka mënyrë të vetme dhe të drejtë. Secila shkollë vetëm e cakton mënyrën me të cilën do ta përdor Indeksin. Ai mundëson inkluzionin e shkollës që të studjohet dhe të zhvillohet në tre dimensione të ndërlidhura ndërmjet veti: krijimi i kulturës inkluzive, krijimi i politikës inkluzive, zhvillimi i praktikës inkluzive.

2 Xhonston K., Miriç S., Llazarus Ш., Arsimi inkluziv në kuadër të shkollës me përmasa të fëmijës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shkup, 2010

Pothuajse në të gjitha vendet e OECD, kryesisht në të gjitha vendet e Evropës Juglindore hasen shkolla të veçanta, paralele të veçanta dhe paralele të rregullta. Në disa vende shumë nga shkollat njëkohësisht janë institucione, por kanë edhe karakter rezidencial (vendosje në konvikte). Në kontinuitet me marrëveshjet ndërkombëtare (si shembull. Salamanka dhe Kreu i Kombeve të Bashkuar për të Drejtat e fëmijës) disa shtete kanë menduar gjëra serioze për zhvillimin e integrimit.

Zbatimi i arsimit inkluziv kërkon forma të domosdoshme në disa nivele në sistem, si dhe përfshierje të gjerë të faktorëve. Këto ndryshime të përfshiera në kornizë juridike nënkuptojnë ndryshime në terminologji, sigurimin e kushteve financiare, por edhe ndryshime në diapazonin dhe llojin e kushteve që e përkrahin arsimin në edukimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve, sigurimin e kushteve adekuate dhe qasjen fizike në shkollë, si dhe në arsimin dhe edukimin parashkollor.



REZYME

Sektori i hulumtimit në arsim në Byronë e zhvillimit të arsimit bën hulumtim për gjendjen aktuale të inkluzionit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Me hulumtim janë të përfshirë gjithsej 367 shkolla fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prej të cilëve në 293 mësimi realizohet në gjuhën maqedonishte ndërsa në 74 shkolla në gjuhën shqipe.

Për hulumtim janë përdorur pyetësor anketues dedikuar për nxënësit, mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Qëllimi i hulumtimit është që të fitohet pasqyrë reale për gjendjen e arsimit inkluziv në shkollat e rregullta fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga aspekti i përfshierjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, resurset momentale për ndihmë dhe përkrahje me të cilët disponon shkolla, trajnimi i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional (pedagogu, psikologu dhe defektologu) për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, puna e ekipit shkollor inkluziv dhe pjesëmarrja e bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve pedagogjik dhe personal në dhënien e ndihmës adekuate dhe përkrhajes së të gjithëve të cilët marrin pjesë në procesin inkluziv (nxënës, mësimdhënës, prindër). Njëherit, të shqyrtohet nevoja e përkufizimit të kompetencave të defektologut/punëtorit profesional dhe defektologut/asistentit pedagogjik, që paraqet risi në konceptin aktual të arsimit inkluziv në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për hulumtim janë përdorur pyetësor anketues dedikuar për nxënësit, mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve që u përgjigjen pyetësorit është 739.

Prej tyre 262 janë mësimdhënës të mësimit klasor, ndërsa 477 janë të mësimit lëndor.

Ekzemplarët nga bashkëpunëtorët profesional që janë përgjigjur pyetësorit është 335 bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prej të cilëve 141 janë pedagogë, 130 psikolog dhe 64 defektolog (edukatorë special dhe rehabilitues).

Në hulumtim janë përmbledhur disa të dhëna të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me sfera të ndryshme të arsimit inkluziv:

- Gjendja numerike e nxënësve me pengesë, me vështirësi në mësim dhe nxënës me prirje, sipas klasëve dhe sipas përkatësisë nacionale.
- Shkalla e inkluzivitetit të shkollave nga aspekti i ekipit funksional shkollor inkluziv me programin e përgatitur dhe planin aksionar të punës, procedura dhe formulari i përgatitjes së planit arsimor individual (PAI), përpunuar procedura për përcjelljen e përparimit/rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual, aftësia e mësimdhënësve për përpilimin e planit individual arsimor dhe qasja diferenciale në punën.
- Roli i asistentëve personal dhe pedagogjik në dhënien e përkrahjes së nxënësve, angazhimi i tyre momental dhe disperzimi në shkolla, profesioni dhe segmentet në të cilët janë të përfshirë për ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.
- Trajnimi i mësimdhënësve të punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nga aspekti i përgatitjes dhe përcjelljes së planit individual arsimor, zbatimi i diferencimit, përshtatja e kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesë, përcjellja e të arriturave të tyre, ndihma dhe përkrahja e asistentëve personal dhe pedagogjik.
- Roli i bashkëpunëtorëve profesional (pedagogu, psikologu dhe defektologu) në ndihmë dhe përkrahje të mësimdhënësve dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në të gjithë segmentet e arsimit inkluziv, përpilimi dhe përcjellja e realizimit të planit individual arsimor, periudha e dhënies përkrahje, llojet e përkrahjes që u jepen nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, llojet e bashkëpunimit me asistentin pedagogjik apo personal.

Në bazë të analizës së të dhënave/ përgjigjeve të marra të nxjerura nga intrumentet e ofruara dhe rezultatet e fituara në vijim, hulumtimi jep raport të detajuar me konkluza dhe rekomandime vijuese për arsimin inkluziv më cilësor.

PJESA I

BAZAT TEORIKE TË HULUMTIMIT

1. ASPEKTI TEORIK I ARSIMIT INKLUZIV

Pikëpamjet aktuale, duke përfshirë qëndrimin e fëmijës në Qendrën e mësimit dhe zhvillimit të mësimit të planeve individuale mësimore, njihen më gjerësisht, por jo çdoherë të zbatuara në praktikë. Mungesa e resurseve, veçanërisht resurset njerëzore dhe materialet mësimore, detektohen si përkufizim serioz i vetëm disa vendeve, kryesisht, kanë siguruar qasje të mirë në teknologjinë informatike, si mjet mësimor.[3]

Duke e pasur parasyshë këtë që theksohet më lartë, arsimi inkluziv nënkupton:

- të gjithë fëmijët të munden të mësojnë dhe të gjithë fëmijëve t'ju mundësohet nevoja e përkrahjes në procesin e mësimit;
- respektin e të gjitha dallimeve ndërmjet fëmijëve sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, gjuhës, pengesës, statusit social;
- ndërtimin e strukturës arsimore, sistemin e metodologjisë që i përmbush nevojat e të gjithë fëmijëve (emocional, fizik, intelektual, social, kreativ etj.);
- adaptimin e strukturave programore përmes përpilimit të planit arsimor individual në pajtim me mundësitë dhe nevojat e fëmijëve;
- ndryshimin e qëndrimeve, sjelljen dhe akomodimin e mjedisit, me intencë për përmbushjen e nevojave të të gjithë fëmijëve;
- promovimi i inkluzionit në shoqërinë më të gjerë;
- zvogëlimi i ekskluzionitluzionit, diskriminimit dhe mosperspektiva;
- mundësia që fëmija të rritet dhe të zhvillohet në mjedisin e vetë biologjik, në familjen e tij dhe në mjedisin e tij të drejtëpërdrejtë (në mjedisn më të ngushtë social);

3 Politikat arsimore për nxënësit me rrezik dhe për ata me nevoja të veçanta në Evropën Juglindore, Organizimi i bashkëpunimit ekonomik dhe zhvillimi (OECD) 2007, faqe. 30,31,33

➔ mundësi që të përmirësohet cilësia e edukimit dhe arsimit për të gjithë fëmijët.

Në punën me fëmijët me nevoja të veçanta, përveç arritjeve të tyre dhe suksesit, me rëndësi të veçantë është kujdesi për shëndetin e tyre, zhvillimin e ndjenjës pozitive, vetëbesimi dhe siguria.

1.1. PENGESAT QË E PENGOJNË QASJEN NË ARSIMIN INKLUZIV TË FËMIJËVE ME PENGESË

- Reyultatet e ulta nga fëmijët me pengesë të cilët janë të përfshirë në arsimin e rregullt.
- Qëndrimet e gabuara dhe stereotypet se inkluzioni do të nxis uljen e cilësisë së arsimit dhe do të ndikojë negativisht te nxënësit tjerë.
- Mungesa e resurseve të të gjithë niveleve, si dhe kuadri mësimor kompetent për arsimin inkluziv.
- Mekanizma joadekuat për finansim me të cilët do të ishte stimuluar edhe përshtatje adekuate për inkluzionin e fëmijëve me pengesë.
- Koordinimi, përkrahja dhe qëndrueshmëria e pamjaftueshme ndërmjet sektorëve.

1.2. LLOJET E PENGESAVE DHE VËSHTIRËSITË

Sipas definicionit operacional të Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OEDC) janë përcaktuar tre kategori apo grupe të fëmijëve (nxënësve) me nevoja të veçanta arsimore, me rrezik nga ekskurzioni arsimor.

- Kategoria „A / fëmijë (nxënës) **me pengesa** (disabilities, termine të përdorura më herët: hendikep, invaliditet)".
- Kategoria B„ /fëmijë (nxënës) me vështirësi **emocionale - biheviorale** (difficulties)".
- Kategoria „C / fëmijë (nxënës) me kushte **të pavolitshme socio - kulturore** (disadvantages)".

KATEGORIA A / FËMIJË (NXËNËS) ME PENGESA (DISABILITY)

Ata janë nxënës me pengesa të ndryshme:

- çrregullime nga aspekti mjeksor: dëmtime të organeve;
- çrregullime të funksioneve senzore: çrregullimi i të pamurit dhe dëgjimit, çrregullimet senzore etj;
- çrregullimi i funksioneve kognitive, intelektuale, perceptive dhe funksionet e vëmendjes: (të natyrës organike), disfunksione të të folurit, çrregullime perceptive etj.;

- çrregullimi i kontrollit të muskujve, që e pengon interaksionin me mjedisin: paraliza cerebrale, çrregullimet ortopedike dhe dëmtimet, çrregullime të artikulimit të të folurit etj.;
- çrregullimi i shëndetit fizik të cilat e pengojnë metabolizmin dhe shëndetin fizik, për shkak të cilës është i penguar funksionaliteti normal dhe interaksioni me mjedisin.

KATEGORIA B / FËMIJË (NXËNËS) ME VËSHTIRËSI EMOCIONALE - BIHEVIORALE (DIFFICULTIES)

Ata janë nxënës me çrregullime të sjelljes apo me vështirësi emocionale apo specifike në mësim (disleksia, disgrafia dhe diskalkulia).

KATEGORIA C / FËMIJË (NXËNËS) ME KUSHTE TË PAVOLITSHME SOCIO - KULTURORE DISADVANTAGES

Ata janë nxënës me nevoja të veçanta arsimore, apo „nxënës prej kushteve të privimit", ku mungesat dalin së pari nga faktorët deprivues socio – ekonomik, kulturor apo gjuhësor.[4]

Terminologjia që përdoret në Republikën e Maqedonisë së Veriut për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore duhet të jetë në pajtim me propozimin e **Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD),** e cila përdoret në Unionin Evropian dhe ka të bëjë me fëmijët me pengesa dhe vështirësi në zhvillimin e nivelit shkollor.

Arsimi inkluziv si faktor kryesor për realizimin e së drejtës për arsimin e personave me pengesa është caktuar në **Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e personave me pengesa 2008** dhe paraqet dokumentin e parë detyrues ligjor që theksohet në konceptin e arsimit cilësor inkluziv.[5]
Studimi tematik nga viti 2013 i Komesionerit të lartë për të drejtat e njeriut vërteton se vetëm arsimi inkluziv mund t'iu sigurojë arsim cilësor dhe zhvillim shoqëror fëmijëve me pengesa, që garanton të përgjithshmen dhe mosdiskriminimin në realizimin e së drejtës të arsimit.

1.3. DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE TË CILËT E TRAJTOJNË ARSIMIN INKLUZIV

Koncepti i arsimit inkluziv është inkorporuar në disa dokumente të organizatave internacionale si:

- Në **Deklaratën Botërore për Arsim për të gjithë nga Kombet e Bashkuara, miratuar në vitin 1990**, ku promovohen

4 Xhonston K., Miriq S., Llazarus Ш., Arsimi inkluziv në kuadër të shkollave sipas përmasës së fëmijës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2010

5 http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf

parimet themelore të arsimit për të gjithë, ndërsa në njërin prej neneve të saj qëndron: ,,Duhet ndërmarrë hapa me qëllim të sigurohet një qasje e barabartë për secilën kategori të personave me pengesë në zhvillim dhe atë si pjesë përbërëse e sistemit arsimor'' (citat nga: WCEF. World Declaration on Education for All, Inter-Agency Commision for the World Conference on Education for All, 1990).[6]

- **Në nenin 2** të **Konventës së të Drejtave të fëmijës (1989-1993)** është theksuar: „të respektohen dhe të sigurohen të drejtat pa asnjë lloj diskriminimi sa i përket racës, gjinisë, gjuhës, origjinës etnike apo sociale, paaftësia apo status tjetër të fëmijës'' ndërsa në nenin 3 është theksuar se ,,në të gjithë aktivitetet rëndësi primare janë interesat e fëmijës''. **Në nenin 23** nga e njëjta konventë është caktuar: ,,Fëmija me pengesa të ketë qasje më efikase në arsim dhe trajnim'', ndërsa në nenin 28 ,,shtetet anëtare ja pranojnë të drejtën fëmijës për arsim në bazë të mundësive të barabarta''.[7]
- ,,Deklarata Botërore arsim për të gjithë'' është e përcjellur nga ana e Konferencës Botërore për arsim specialistik në Salamanka me çka në Deklaratën e Salamankës (1994) qeveritë e të gjitha vendeve janë të përqëndruara që ta përvetësojnë arsimin inkluziv si ligj apo parim me stë që:
- Secili fëmijë ka të drejtën themelore të arsimit dhe duhet të fitojë mundësi që të arrijë dhe realizojë nivel të pranueshëm të mësimit.
- Secili fëmijë ka karaktersitika unikate, interesa, aftësi dhe nevoja arsimore.
- Sistemi arsimor duhet të mbajë kujdes për llojllojshmërinë e gjerë të këtyre karaktersitikave dhe nevojave.
- Fëmijët me pengesa duhet të kenë qasje në shkollat e rregullta të cilët duhet të sigurojnë mënyra që t'i përmbushin këta nevoja[8].
- **Neni 8 nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e personave me pengesa 2008-2011** ka të bëjë me ,,promovimin e respektit e të drejtave të personave me pengesa, e të gjithë niveleve të sistemit arsimor, duke përfshirë të gjithë fëmijët e moshës më të re'', përderisa në nenin 24 ,,vendet nënshkruese e pranojnë të drejtën e arsimit të këtyre personave pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, sigurojnë sistem të përfshirë të arsimit të të gjithë niveleve dhe mësimin e përjetshëm. Personat me pengesa të kenë qasje në arsimin fillor dhe të mesëm me bazë të njejtë me tjerët në bashkësitë ku jetojnë, riaftësim cilësor dhe pa pagesë riaftësim i arsyeshëm i nevojave individuale, si dhe ta kenë përkrahjen e nevojshme

6 http://www.unesco.org/education/pdf/11_93.pdf

7 Deklarata nga Salamanka, UNESKO, 1994, http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.PDF

8 Deklarata nga Salamanka, UNESKO, 1994, http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.PDF

në kuadër të sistemit të përgjithshëm arsimor, që të thjeshtësohet arsimi i tyre efikas".[9]

- **Në nenin 26 të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut përfshin parimin se** secili ka të drejtë në arsim, ndërsa prindërit kanë të drejtë primare ta zgjedhin llojin e arsimit për fëmijët e tyre.[10]

2. ARSIMI INKLUZIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Arsimi inkluziv në Republikën e Maqedonisë së Veriut është proces i cili ka filluar para dy dekadave dhe në kontinuitet disperzon dhe progreson në tërë sistemin arsimor, me intensitet të fuqishëm në vitet e fundit, madje duke përfshirë një numër të madh fëmijësh me nevoja të veçanta arsimore, në shkollat e rregullta. Është e sigurtë se edukimi dhe arsimi i fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanat arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk bazohet mbi traditën e gjatë.

Në periudhën zhvillimore nga vitet e gjashtëdhjeta në raport me arsimin e përgjithshëm të personave me nevoja të veçanta janë ndërmarë aktivitetet vijuese:

- sipas normativit është rregulluar sistem fleksibil në edukim dhe arsim;
- është krijuar rrjet i institucioneve që i përmbush nevojat e vazhdueshme;
- është caktuar sistem i finansimit;
- është siguruar pasqyrë e detyrueshme ekipore nga komisionet adekuate profesionale nga komisionet adekuate profesionale për secilin fëmijë, para referimit në institucionin adekuat;
- procesi edukativo – arsimor realizohet sipas planeve dhe programeve mësimore të cilat përfshijnë specifika, me çka nuk vë në dyshim qëllimet e përgjithshme arsimore.

9 http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf

10 Univerzalna-deklaracija-za-pravata-na-covekot.pdf

2.1. VENDOSJA NORMATIVE

Aplikimi aktual i konceptit të edukimit dhe arsimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta arsimore është i rregulluar dhe integruar në Ligjin e arsimit fillor, Ligjin e arsimit të mesëm dhe globalisht mund të prezantohet si:

- qëllim përfundimtar i edukimit dhe arsimit të fëmijëve dhe të rinjët me nevoja të veçanta arsimore është e njejtë apo e ngjashme me ata nga ,,popullata e rregullt";
- edukimi dhe arsimi i fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta arsimore është i organizuar në institucione dhe shkolla të ndryshme, si dhe në ,,paralelet e rregullta'' bashkërisht me moshatarët e tyre;
- detyrimi i edukimit dhe arsimit fillor ka të bëjë edhe me fëmijët dhe të rinjët me nevoja të veçanta arsimore, përveç për ata me pengesa mesatare dhe të rënda në zhvillimin psiqik për të cilët është kufizuar procesi edukativo – arsimor, i programuar dhe adaptuar në mundësitë dhe nevojat e tyre individuale;
- planet mësimore dhe programet janë të adaptuara (të modifikuara, të reduktuara, të shkarkuara) në masë të madhe, në pajtim me llojin dhe shkallën e pengesës;
- angazhimi ligjor dhe profesional është që këta nxënës masovisht të arsimohen në vendin ku jetojnë, që nënkupton kushtet të ofrohen afër tyre, ndërsa jo ata te kushtet në rast kur ajo është e mundshme;
- fëmijët me nevoja të veçanta arsimore i kanë të drejtat e barabarta në arsim si të tjerë, në pajtim me mundësitë tjera dhe ato intelektuale, ambicjet dhe interesat.

Një aplikim i tillë i normativit të edukimit dhe arsimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta arsimore është bazë e mire për aftësimin dhe përsosjen e mëtutjeshme.

Gjatë përpilimit të udhëzimeve për përparimin e Konceptit, si baza fillestare meret përvoja e vendeve të zhvilluara në botë, njohuritë më të reja shkencore si dhe rezolucionet e trupave ndërkombëtar dhe organizatave (UNESKO, OKB).

Nga analiza e burimeve të theksuara , ndërsa në bazë të parimeve gjithpërfshirëse mund të projektohen korrnizat konceptuale të edukimit dhe arsimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta arsimore në vendin tone madje, duke e pasur parasyshë në llojin e trendeve botërore dhe proceset evrointegruese.

Lëvizja e inkluzionit bazohet në parimin e individualizimit në planifikimin e mësimit, qasjen në vetë procesin e realizimit, me çka sigurohet zhvillim më optimal në të gjithë sferat për secilin individ.

Në dobi të ringjalljes së demokracisë së përgjithshme dhe humanizmit njëzëri theksohet angazhimi i përgjithshëm për të gjithë, që nënkupton zbatimin e të drejtës fundamentale në arsim. Parimi i arsimit për të gjithë e pranon të drejtën e arsimit adekuat në pajtim me mundësitë e fëmijëve dhe të rinjve pa marrë parasysh shkallën e pengesës së tyre apo nevojat e veçanta arsimore.

Duke e pasur parasyshë se nevojat e veçanta janë të llojit dhe shkallës së ndryshme, angazhimi arsim për të gjithë nuk kupton

përfshierje të sistemit edukativo – arsimor të fëmijëve me pengesa mesatare dhe të vështira në zhvillim, të cilët nuk posedojnë aftësi për mësimin në shkollë. Ajo nuk e përjashton mundësinë dhe nevojën e organizimit të modeleve adekuate të mësimit të posaçëm në funksion të socializimit, ai është detyrim i përgjithshëm ndërsa e drejtë e pacënueshme natyrore.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullativa e inkluzionit me nevoja të veçanta arsimore duhet të bazohet në përvojat pozitive botërore, të adaptuara në kontekstin tonë nacional. Politikat aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut si parim kryesor kanë karakter të inkluzionit dhe me atë nxiten sistemet inkluzive, para së gjithash përvoja dhe mendimi profesional i disa faktorve relevant, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ende është model aktual i kombinuar i arsimit inkluziv, ku përveç shkollave të rregullta funksionojnë edhe shkolla të veçanta fillore, institucione si dhe institucione të specializuara.

Një ndër angazhimet themelore për të cilin sa e më zëshëm dhe me argumentim flitet në literaturën shkencore dhe në të gjithë tubimet shkencore të cilët e trajtojnë këtë problematikë është përfshierje e fëmijëve me pengesa në zhvillim dhe nevoja të veçanta arsimore me trajtim të hershëm dhe arsim dhe edukim parashkollor.

Të bazuarit shkencor të detektimit të hershëm dhe përfshierja e fëmijëve me probleme zhvillimore dhe nevoja të veçanta arsimore të cilët kanë trajtim adekuat dhe forma të organizuara të arsimit dhe edukimit parashkollor, është elaboruar në disa punime shkencore, përderisa praktika atë e ka treguar në teren. Qëllimi i intervenimit (trajtimit) të hershëm shprehet në zhvillimin maksimal dhe shfrytëzimin e potencialeve biopsikologjike në funksion të kompensimit të organit të humbur (aftësi), në periudhën e jetës kur mundet të ndikojë me vendosje. Proceset e kompensimit nuk janë të orientuara në kompensimin e drejtëpërdrejtë të mungesës (që shpeshherë është e pandryshueshme), por në tejkalimin e vështirësive që paraqiten si pasojë e mungesës, përkatësisht substrukturës te disa persona mund të zhvillohet një mekanizëm aq i fuqishëm kompezator, ashtu që bëhet impuls dhe siguron zhvillim.

Duke pasur parasysh lëvizjet dhe gjendjet momentale ekonomike kjo qasje ka zbatim më eksplicit në zgjidhjen e nevojave të veçanta të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta arsimore (mjete, kuadër, financa) që na shpie në kordinim ndërsektorial që është me theks të veçantë edhe në këshillimin në Paris.

Përvoja e deritanishme tregon se është e pamundur të përparojë teoria dhe praktika nëse nuk zbatohen evaluimet e bazuara shkencore në secilin segment të arsimit edhe pse praktikantët paralel nuk aftësohen për transfer të rezultateve të hulumtimit

shkencor në praktikë. Pa atë nuk mundet të pritet ndonjë përparim i rëndësishëm.[11]

Duke e respektuar **parimin arsimi për të gjithë** në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e përcaktuar që t'i përcjell rekomandimet e faktorëve ndërkombëtar për krijimin ,,bota sipas përmasës së fëmijës'', me intencë të mundësojë arsim cilësor për të gjithë fëmijët, kryesisht edhe për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Bazuar në ata nevoja, Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese **e Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si edhe e dokumenteve tjera dhe konventave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Edhe pse angazhimet dhe përpjekjet e të gjithë krijuesve të politikave arsimore dhe participientëve në sistemin arsimor janë evidente, ende është i manifestuar kuptimi i kufizuar për mënyrën e ballafaqimit me çështjet e ndërlidhura me pengesën. Në këtë drejtim ende është aktual **modeli mjekësor** me çka pengesa shihet si gjendje e cila duhet të shërohet, përkundër atij social në përputhje që pengesa është nxitje, iniciativë e proceseve (identifikim, vlerësim, përkrahje) që ndodhin në kontinuitet gjatë vazhdimit të jetës në tërësi dhe për të cilët duhet të kujdeset shoqëria përmes tejkalimit të pengesave me të cilat ballafaqohen personat me pengesa.[12]

11 http://bro.gov.mk/?q=mk/obrazovanie-za-deca-so-posebni-potrebi

12 http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/pravilnicidetska/programa_rano_ucenje_posebni.pdf

2.2. PËRCAKTIMI LIGJOR

Përkrahja ligjore e arsimit inkluziv është i rëndësishëm meqë mundëson siguri për pranimin dhe trajtimin e barabartë të fëmijëve dhe nxënësve, me çka rregulloret e zbatueshme janë adekuate.

Kjo na shpie në domosdoshmërinë e ndryshimeve dhe plotësimin e sistemit arsimor kryesisht rishqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, për ndërtimin e fuqishëm dhe të sigurtë të përshtatur me qasjen inkluzive dhe krijimin e modelit autentik të arsimit inkluziv, tërësisht i orientuar ndaj fëmijëve.

2.3. LIGJET AKTUALE ME TË CILËT RREGULLOHEN SEGMENTE TË CAKTUARA NË ARSIMIN INKLUZIV

Edhe pse në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullativa ligjore nuk është plotësisht e miratuar me aktet ndërkombëtare dhe nuk ka ligj të veçantë i cili ka të bëjë me arsimin inkluziv, nene të caktuara nga dokumente të theksuara ndërkombëtare dhe Konventa janë pjesë përbërëse e Ligjit të arsimit fillor. Nëse bëhet krahasim me politikën arsimore për këta nxënës në vendet e zhvilluara mund të konstatohet, globalisht se disa vendime normative janë identike apo shumë të afërta te ne.

2.3.1 Përmes neneve të caktuar të **Ligjit për arsim fillor** (viti 2002) janë zbatuar parime të rëndësishme dhe vlera të ndërlidhura drejtpërdrejtë me rregullimin e çështjes së inkluzionit, duke përfshirë universalen dhe mosdiskriminimin. Kështu që në **nenin 2** theksohet se ,,Secili fëmijë ka të drejtë për arsim fillor'', ndërsa në **nenin 3** qëndron ajo se ,,roli i arsimit fillor është përfshierja dhe mbajtja kujdes për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanat arsimore. Në **nenin 6** të ligjit të njëjtë është theksuar se nxënësit me nevoja të ndryshme arsimore sigurojnë kushte adekuate për arritjen e arsimit dhe edukimit fillor në shkollat e rregullta edhe në shkollat e veçanta fillore, ndërsa kanë të drejtë dhe me ndihmën indivuaduale për arritjen e edukimit dhe arsimit fillor. Mëtutje, në ligjin e njëjtë në nenin 42 përcaktohet e drejta dhe mundësia në paralelet në të cilat ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore të angazhohet edhe defektologu për punën me këta nxënës, ndërsa në pajtim me nenin 51 prindi ka të drejtë që fëmijën me nevoja të ndryshme arsimore ta regjistroj në shkollë fillore, madje prej këtu del edhe e drejta e fëmijës me nevoja të veçanta arsimore që të pranohet dhe trajtohet në mënyrë të njëjtë me fëmijët tjerë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e caktuara. Në **nenin e 51** është caktuar edhe e drejta për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të cilat regjistrohen në shkollat e rregullta, shkolla të formojë ekip inkluziv (i përbërë nga pedagogu, kryesisht psikologu i shkollës, mësimdhënësi i nxënësit, prindi, kryesisht tutori i nxënësit, defektologu, nëse ka në shkollë dhe sipas nevojës mund të përfshihet edhe mjeku i nxënësit). **Neni 51,** kryesisht i jep të drejtë prindit të fëmijës me nevoja të veçanat arsimore ta regjistrojë në shkollën fillore, përveç në rastet kur nevojat e veçanta të fëmijës janë të tilla, kështu që duhet të përcjell mësim në shkollë të veçantë fillore.

E fundit ende është lëndë e shqyrtimit të institucioneve kompetente. Përderisa, me **nenin 61** parashihet transport pa pagesë për nxënësit me nevoja të veçanat arsimore. Me Ligjin për arsim fillor fëmijët me nevoja të veçanta kanë të drejtë në zgjedhjen e institucionit arsimor në të cilin do të arsimohen. Përfshierja e tyre në sistemin e rregullt arsimor nënkupton inkluzionin e tërësishëm në punën dhe jetën e tërësishme në shkollë.[13]

Në disa nga ligjet, të cilat rregullojnë veprimtari të strukturave të ndryshme të sistemit arsimor, përfshijnë nene që kanë të bëjnë me nevojat arsimore të personave me vështirësi në mësim edhe atë:

2.3.2. Ligji i Byrosë së zhvillimit të arsimit (viti 2006) me të cilin përcaktohen kompetencat e Byrosë së zhvillimit të arsimit si dhe çështje tjera të rëndësisë së zhvillimit dhe avancimit të edukimit dhe arsimit.

13 Ligji për arsim fillor, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015,145/2015, 30/2016,127/2016 и 67/2017

Byroja e zhvillimit të arsimit përveç fushave tjera, është kompetente edhe për përcjelljen/mbykëqyrjen adekuate, hulumtimin dhe avancimin dhe zhvillimin e veprimtarisë edukative arsimore në pjesën e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, me çka në pajtim me nenin 6 të Ligjit të Byrosë së zhvillimit të arsimiti i propozon ministrit të Arsimit dhe Shkencës, plane dhe programe mësimore për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, me çka në pajtim me nenin 13 realizon botimin e tyre. **Në nenin 14** është theksuar se Byroja e zhvillimit të arsimit bën vendosjen e sistemit të informatave dhe bazën e të dhënave për arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.[14]

2.3.3. Në pajtim **me nenin 2** të **Ligjit për inspektim në arsim (viti 2005)** me të cilin rregullohet organizata, kompetencat dhe autorizimet e inspektimit arsimor, që e bën Inspektoriati shtetëror arsimor dhe inspektorët e autorizuar të komunës dhe të Qytetit të Shkupit, mbykëqyrja inspektuese e arsimit, përveç në institucionet arsimore tjera bëhet edhe në institucionet e arsimit dhe aftësimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.[15]

2.3.4. Me ligjin e mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme (viti 2015) rregullohen kushtet për kryerjen e profesionit mësimdhënës në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut (kryesisht edhe për mësimdhënësit të cilët punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore), krijimi i marrëdhënieve të punës, kategoritë e mësimdhënësve detyrat e punës së mësimdhënësve, aftësimi i vazhdueshëm profesional (zhvillimi profesional), përparimi i njohurive (zhvillimi në karrierë) dhe duke zbritur një titull, sidomos edhe për shkollat speciale.[16]

Ligjet e theksuara, nga miratimi i tyre deri më sot rregullisht rishqyrtohen varësisht nga nevojat.

2.4. RREGULLORE

2.4.1. Me **Rregulloren për numrin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në paralelen dhe mënyrën e regjistrimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore** (viti 2017) vërtetohet lloji i pengesës, numri i nxënësve me nevoja të veçaaat arsimore në paralele të veçantë, kryesisht grup mësimor, që është më ndryshe varësisht nga shkalla e llojit të pengesës, numrit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në paralele në shkollë të rregullt fillore dhe mund të sillet më së shumti deri

14 Ligji i Byrosë së zhvillimit të arsimit TEKST I KONSOLIDUAR („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" бр.37/2006; 142/2008; 148/2009,69/2013, 120/2013,148/2013,41/2014dhe 30/2016).

15 LIGJI I INSPEKTIMIT TË ARSIMIT TEKSTI I KONSOLIDUAR („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/2005, 81/2008, 148/2009, 57/2010, 51/2011, 24/2013, 137/2013, 164/2013, 41/2014, 33/2015,145/2015 dhe 30/2016)

16 Ligji i mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme TEKSTI I KONSOLIDUAR („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017)

në dy nxënës, me çka për një nxënës me nevoja të veçanta arsimore i cili përfshihet në paralele, numrin e nxënësve tjerë në paralele zvoglohet për tre nxënës. Përderisa në shkollë ka disa nxënës me nevoja të veçanta arsimore të cilët nuk munden të rradhiten në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, shkolla në mënyrë të barabartë i shpërndan nxënësit në të gjithë paralelet në klasën e njejtë në arsimin fillor. Në pajtim me nenin 5 të rregullores së theksuar, për fëmijën i cili regjistrohet si nxënës me nevoja të veçanta arsimore dërgohet udhëzim dhe mendim për kontrollimin e të pamurit dhe shkallën e pengesës dhe nevojat e veçanta, ndërsa neni 6 ka të bëjë me ekipin inkluziv i cili ka detyrë për mbledhjen e të dhënave për zhvillimin e fëmijës, gjendjen e tij shëndetësore si dhe nevojat e tij të veçanta.

2.4.2. **Sipas Rregullores për kompetencat themelore profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme,** në fushën e inkluzionit arsimor dhe social, nevojitet që mësimdhënësi t'i dijë llojet e vështirësive të ndryshme te nxënësit të cilëve u nevojitet përkrahje plotësuese në arsim, kryesisht nevojat e veçanta arsimore, vështirësitë në mësim dhe mungesat e inicuara nga arsyeja ekonomike.

2.4.3. Në **nenin 1 të Rregullores për kompetencat themelore profesionale sipas fushave të bashkëpunëtorit profesional në shkollat fillore dhe të mesme,** me çka rregullohen kompetencat profesionale themelore sipas fushave të bashkëpunimit profesional në shkollat fillore dhe të mesme, është përfshi përbërja e bashkëpunëtorëve profesional të cilët realizojnë veprimtari edukative – arsimore në arsimin fillor dhe të mesëm, ku është përfshi edhe defektolog si anëtar i barabartë i ekipit. Përfshierja e defektologut si bashkëpunëtor profesional në punën ekipore të shkollës është në drejtim të ndihmës dhe përkrahjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe përparimi i arsimit inkluziv. Në **nenin 44** të kësaj rregullorje në fushën **''Puna me nxënësit''** për bashkëpunëtorin profesional defektologu i përfshirë me tre nën fusha:

- ➔ përkrahja e nxënësve në mësim,
- ➔ përcjellja dhe përkrahja e zhvillimit të nxënësve;
- ➔ orientimi profesional dhe i karierës së nxënësve.

Në **nenin** 45 në fushën **„Puna me mësimdhënësit",** për bashkëpunëtorin profesional defektologun janë të përfshirë dy nënfusha:

- ➔ përkrahja e mësimdhënësve për planifikimin dhe realizimin e procesit edukativ – arsimor dhe vetëevaluimin;
- ➔ përkrahja e mësimdhënësve për punën e nxënësve.

Në **nenin 50** kompetencat themelore profesionale të bashkëpunëtorit profesional defektologut nga nënfusha **„Struktura shkollore dhe organizimi"** kanë të bëjnë me njohuritë dhe shkathtësitë për përcjelljen e mënyrës së udhëheqjes së evidences dhe dokumentacionit pedagogjik për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe propozim

masat për përmirësim. Kompetencat themelore profesionale të bashkëpunëtorit profesional defektologut nga nënfusha ,,Klima shkollore, mjedisi i sigurtë dhe pjesëmarrja demokratike" kanë të bëjnë me njohuritë dhe shkathtësitë për përfshierjen adekuate të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në aktivitetet e bashkësive të nxënësve.

Shkollat mund të përpilojnë edhe akte interne me instruksione më të hollësishme për vërtetimin e të drejtave të planit individual arsimor dhe implementimin e tij.

2.5. DOKUMENTE TJERA

Arsimi inkluziv është i përfshirë edhe në disa dokumente nacionale tona si për shembull:

2.5.1. Në strategjinë nacionale për barazimin e të drejtave të fëmijëve me invaliditet 2010 – 2018 theksohen disa masa të cilat drejtpërdrejtë e përkrahin inkluzionin:

- puna me nxënësit të jetë e individualizuar, e përqëndruar nga defekologët dhe ekipi profesional në shkollë, me çka nevojitet përfshierje e detyrueshme e defektologëve në sistemin e rregullt të arsimit, si dhe në klasët për arsimin në vetëqeverisjen lokale;
- diferencimi dhe individualizimi i mësimit, me çka mundësohet orientimi i nxënësve në pajtim me nevojat dhe aftësitë e tyre;
- të sigurohet trajnim i kuadrit arsimor, drejtorit dhe bashkëpunëtorëve profesional për përkrahjen dhe realizimin e arsimit inkluziv.[17]

2.5.2. Programi nacional për zhvillim të arsimit në Republikën e Maqedonisë (2005-2015) paraqet një hap të madh në përmirësimin e sistemit arsimor për të gjithë nxënësit. Kjo strategji parasheh eliminimin më të shpejtë të pengesave fizike në arsim, uljen e diskriminimit në shkolla (në bazë të gjinisë, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë etnike, përcaktimit nacional apo fetar, rritjen e kujdesit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore atj. Në pjesën 2.7. Inkluzioni dhe participimi arsimor i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore është theksuar se arsimi fillor misionin e vetë mund ta plotësojë në tërësi vetëm nëse i respekton parimet e transparencës ndaj nevojave dhe kushteve të fëmijëve me problem zhvillimor dhe nevoja të veçanta arsimore, në frymën e standardeve dhe konventave ndërkombëtare. Madje, qasja ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në tërësi do t'i respektojë llojin dhe shkallën e pengesave të tyre zhvillimore, në kushtet që do t'i përmbushin dëshirat e fëmijës dhe familjes si dhe kërkesat për zbatimin e vazhdueshëm të parimit të inkluzionit (profesional, kadrovik, përgatitja hapësirnore – teknike e shkollave për pranimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore). [18]

17 Qeveria e RM, Trupi koordinues nacionla për të drejta të barabarta të personave me invaliditet në R.M: Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me invaliditet 2010-2018

18 Programi nacional për zhvillimin e arsimit në

2.5.3. Në **strategjinë Nacionale për deinstitucionalizim, në sistemin e mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë (2008 - 2018)**, theksohet kërkesa në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për krijimin e kushteve të inkluzionit apo përfshierjen e fëmijëve me nevoja të veçanra arsimore në shkollat e rregullta.[19]

2.5.4. Në strategjinë e arsimit viti 2018-2025 si vision i caktuar mund të konsiderohet angazhimi që të sigurohet gjithpërfshierja, arsimi inkluziv dhe i integruar ndaj ,,nxënësit'' me programet bashkëkohore që mundësojnë që gjeneratat e ardhshme të aftësohen me njohuri, shkathtësi dhe kompetenca, në pajtim me nevojat e shoqërisë demokratike multikultuore, tregun e punës dhe sfidat e reja në ambientin global shkencorë – teknologjik.

Ndërmjet qëllimeve të caktuara kryesore për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm është edhe qëllimi për përmirësimin dhe aftësimin e infrastrukturës arsimore, planin mësimor dhe programin si dhe tekstet për nxënësit me aftësi të kufizuara si dhe sigurimi i kompetencave të mësimdhënësve dhe shrëbimit rpofesional të cilët punojnë me nxënësit e këtyre grupeve. Qëllimet e strategjisë për arsim 2018-2025 të cilët kanë të bëjnë me personat me nevoja të veçanat janë të definuara në mënyrën e cila mundëson përshtatjen dhe realizimin e vazhdueshëm të konceptit të arsimit inkluziv dhe multikukturot, me fokus të barazisë gjinore, respektimi i dallimeve me cilën do formë, si dhe me përkrahjen e disa gjuhëve dhe kohezionit etnik, përparimi i strukturës arsimore për shkak të sigurisë (përfshierjes) më të madhe të inkluzionit, efikasitetit energjetik dhe digjitalizimi si dhe të siguruarit e përfshierjes së tërësishme në sistemin arsimor të të gjithë personave me nevoja të veçanta arsimore, përmes përshtatjes së programeve mësimore (nga aspekti i qëllimeve mësimore dhe gjuha e realizimit të mësimit) për nevojat dhe mundësitë e tyre. Në atë drejtim disa nga prioritetet në Strategjinë e arsimit për vitin 2018 – 2025 janë: rritja e përfshierjes së fëmijëve dhe përmirësimi i inkluzionit si dhe integrimi interetnik në arsimin fillor dhe të mesëm.[20]

2.5.5. Indikatorët e cilësisë së punës së shkollave, është dokument i Inspektoriatit shtetëror të arsimit, i cili ka më tepër indikatorë që kanë të bëjnë me arsimin inkluziv[21]

Republikën e Maqedonisë: 2005-2015 / [përpiloi grupi nacional i ekspertëve, ligjërues Tale Keramiçioski]. – Shkup Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë, 2005

19 Strategjia nacionale për deinstitucionalizimin në sistemin e mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë (2008-2018)

20 Strategjia e arsimit viti 2018-2025

21 http://dpi.mon.gov.mk/images/pravilnici/IKRU-MAK.pdf

2.5.6. Në dokument **kompetencat themelore profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme** në lëmin ,,Inkluzioni social dhe arsimor''është dhënë përshkrim i kompetencave që kanë të bëjnë me njohjen e kompetencave të ndryshme dhe modeleve për arsimin inkluziv nga mësimdhënësi, për nxënësit me vështirësi të ndryshme të cilëve u nevojitet përkrahje plotësuese në arsim (nxënës me nevoja të veçanta arsimore, me vështirësi në mësim dhe ngecje në aspektin socio – ekonomik), si dhe të kuptuarit e faktorëve social dhe kulturor si dhe mënyra me të cilën ndikojnë në arsim dhe kohezion social.[22]

2.5.7. Në dokumentin **Kompetencet themelore profesionale dhe standardet për bashkëpunëtorët profesional** të përfshira me kompetencat për arsimin inkluziv në fusha të ndryshme të punës së bashkëpunëtorëve profesional, kurse barazi, inkluzion dhe drejtësi sociale janë njërat nga vlerat me çka udhëhiqen në punën e tyre profesionale.[23]

Korrniza ligjore nacionale si dhe të gjithë dokumentet e theksuara ndërkombëtare që është detyruar Republika e Maqedonisë së Veriut shpiejnë në ekzistimin e mundësive pozitive arsimore për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, me çka ata e kanë të drejtën e njëjtë për arsimin adekuat dhe cilësor si dhe të gjithë të tjerët, me intencë për vënien në funksion të potencialit të përgjithshëm, me të drejtën e zgjedhjes dhe mundësisë për arsim në mjedisin inkluziv, të drejtë në resurset specifike dhe profesionalizëm që t'ju përshtaten nevojave të tyre dhe të drejtë të serviseve që vazhdimisht veprojnë në interesin më të mirë të tyre.

Në atë kontekst, nuk guxon të shmanget roli i shërbimit profesional dhe ekipit inkluziv, të cilët janë me rëndësi të veçantë për zhvillimin e arsimit inkluziv (në përcjelljen, përparimin, adaptimin, mësimin dhe komunikimin, si dhe përkrahja e mësimdhënsëve, nxënësve dhe prindërve).

Në drejtim të progresionit të shpejtë dhe cilësor të procesit inkluziv, vendi ynë duhet të vazhdojë të zhvillojë ligjvënie efektive për të drejtat e fëmijëve me pengesë, në raport me arsimin inkluziv. Kjo legjislativë duhet të zhvillohet dhe rishqyrtohet në pajtim me dispozitat e nenit 24 të Konventës së KB për të drejtat e personave me pengesa.

2.5.8. Aktivitetet për përkrahjen e shkollave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga Byroja e zhvillimit të arsimit dhe UNICEF

Si mënyrë më adekuate për inklinim ndaj standardeve inkluzive botërore dhe entuziazmi në shkolla, me traditë stihike dhe integrimin joorganizues të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, është realizimi i projektit ,,Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Republikën e

22 Rregullore për kompetencat themelore profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme, 2015

23 Kompetencat themelore profesionale dhe standardet e bashkëpunëtorëve profesional, Qendra maqedonase për arsim qytetar, 2016

Maqedonisë''si segment i projektit ,,Nevojat speciale në klasë'' prej vitit 1988, bartës i të cilës është Byroja e zhvillimit të arsimit në Republikën e Maqedonisë. Një dekadë më vonë, në vitin 1998 Byroja e zhvillimit të arsimit me përkrahjen e Zyrës së UNICEF-it e filloi projektin pesëvjeçar ,,Inkluzioni i fëmijëve me nevoja të veçanat arsimore në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë''. [24]

Në kuadër të këtij projekti, ndërsa në pajtim me arritjet shkencore bashkëkohore, termi integrim i fëmijëve me nevoja të veçanat arsimore zëvendësohet me termin inkluzioni i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, formohen ekipet shkollore inkluzive në 54 shkolla fillore dhe 13 kopshte publike për fëmijë dhe ka bashkëpunim me defektologët nga shkollat fillore të veçanta për përpilimin e planit arsimor individual (PAI).

Politikat shtetërore të inkluzionit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ka bërë intenzitet të madh të masave të ndërmarra dhe të realizuara si dhe aktivitete, veçanarisht në disa vite të fundit. Si një nga prioritetet dhe masë mjaft e rëndësishme e përfshierjes së defektologëve si bashkëpunëtor profesional në shkollat e rregullta si dhe angazhimi i asistentëve personal dhe pedagogjik për ndihmë dhe përkrahje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA) që prodhon nevojën e definimit të kompetencave të tyre profesionale.

Prej vitit 2014 Byroja e zhvillimit të arsimit me intensitet më të madh ndërmer aktivitete konkrete për realizimin e politikave shtetërore për inkluzion të grupeve të margjinalizuara të fëmijëve. Në këtë drejtim, Byroja e zhvillimit të arsimit në bashkëpunim me Qendrën maqedonase për Arsim qytetar dhe me përkrahje finansiare të UNICEF- it është e përfshirë në programin ,,Arsimi inkluziv për shkollat fillor'' që është pjesë e programit ,,Shkolla sipas përmasave të fëmijës'' dhe paraqet zgjerimin dhe detajet e programit ,,Matematika me logjikë'' dhe ,,Shkrim – leximi gjuhësor në klasët fillestare'', të cilët me përkrahjen e UNICEF -it realizohen nga viti 2009.

Qëllimi i programit është që të përmirësohet cilësia e mësimit, veçanërisht në njohuritë dhe shkathtësitë themelore në matematikë dhe gjuhë amtare, me theks të veçantë të përkrahjes së mësimit të nxënësve me përkatësi etnike rome dhe të nxënësve me vështirësi të cilët janë të përfshirë në shkollat e rregullta fillore. Programi është i bazuar në:

- Inkluzionin e të gjithë fëmijëve në shkollat/shkollën dhe në sistemin arsimor;
- Zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve për arsimin inkluziv;
- Promovimin e qasjeve në mësim që do të sigurojnë arritje më të larta të nxënësve;
- Siguron përkrahje plotësuese të nxënësve që kanë nevoja/vështirësi të veçanta arsimore;

24 Jaçova 3., L.Samarxhiska - Panova, I.Leshkovski., M.Ivanovska., Doracak për projektin Inkluzioni i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e rregullta në Republikën e Maqedonisë, Byroja e zhvillimit të arsimit Shkup, 2002

- Përdorimi i vlerësimit formativ dhe zhvillimi i botëkuptimit për intelegjencën si ndryshore përmes procesit të mësimit;
- Inkuadrimi i prindërve dhe bashkësisë më të gjerë.

Programi në inicialitetin e tij filloi të realizohet në shtatë shkollat fillore në gjysmën e parë të vitit 2014.

Si rezultatet i trajnimeve vijuese dhe materialeve të fituara manuale, në të gjithë shtatë shkollat ka përmirësim në politikat inkluzive shkollore dhe pratikat.

Në vitin 2015 rrjeti i shkollave fillore të përfshira në programin ,,Arsimi inkluziv për shkollat fillore'' përhapet me përfshierjen e 13 shkollave në të cilat ka edhe fëmijë me vështirësi në mësim, ndërsa në vitin 2017 me 11 shkolla, kështu që në vitin 2017 numri i tyre sillet gjithsej 31 shkolla.

Shkollat që janë të përfshira në programin përmes trajnimit dhe aktiviteteve të ndryshme janë të orientuara kah të kuptuarit më i mirë i arsimit inkluziv si dhe përforcimi i kapaciteteve të shkollave ,,puna me grupe të ndryshme, sigurimi i pjesëmarrjes dhe nxitja në mësim''. Një pjesë e trajnimeve dhe aktiviteteve ka të bëjë edhe me formimin e ekipeve dhe zhvillimi i bashkësive të inkluzionit. Në këto shkolla janë formuar ekipe shkollore inkluzive që kanë arritur me përvojat në punën e tyre dhe janë të përgatitur që t'i ndajnë me shkollat tjera.

Byroja e zhvillimit të arsimit është e përfshirë edh në përpilimin e Programit për zhvillim profesional të mësimdhënësve për arsimin inkluziv e cila përbëhet nga këto module:

- Teoria e konceptit të arsimit inkluziv;
- Identifikimi i fëmijëve të cilët janë jashtë sistemit arsimor;
- Ekipi shkollor për inkluzion;
- Planet individuale arsimore.

Si plotësim, Byroja e zhvillimit të arsimit përmes këshilltarëve të saj jep përkrahje profesionale si mentor në shkolla në procesin e diseminimit të përmbajtjeve të moduleve për ndërtimin e shkollës inkluzive.

Këtë vit Byroja e zhvillimit të arsimit organizoi trajnim për trajnuesit me temë: ,,përforcimi i kapaciteteve të shkollave për arsim inkluziv'', të cilët deri në fund të vitit 2018 duhet të realizojnë trajnim dedikuar mësimdhënësve dhe bashkëpunëtoërve profesional në 20 shkolla fillore, të cilët deri tani nuk anë qenë të përfshira në rrjetin e shkollave inkluzive.

Substrat i aktiviteteve të realizuara për përkrahjen e shkollave në Republikën e Maqedonisë nga Byroja e zhvillimit të arsimit dhe UNICEFIT:

- ➔ Trajnime për parimet themelore dhe modulet për arsim inkluziv në shkollat fillore (20 shkolla fillore). [25]
- ➔ Diseminimi i trajnimeve në shkolla dhe përkrahja e vazhdueshme nga njerëz profesional. [26]

25 Xhonson K., Miriç S., Llazarus Ш., Arsimi inkluziv në kuadër të shkollës me përmasa të fëmijës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2010

26 Убавка Бутлеска ... etj., Doracak për përcjelljen e punës dhe planifikimi i zhvillimit profesional

- Përfshierja e Byrosë së zhvillimit të arsimit dhe Qendrës shtetërore të provimeve për përkrahje dhe përcjellje.
- Studimet e rastit, vlerësimi formativ, hulumtimi aksionar, qasja diferencuese, përkrahja individuale.
- Përqindja e kapaciteteve për shërbimet e sektorëve: shëndetësi, arsim, mbrojtja sociale për përfshierjen e fëmijëve me pengesa.
- Qasjet kryesore nga anketa „Njohuri, qëndrime dhe praktika ndaj fëmijëve me pengesa".
- Hartimi i organizatave, në fushën e pengesës - raporti.
- Raporti nga anketuesit e gjendjes fillestare për arsimin inkluziv.
- Studimet e rastit nga shkollat fillore në programin ,,Arsimi inkluziv" (2012-2014).
- Studimi për arsimin inkluziv – rregullativa ligjore.
- Doracak për arsimin inkluziv për mësimdhënësit, bazuar në tre medule. Praktikum për arsimin inkluziv.
- Doracak për mësimdhënës për vlerësimin formativ të nxënësve me vështirësi në mësim – mësimi klasor.
- Doracak për mësimin diferencial dhe mësimin individual.
- Udhëzim me intrumente për ekipet shkollore inkluzive.
- Doracak me instrumente për bashkëpunëtorët profesional për punën individuale me fëmijët me pengesa.

të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorët profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Qendra maqedonase për arsim qytetar, Shkup, 2016

3. ARSIMI INKLUZIV NË KONTEKSTIN EVROPIAN ARSIMOR

3.1. ARSIMI INKLUZIV NË SUEDI

Kur bëhet fjalë për nxënësit të cilët kanë nevojë për përkrahje të veçantë dhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, sistemi i detyrueshëm suedes arsimor ndonjëherë konsiderohet sis item njëkahësh27. Në analizën e mëtejshme do të merren parasyshë diskutimet kritike të ekspertëve si dhe politikat aktuale dhe praktikat e niveleve të ndryshme të sistemit të detyrueshëm shkollor suedes për këta nxënës.

Analizat e realizuara në nivelin shtetëror theksojnë në një fotografi komplekse të vendosjes dhe realizimit të arsimit inkluziv në nivelin komunal dhe nacional dhe japin disa përfundime:

- politikat shtetërore japin shumë hapësirë për interpretimin e nivelit shkollor komunal që rezulton me variante të mëdha në komuna të ndryshme;
- politika shtetërore suedese nuk është aq inkluzive ashtu siç theksohet shpeshherë;
- supozohet se është vështirë të arrihet identifikimi i dallimeve;
- qëllimet e arritjeve që janë të vendosura mund të jenë ,,thikë me dy teha''kur janë në korrelacion me inkluzionin;

27 https://www.researchgate.net/publication/289912842_Special_Education_Today_in_Sweden

- supozohet se disa nxënës të cilët ndjekin mësimin e rregullt kënaqen me të, që nga perspektiva ndërkombëtare e bën Suedin kryesisht demokratike në atë sferë.

3.1.1. Zhvillimi i inkluzionit

Sistemi arsimor suedes bazohet në filozofinë e nxënësve se nxënësit kanë të drejtë në zhvillim individual dhe mësim[28]. Kjo e drejtë është e theksuar në nenin 1 të Ligjit për arsim[29].

Përfshierja e të gjithë nxënësve sipas këtij parimi është me rëndësi kryesore, ndërsa të drejtat e nxënësve të cilët kanë nevojë nga përkrahja e posaçme nuk hulumtohen në veçanti.

Plani mësimor momental për shkollat e detyrueshme nuk e përdor fjalën apo konceptin inkluzion në politikat kryesore, por e promovon të sipërpërmendurën se të gjithë nxënësit do të shkollohen në paralelet e rregullta apo grupe për kujdesin e fëmijëve. Nëse kjo nuk është e mundshme, atëherë shkolla duhet shumë qartë të tregojë se pse duhet të shqyrtohen mundësitë tjera arsimore të nxënësve. Ky është një qëndrim i rëndësishëm filozofik për organizimin dhe funksionimin e shkollës. Diskutimet paraprake janë qëndrim për organizimin dhe funksionimin e shkollës. Diskutimet paraprake janë të fokusuar në parakushtet për integrim. Tani fokusimi është vendosur në nevojën që të arsyetohen opsionet e ndara që shqyrtohen për nxënësit.

3.1.2. Zgjidhjet lokale për pengesën në mësim

Për nxënësit me vështirësi më të mëdha në mësim ekziston program special - särskola apo në përkthim: pengesa në mësim. Ky program paraprakisht ka qenë përgjegjësi në nivelin rajonal dhe nacional, por nga viti 1996 Pushteti local vetëqeveris përmes këshillave lokal shkollor në secilën komunë dhe fiton përgjegjësi të plotë për realizimin e saj. Programi momentalisht është i lidhur ngusht dhe gjithpërfshirës në aktivitetet e përgjithshme të shkollave.

Nga kuadri kërkohet të bëjnë raport te udhëheqësi në të cilin do të theksohet qartë se do të mundet të pritet që nxënësi të mos I arrijë edhe kërkesat minimale profesionale, që duhet ti përvetësojë në procesin arsimor30.

Për nxënësit të cilët do të kenë nevojë nga përkrahja e veçantë, nevojitet që të përpilohen plane aksionare nga mësimdhënsëit e tyre në konsultim me vetë nxënësit, prindërit e tyre dhe mësimdhënësit si dhe këshilltarët për përkrahje speciale. Këto plane që i identifikojnë nevojat dhe rregullat për plotësimin e tyre, në kontinuitet vlerësohen ndërsa përparimi thekson në ndryshimet

28 https://www.european-agency.org/country-information/sweden

29 https://www.perfar.eu/policy/education/sweden

30 http://www.enil.eu/wp-content/uploads/2012/07/Intellectual-Disability-in-Europe.pdf

eventuale në drejtimet e përcaktuara fillestare. Udhëheqësi i shkollës është përgjegjës për nevojat e veçanat të nxënësit që analizohet menjëher.

3.1.3. Edukimi i mësimdhënësve për përkrahjen e veçantë

Mësimdhënësit për përkrahje të veçantë janë të specializuar në gjashtë drejtime: zhvillimi i gjuhës, shkrimi dhe shkrim-leximi, zhvillimi i matematikës, mosdëgjimi apo dëmtimi i dëgjimit, çrregullimi i të pamurit, çregullimi i gjuhës dhe vështirësitë në mësim. Gjithashtu ekziston pedagog arsimor për përkrahjen e veçantë pa udhëzime konkrete.

3.1.4. Qendrat e burimeve dhe shkollat speciale

Përcaktimi specialistik për mbështetjen e nxënësve me pengesa trupore dhe dëmtim të dëgjimit dhe shikimit ekziston, kryesisht në programet e përgjithshme arsimore, madje në disa raste edhe në kushte të veçanta[31]. Arsimi i përgjithshëm dhe programet mësimore nacionale korrespondojnë sa më shumë që është e mundur për nxënësit të cilët nuk i përkasin personave me aftësi të kufizuara, me theks të përmbushjes së nevojave individuale. Sipas kurrikulumeve nacionale, nxënësit me dëmtim në dëgjim kanë mundësi të komunikojnë edhe në gjuhën suedeze edhe në gjuhën e shenjave, por gjuha e shenjave aplikohet si gjuhë e parë

31 https://www.swselpa.org/

Shteti ofron mbështetje përmes Agjencisë nacionale për arsim me nevoja të veçanta, e cila përfshinë tre skolla nacionale dhe pesë shkolla speciale rajonale.

Shkollat nacionale kujdesen për nxënësit me: dëmtimin e shikimit në kombinim pengesat tjera plotësuese; shurdhër ose dëmtim në dëgjim në kombinim me mangësitë në mësim; çrregullime në të folurit dhe në gjuhë. Shkollat rajonale ofrojnë edukimin e nxënësve të shurdhër ose humbje dëgjimi që korrespondojnë me shkollimin e detyrueshëm. Agjencia nacionale për arsim me nevoja të veçanta, gjithashtu, ka katër qendra burimore nacionale për arritjen e njohurive të specializuara për personat që janë të përfshirë në shkollat nacionale[32]. Qendrat burimore ofrojnë vlerësimin e fëmijëve dhe të rinjve dhe përpilojnë programe për trajnimin e edukatorëve dhe prindërve. Ato janë në një korrelacion të fuqishëm me këshillat e shkollave lokale në përshtatjen e arsimit inkluziv sa më afër nevojave të personave, në pajtim me pengesat e tyre. Nxënësit që janë të verbër ose kanë dëmtime shikimi, por pa dëmtime tjera, që nga viti 1988 ato janë arsimuar në mësimin e rregullt. Mbështetja sigurohet përmes disa qendrave burimore.

3.1.5. Arsimi parashkollor

Të gjitha aktivitetet pedagogjike duhet të jenë të ndërlidhura me nevojat e të gjithë fëmijëve, ndërsa fëmijëve të cilëve iu

32 https://www.spsm.se/om-oss/english/the-swedish-education-system/laws-and-rights-in-swedish-schools/special-needs-education-sne-in-sweden/

nevojitet mbështetje e posaçme duhet ta marrin në grupin për kujdesin e fëmijëve. Ekziston program i ri mësimor për arsimin parashkollor, aplikuar në vitin 1998 si Akt 98, ndërsa është rishqyrtuar në vitin 2010[33]. Një numër i madh i qendrave për mbrojtjen e fëmijëve janë organizuar në grupe prej 15 deri 20 fëmijë me tre punonjës të cilët punojnë me ata, ku fëmijëve të cilëve iu nevojitet ndihmë e posaçme vizitojnë grupin dhe për të njëjtit mund të bëhet një staf shtesë i shpërndarë. Mbrojtja shëndetësore, përkujdesi social, edukimi dhe mësimdhënia janë detyrat kryesore të theksuara në planim mësimor paraprak të pashqyrtuar. Zhvillimi social i fëmijëve bëhet në grupe. Si rezultat i kësaj, grupi ka funksion të rëndësishëm arsimor në përkujdesin e fëmijëve, ku të dyja grupet në veçanti (fëmijët dhe grupi) janë pikat përqëndruese në programet pedagogjike. Dallimi konsiderohet si standard i përgjithshëm në këtë zhvillim shoqëror dhe të gjithë fëmijët aq sa është e mundur, pa marr parasyah nevojat e tyre, duhet të jenë pjesë e grupit të tillë. Për shkak të korrelacionit të fuqishëm ndërmjet institucioneve, në çdo moment të vitit, cili do qoftë fëmijë i moshës parashkollore mund të ndjek mësimin në kohë të caktuar në Agjencinë nacionale për arsim me nevoja të veçanta.

3.1.6. Arsimi fillor i detyrueshëm

Debatet paraprake në fushën e arsimit të detyrueshëm përqendrohen në parakushtet e përfshirjes të aspekteve gjinore në politikat kryesore. Tani përqendrimi është zhvendosur në nevojën e justifikimit në opsionet e ndara të cilat po shqyrtohen për nxënësit. Secila shkollë është e detyruar në përputhje me qëllimet nacionale dhe vlerat kryesore, por është e lirë t'i organizojë mjetet e veta për arritjen e atyre qëllimeve. Secili nxënës duhet t'i arrijë qëllimet në lëndë të caktuar, por mënyrat për arritjen e tyre dhe kohën që e kalon, mund të ndryshojnë.

Nxënësi i cili për një arsye ose tjetër, përballet me vështirësi, mund të merr mbështetje në forma dhe mënyra të ndryshme:

- Nxënësit kanë të shkruar programin e specializuar me nevojat e tyre i cili përfshinë prindërit dhe personat profesional.
- Mësimdhënësit vazhdimisht janë në konsultime me mësimdhënësin e specializuar ose asistentin i cili i ndihmon mësimdhënësit dhe punon me nxënësin në fjalë.
- Nxënësi e lëshoi grupin/klasën për një periudhë të caktuar dhe punon kryesisht me mësimdhënës të specializuar.
- Nxënësit marrin materiale të përshtatura me nevojat e tyre.
- Mësimdhënësit kanë mbështetjen nga qendra burimore në nivel lokal.
- Qendrat burimore në nivel lokal mund të mbështeten nga këshilltari i Agjencisë nacionale për arsim me nevoja të veçanta.

33 https://www.european-agency.org/country-information/sweden/teacher-education-for-inclusive-education

3.1.7. Arsimi i mesëm

Shkollat e mesme (gjimnazet) nuk janë të detyrueshme, por i vizitojnë pothuajse të gjithë nxënësit. Shkollat janë papagesë dhe janë të liruara nga tatimi për materialet edukative. Nxënësit me nevoja të veçanta, të përfshirë në arsimin e mesëm, kanë të drejtat e njëjta sikurse në arsimin fillor të detyrueshëm. Për nxënësit të cilët kanë nevojë për përkrahje të posaçme, shteti siguron materiale mësimore të përshtatura. Shkollat dhe mësimdhënësit i konsultojnë qendrat burimore lokale, të cilat si reciprocitet konsultohen me Agjencinë nacionale Suedeze për arsim me nevoja të veçanta dhe shkollat. Nxënësit nga shkolla e mesme mund të përzgjedhin prej 18-të programeve nacionale sipas interesimit të tyre dhe shumica e nxënësve me aftësi të kufizuara i ndjekin këto programe nacionale. Nxënësit e shurdhër ose që kanë dëmtim në dëgjim mund të ndjekin shkolla të mesme speciale. Nxënësit me pengesa trupore e kanë të njëjtën mundësi. Komunat kanë për detyrim të ofrojnë arsim të mesëm për të gjithë nxënësit, përfshirë edhe nxënësit me vështirësi në mësim. Kjo më së shpeshti bëhet me programin special i cili ofron studimet teorike dhe aftësimin praktik. Në programet nacionale për nxënësit me vështirësi në mësim janë edhe programet për turizëm, tregti, industri dhe art. Te të gjithë nxënësit e shkollave të mesme janë të mundshme edhe zgjidhjet individuale.

3.1.8. Përkrahja shtetërore dhe rajonale

Me qëllim që të sigurohen kushte për nxënësit të cilët kanë nevojë për përkrahje të veçantë për të fituar një cilësi të barabartë të përvojave arsimore sikurse moshatarët tjerë, shteti përmes Agjencisë nacionale për arsim me nevoja të veçanta iu ofron shërbim të posaçëm për përkrahje pedagogjike organeve, shërbimeve dhe shkollave. Akti me të cilin ajo është paraparë nënkupton plotësimin e shërbimeve për përkrahje nga pushteti lokal, ndërsa qëllimi është që të zhvillohen deri në nivelin më të lartë qendrat burimore lokale dhe pjesa më e madhe e përkrahjes të vijë nga niveli lokal.

3.1.9. Treguesit për cilësinë e arsimit me nevoja të posaçme

Treguesit për cilësinë e arsimit me nevoja të posaçme në sistemin arsimor të Suedisë bazohet në qëllime[34]. Qëllimet nacionale i parashtron qeveria. Komunat, shkollat, kuadri individual dhe nxënësit i bëjnë qëllimet konkrete në mjedisin e tyre dhe bëjnë plane me aktivitetet e tyrepër t'i arritur qëllimet nacionale. Treguesit për cilësinë doemos të dalin nga planet arsimore në disa nivele nga sistemi arsimor. Përveç parashtrimit të qëllimeve, programet nacionale, gjithashtu, theksojnë cili është përgjegjës për detyrat e ndryshme në punën në shkollë edhe

34 https://www.stralsakerhetsmyndigheten.se/contentassets/df6cef3740634d1aa45f5d1e9d2a3e70/201621-the-effect-of-a-glaciation-on-east-central-sweden-case-studies-on-present-glaciers-and-analyses-of-landform-data

për mospërfilljen e së njëjtave. Në mënyrë të ngjashme, varësisht nga qëllimet e parashtruara, sistemi i evaluimit funksionon në disa nivele. Këshilli i shkollës, punonjësit dhe nxënësit bëjnë evaluimet e tyre dhe e përkrahin këshillin e shkollës me rezultatet dhe informatat tjera të nevojshme. Çdo këshill i shkollës e vlerëson punën e shkollës, e përdor materialin për planifikimin e punës në të ardhmen dhe i informon komunat. Komunat përgjegjëse për funksionimin e arsimit suedez e informojnë Agjencinë nacionale për arsim, ndërsa komunat e informojnë qeverinë. Dokumentet janë zyrtare dhe duhet të kenë qasje të lehtë.

3.1.10. Sistemi i vlerësimit

Shkalla për vlerësim në arsimin suedez përfshinë gjashtë (6) nivele të vlerësimit: A, B, C, Ç, D dhe Dh. Nivelet prej A deri në D përfshijnë rezultatet me të cilat kalohet viti, ndërsa niveli DH është rezultat i papërshkueshëm për vitin e ardhshëm shkollor[35]. Në qoftë se nxënësi shpesh mungon, ndërsa vlerësimi, nota nuk mund të jepet, sepse është e pamundur të bëhet vlerësimi i njohurisë, atëherë shkruhet simboli (-) në regjistrat e klasës. Megjithatë, nota DH dhe simboli (-) nuk përdoren në arsimin fillor të detyrueshëm për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe në arsimin e mesëm ekuivalent.

Vërejtje: Shprehja nevoja të veçanta në tekst përdoret edhe si përkrahje e veçantë.

35 https://www.skolverket.se/andra-sprak-other-languages/english-engelska

3.2. ARSIMI INKLUZIV NË ANGLI

3.2.1. Zhvillimi i inkluzionit

Qeveria e Anglisë synon një numër të madh dispozitash për përmbushjen e nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, kryesisht edhe sigurimin e burimeve në shkollat e rregullta edhe në shkollat e veçanta.

Shkollat edhe pushtetet vendore kanë për obligim të planifikojnë mënyrat me të cilat do ta rrisin qasjen e nxënësve me pengesa në hapësirat shkollore dhe zotërimin e planeve mësimore. Shkollat doemos të sigurojnë aranzhman të kurrikulës me të cilat nuk i diskriminojnë nxënësit me nevoja të veçanta, pa dallim vallë në vitin aktual kanë të regjistruar nxënës me nevoja të veçanta ose jo.[36]

Sipas Ligjit të fëmijëve dhe familjes prej vitit 2014, të gjithë fëmijët edukohen në shkollat fillore, në përjashtim të rrethanave kur duhet të pranohen në shkolla speciale pas vlerësimit të bërë.

Shkollat speciale mund të jenë gjenerike – për fëmijët me më shumë vështirësi në mësim ose mangësi fizike. Ato mund të sigurojnë kushte edhe për fëmijët me një lloj nevoje të veçantë siç është autizmi. Shkollat speciale sëbashku me shkollat e rregullta kanë të drejtë të bëhen akademi, që nënkupton se më nuk janë nën kontrollin e pushtetit vendor dhe kanë më shumë liri për atë se çka do të

36 https://www.european-agency.org/country-information/uk-england/legislation-and-policy

mësohet në programin mësimor. Prindërit, organizatat joqeveritare dhe të tjera, kanë të drejtë të themelojnë shkolla pa pagesë, duke përfshirë edhe shkollat speciale papagesë. Shkollat speciale janë pjesë e planit qeveritar me të cilin iu jepet shkollave roli qendror në ngritjen e standardeve përmes zhvillimit të vetëpërmirësimit dhe sistemit të qëndrueshëm të cilin e udhëheq shkolla.

3.2.2. Dispozitat aktuale

Sipas Ligjit të arsimit prej vitit 2002[37] të gjithë nxënësit në shkollat, të cilat financohen nga shteti kanë të drejtë të qasjes të një programi mësimor më të gjerë dhe të balancuar dhe të gjitha shkollat në pushtetin vendor (përfshirë edhe shkollat speciale) janë të detyruara ta dorëzojnë Programin mësimor nacional, i cili është mjaft fleksibil për të përshtatur stile të ndryshme mësimi[38]. Programi i ri mësimor nacional është aplikuar në shtator të vitit 2014. Mësimdhënësit doemos të përcaktojnë ndërhyrjet për përkrahjen dhe mësimdhënien, ku nxënësit plotësisht mund të marrin pjesë në të gjitha pjesët e programit mësimor, në bazë të Programit mësimor nacional. Mësimdhënësit kanë lirinë që programet mësimore nacionale t'i harmonizojnë me nevojat specifike dhe individuale të nxënësve dhe të bëjnë përshtatshmëri të arsyeshme aty ku e kërkon nevoja. Afatet kohore, gjithashtu, mund të përshtaten sipas Aktit për barazi prej vitit 2010 që të mundësohet përfshirja e fëmijëve me pengesa[39]. Programi i njohur anglez „Achievement for All" ose „Arritjet për të gjithë" punë me prindërit, edukatorët, mësimdhënësit, liderët dhe personat profesional të arsimit, shëndetësisë, vullnetarit, sektorit privat dhe publik për përkrahjen e personave të rinj të rrezikuar dhe familjet e tyre për t'i rritur afinitetet, qasjen dhe arritjet.

3.2.3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore

Fondacioni „Faza në vitet e hershme" (EYFS) është kornizë ligjore gjithëpërfshirëse, të cilin të gjithë provajderët e mësimit në vitet e hershme doemos duhet ta përmbushin[40]. Ai promovon mësim dhe mësimnxënie që të sigurojë për fëmijët ,,përgatitjen për në shkollë" dhe iu jep fëmijëve një spektër të gjërë dhe shkathtësi të cilat sigurojnë bazën e vërtetë për një përparim të mirë të ardhshëm në shkollë dhe gjatë jetës. EYFS për herë të parë është publikuar në vitin 2008, ndërsa versionet e përshpejtuara janë botuar në vitin 2012 dhe 2014. Ekziston një kusht ligjor të gjithë nxënësit të vlerësohen në mbarim të fazës kryesore 1 (5-7 vjeç), faza kryesore 2 (7-11) dhe faza kryesore 4 (14-16). Tanimë nuk ekziston një vlerësim ligjor në mbarim të fazës kryesore 3 (11-14 vjeç) sepse si pjesë e Programit mësimor nacional nivelet e arritjes janë hequr dhe nuk janë zëvendësuar.

37 https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2002/32/contents

38 https://www.teachers.org.uk/files/active/0/costs_of_inclus-pt1.pdf

39 https://educationendowmentfoundation.org.uk/projects-and-evaluation/projects/achievement-for-all/

40 https://www.gov.uk/early-years-foundation-stage

3.2.4. Testimi aktual në shkolla

Faza kryesore 1: Kontrollimi i fonetikës që iu jepet nxënësve në klasën e parë që të vlerësohet aftësia e tyre për deshifrimin e fjalëve[41]. Të dhënat në nivel të shkollës nuk publikohen, por rezultatet nacionale publikohen gjatë muajit shtator. Pastaj jepen detyra dhe teste statutore në matematikë dhe në shkrim dhe lexim në gjuhën angleze. Rezultatet nuk publikohen, por doemos të përdoren që të definohet nota e mësimdhënësit në këto lëndë. Shkolla, gjithashtu, doemos të bëjnë vlerësimin e mësimdhënësit përtë folurit dhe të dëgjuarit.

Faza kryesore 2: Përmbanë teste statutore nga matematika, shkenca dhe lexim në gjuhën angleze, një test të posaçëm për gramatikë, shenjat e pikësimit dhe drejtëshkrimi.

Faza kryesore 3: Nxënësit marrin pjesë në testimin ekstern.

3.2.5. Treguesit për cilësinë e arsimit special

Cilësia e arsimit të posaçëm/special është përfshirë në mekanizmat më të zgjeruar të shtetit për sigurinë e cilësisë. Shkollat janë subjekt i inspektimit nga departamenti përgjegjës i qeverisë Ofsted[42]. Cilësia e arsimit për të gjithë nxënësit, përfshirë edhe ato me nevoja të veçanta arsimore, është pjesë e kornizës inspektuese.

41 https://www.gov.uk/guidance/key-stage-1-assessments

42 https://www.gov.uk/government/organisations/ofsted

3.3. ARSIMI INKLUZIV NË ITALI

3.3.1. Zhvillimi i arsimit inkluziv[43]

Sipas Kushtetutës, Republika e Italisë garanton **shkollë për të gjithë** (neni 34) dhe kërkon gjatë procesit të përmbushet obligimi i detyrueshëm për solidaritet (neni 2)[44]. Përveç kësaj, „detyrim i Republikës është t'i shmangë të gjitha pengesat me të cilat përkufizohet liria dhe barazia e qytetarëve me qëllim të sigurimit dhe zhvillimit të plotë të personalitetit të njeriut" (neni 3). Para integrimit, në Itali ka pasur paralele të posaçme për nxënësit me hendikep dhe shkolla speciale për nxënësit me pengesa „të lehta" (nxënës me pengesa specifike fizike ose intelektuale). Ka pasur edhe klasa të posaçme ku kanë marrë pjesë ,,nxënës nervoz, të privuar intelektualisht, nxënës jostabil" të cilët nuk mund të përshtateshin në paralele të rregullta edhe për të cilët disiplina e përbashkët edhe metodat mësimore do të ishin jopërkatëse, ndërsa të njëjtat do të përmirësoheshin vetëm përmes metodave të posaçme.

Integrimi në Republikën e Maqedonisë filloi në vitin 1971 në bazë të nenit 118 të Ligjit për arsim, arsimi i detyrueshëm për fëmijët me nevoja të veçanta doemos të realizohet në paralelet e rregullta, përveç në raste të mangësive intelektuale ose dëmtimeve fizike të cilat janë aq të vështira që të

43 https://www.european-agency.org/country-information/italy

44 https://www.senato.it/documenti/repository/istituzione/costituzione_inglese.pdf

pengohet mësimi ose integrimi në klasat e përbashkëta[45]. Ligji i njëjtë, gjithashtu, imponon një detyrim për komunat për t'i bërë ndërtesat shkollore të kapshme për të gjithë, në përputhje të standardeve nacionale.

Ligji 517/**1977** është miratuar për zbatimin e procedurave për integrimin e nxënësve me hendikep përmes sigurimit të mësimdhënësve special, si në shkollat fillore ashtu edhe në shkollat e mesme.

Ligji 104/**1992** është korniza kryesore për të gjitha problemet dhe pengesat. Ai garanton të drejta specifike për personat me nevoja të veçanta dhe për familjet e tyre, siguron ndihmë, parashikon integrimin e plotë dhe miratimin e masave për parandalimin dhe rikuperimin funksional , gjithashtu, siguron mbrojtje sociale, ekonomike dhe juridike.

Ligji 328/**2000** parashikon se familjet, së bashku me komunat dhe shërbimet sociale mund të bien dakord për një projekt jetësor të individualizuar për fëmijët e tyre, qëllimi i të cilit është integrimi i plotë në familje dhe në jetën shoqërore.

Ligji 170/**2010** e njeh disleksinë, disgrafinë, disortografinë dhe diskalkulinë si çrregullime specifike në mësimnxënie. Ky është një ligj në të cilin theksohet se nxënësve me çrregullime në mësimnxënie nuk iu nevojiten mësimdhënës special, por mënyrë e re e mësimit, sipas së cilës të mësuarit promovon ndryshim në perspektivë. Qëllimi është që të zhvendoset përqendrimi nga pikëpamja klinike në atë pedagogjike përmes përforcimit e të gjitha subjekteve të përfshira në procesin arsimor.

Direktiva ministrore nga 27 **dhjetori 2012** me temë „Masat e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe organizatat lokale për përfshirjen e nxënësve", krijoi një kategori makro, „ombrellë", që të mbulohen të gjitha llojet e vështjtirësive në shkollë pa dallim a janë të vazhdueshme ose të përkohshme: invaliditet, çrregullime specifike në mësimnxënie, çrregullime specifike në zhvillim, socio-ekonomike, kulturore ose mangësi gjuhësore, si dhe nxënës të cilëve iu nevojitet kujdes i veçantë.[46] Kjo siguron më shumë praktika inkluzive në klasa përmes planeve arsimore të individualizuara dhe të personalizuara.

3.3.2. Nxënësit me nevoja të veçanta

Nxënësit me nevoja të veçanta, zakonisht ndjekin shkollat e rregullta në seksionet dhe orët e zakonshme në të gjitha nivelet e procesit arsimor[47]. Ekzistojnë disa institute të veçanta për nxënës të cilët janë të verbër dhe të shurdhër, të cilët kanë ekzistuar para Ligjit 104/1992, si dhe shkolla me detyra specifike nga fusha e arsimit, kryesisht për nxënësit me pengesa të vështira në zhvillim.

Nxënësit me dhe pa hendikep mund të regjistrohen në shkollë të mesme deri

45 https://www.uni-frankfurt.de/53397339/Inclusion-Italy.pdf

46https://www.researchgate.net/publication/279961505_Inclusive_education_in_Italy_description_and_reflections_on_full_inclusion

47 https://www.uni-frankfurt.de/53397339/Inclusion-Italy.pdf

në moshën 18-vjeçare. Gjatë regjistrimit, prindërit patjetër të dërgojnë vërtetim specifik të lëshuar nga zyra relevante, pasi që të përfundojnë procedurat e detyrueshme për identifikimin e pengesës, aftësisë së kufizuar. Një dokumentacion i këtillë e vërteton llojin e aftësisë së kufizuar dhe të drejtën të marrin përkrahje konkrete. Në bazë të certifikimit të sipërpërmendur përgatiten këto dokumente:

- **Diagnoza funksionale:** organi lokal shëndetësor e përcakton këtë gjendje. Siguron përshkrim analitik të kushteve psiko-fizike të nxënësve dhe potencialin e tij.
- **Profili dinamik-profesional:** autoriteti lokal shëndetësor dhe kuadri mësimor e ndërlidhin këtë së bashku. Në të janë përfshirë elementet diagnostike, të ndërlidhura me vështirësitë me të cilat përballen nxënësit në aktivitetet e tyre shkollore, por, para së gjithash, mundësitë e tyre për zhvillim në afat të shkurtë dhe të mesëm.
- **Plani arsimor individual:** ky plan përgatitet në mënyrë të përbashkët të autoriteteve shëndetësore lokale, mësimdhënësve, edukatorëve ose asistentëve për arsim (nëse është e nevojshme), në bashkëpunim me prindërit. Ai përfshinë përshkrimin e ndërhyrjeve të parapara për nxënësin.

Ligji, gjithashtu, parashikon krijimin e orëve të rregullta në pjesë të veçanta në qendrat për rehabilitim dhe spitale, me qëllim të sigurohet arsimim për fëmijët të cilët përkohësisht nuk mund të shkojnë në shkollë (jo më pak se 30 ditë). Mësimdhënësit me trajnim specifik psiko-pedagogjik mund të punësohen që të ligjërojnë në qendrat për rehabilitim edhe në spitale. ,,Shkolla në spital" është shumë fleksibile, duke pasur parasysh llojin e sëmundjes të secilit nxënës, kohën e ekzaminimit te mjeku dhe terapitë, si dhe ritmin e jetës në spitale. Mësimi në shtëpi dedikohet për fëmijët e sëmurë të cilët nuk mund të ndjekin mësimin së paku 30 ditë, mësohet në shtëpi nga një një ose më shumë mësimdhënës sipas projektit konkret, me qëllim të riintegrimit të tyre të mëvonshëm në klasë.

3.3.3. Nxënësit me çrregullime specifike në mësim (SLD-Specific learning disorders)[48]

Gjatë regjistrimit të nxënësve me çrregullime specifike në mësim, prindërit doemos duhet të dërgojnë në shkollë vërtetimin zyrtar të lëshuar nga zyra relevante shëndetësore nacionale. Ministria e Arsimit lëshon udhëzim për t'iu ndihmuar shkollave në përkrahjen e nxënësve me SLD në rrugëtimin e tyre arsimor. Me qëllim të lehtësimit të procesit arsimor me të nxënësve me SLD, mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave, në të gjitha nivelet, janë subjekt i një trajnimi specifik në vendin e punës. Aktivitetet për trajnim përqendrohen në identifikimin e hershëm të rrezikut për SLD, masat didaktike që duhet të merren me nxënësin edhe me grupin e klasës, me procedura për vlerësim dhe udhëzime, rekomandime. Vlerësimi i nxënësve me

48 https://www.researchgate.net/publication/267742875_WISC-IV_Intellectual_Profiles_in_Italian_Children_With_Specific_Learning_Disorder_and_Related_Impairments_in_Reading_Written_Expression_and_Mathematics

SLD duhet të jetë në përputhje me planet arsimore të personalizuara, për shembull, duke përdorë teste verbale, e jo të shkruara për të vlerësuar njohurinë e gjuhës së huaj, ose duke përdorë mjete kompensuese.

3.3.4. Nevoja tjera të veçanta arsimore

Problemet socio-ekonomike, kulturore ose gjuhësore janë identifikuar si në nivel të shkollës poashtu edhe në nivel lokal. Në raste të këtilla, nëse nevojitet, mësimdhënësit mund të përgatisin plane arsimore individuale. Të miturit, duke përfshirë edhe ato të migracionit të parregullt kanë të njëjtat të drejta të edukimit sikur të miturit italian. Shteti, rajonet dhe autoritetet lokale e garantojnë të drejtën e arsimit.

3.3.5. Indikatorët e cilësisë së arsimit për nevoja të veçanta

Në mars 2013 është lëshuar një **Dekret presidencial** i ri (80/**2013**) i cili rregullon **sistemin nacional të evaluimit**[49]**.** Sipas dekretit, në sistemin nacional të evaluimit përfshihen tre instruksionet me sa vijon:

- Instituti nacional i evaluimit të sistemit për arsim dhe trajnim (INVALSI), detyra e të cilit është përgatitja e testeve për evaluimin e jashtëm të rezultateve nga mësimnxënia e nxënësve.
- Instituti nacional për dokumentim, risi (inovim) dhe hulumtim në arsim (HEMA), qëllimi i të cilit është përkrahja ndaj shkollave në proceset e risive dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.
- INVALSI është nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit, universitetet dhe hulumtimet (MIUR). MIUR, përmesnjë direktive specifike, lëshuar çdo vit e që përcakton qëllim për evaluimin e jashtëm.

Për nxënësit me pengesa individuale, shkollat sigurojnë teste të individualizuara bazuar në modelet nacionale, ndërsa vlerësohet shkalla e arritjes sipas planit individual për arsim.

3.3.6. Planet arsimore dedikuar për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

Pothuajse për të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në sistemin shkollor italian (kryesisht nxënës me nevoja të veçanta, çrregullime specifike në mësim, çrregullime specifike në zhvillim, ose socio-ekonomike, mangësi kulturore ose gjuhësore), ligji parasheh hartimin e planeve arsimore të përshtatura (individuale ose të personalizuara) të cilat përgatiten nga mësimdhënësit, kuadri medicinal, prindërit dhe persona të tjerë profesional që janë të përfshirë në jetën e nxënësit. Prindërit gjithmonë përfaqësohen në grupin punues lokal dhe rajonal. Drejtori i shkollës dhe kuadri mësimor janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë. Kuadri mësimor planifikon dhe përgatit aktivitete didaktike, ndërsa drejtori i kontrollon dhe vendos për evaluimin e rezultateve të arritura.

Nga fillimi i vitit shkollor 2013/2014 secila shkollë në Itali ka obligim të përgatisë plan vjetor për inkluzionin si bazë për planin për politikën arsimore. Plani për politikë arsimore

49 https://bit.ly/2NBDEH0

është dokument bazë i cili i përshkruan burimet mësimore, jashtëmësimore, arsimore dhe organizative, të cilat çdo shkollë i miraton sipas autonomisë së vet. Në fund të çdo viti shkollor, shkollat kanë detyrim ligjor të monitorojnë dhe vlerësojnë efektivitetin e përfshirjes së tyre.

3.4. ARSIMI INKLUZIV NË KROACI

3.4.1. Zhvillimi i arsimit inkluziv

Gjeneza e arsimit inkluziv është vlera e arsimit e të drejtave dhe barazisë së njeriut, vlerave socio-kulturore si dhe supozimeve bazë për inkluzionin social. Këto vlera janë parakusht për ndryshimet në sistemin arsimor në lidhje me përfshirjen e të gjithë fëmijëve në sistemin e rregullt arsimor, si dhe ndryshimet në inkluzionin arsimor.

Implementimi i inkluzionit arsimor është pjesë përbërëse e demokratizimit të arsimit, me qëllim të sigurimit të qasjes së barabartë e arsimit për të gjithë, pa marr parasysh dallimet. Implementimi i sjell problemet me të cilat përballen sistemet arsimore dhe praktikat shkollore[50].

Koncepti i arsimit inkluziv është koncept edukativ i cili del nga qëndrimi gjeneral për nevojën e përfshirjes së të gjithë nxënësve në shkollat e rregullta, duke marrë parasysh nevojat e tyre arsimore, me përqendrim të veçantë ndaj grupeve të rrezikuara, në kuptijm të margjinalizimit dhe përjashtimit.

Në Konferencën Botërore të UNESKO-s, për arsimin me nevoja të veçanta, që u mbajt në vitin 1994, u miratua Deklarata nga Salamanka dhe korniza për aksion e cila promovon të drejtën e secilit fëmijë pa marr parasysh kushtëzimin fizik, intelektual, emocional, social dhe gjuhësor të jetë i përfshirë në sistemin arsimor, përkatësisht në paralelet dhe shkollat e rregullta. Shkollat filloren të rregullta me këtë orientim inkluziv janë mjetet më efektive për luftë kundër qëndrimeve diskriminuese, duke krijuar bashkësi të hapura, ndërtimin e një shoqërie inkluzive dhe arritje arsimore për të gjithë. Përveç kësaj, do të sigurohet arsim efektiv për shumicën e fëmijëve dhe përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të shpenzimeve në tërë sistemin arsimor.

Parimete arsimit inkluziv janë miratuar në Forumin Botëror të arsimit në Dakar të vitit 2000, ndërsa idea për arsimin inkluziv dhe përkrahje të KB (Deklarata për të drejtat e personave me pengesa në vitin 1975, Konventa e KB për të drejtat e personave me nevoja të veçanta në vitin 2006 dhe një numër i dokumenteve tjera të KB dhe UNESKO-s), janë rregulla standarde për barazimin e mundësive e personave me hendikep, duke deklaruar pjesëmarrje dhe barazi për të gjithë, ndërsa llojlojshmëria e natyrës së njeriut kontribuon për pasurinë e çdo shoqërie dhe doemos të manifestohet në shkolla. Në Kroaci arsimi i këtillë është legalizuar në vitin 1980 me Ligjin për arsimin fillor.

50 https://www.european-agency.org/country-information/croatia

Legjitimimi i idesë për arsim të përbashkët të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijëve pa vështirësi të këtilla do të mundësojë zhvillim të suksesshëm në sfera të ndryshme (në veçanti atë kognitive, sociale dhe emocionale), përparim të sukseshëm të fëmijëve gjatë arsimimit të tyre dhe arritjes të suksesit më të madh akademik.

Përfshirja e sukseshme nënkupton se të gjithë fëmijët në mënyrë aktive janë përfshirë dhe kanë qasje deri te vendet për argëtim dhe punë, përkatësisht kanë opsione të cilat munden personalisht t'i përzgjedhin.

Një person nuk mund të jetë përgjegjës për funksionimin e inkluzionit. Për këtë proces duhet një angazhim i përgjithshëm, grupor. Procesi në përfshirje doemos të përshtatet që të përmbushen nevojat e çdo fëmije, si dhe kërkesat e programit mësimor.

Me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta arrihet socializimi, integrimi, rritja në mjedisin jetësor, pranimi i diversiteteve, zhvillimi i tolerancës, guximit në kërkesën dhe pranimin e ndihmës nga të tjerët, zhvillim dhe përforcim të personalitetit të fëmijës me pengesa.

Ligji për arsim fillor përfshin detyrimin e testimit që të përcaktohet gjendja fizike dhe mentale e fëmijës para fillimit të arsimit fillor dhe përgatitja e cila ka të bëjë me të gjithë fëmijët, ndërsa në bazë të Rregullores për procedurën e përcaktimit të gjendjes psikofizike të fëmijës janë nxënësit dhe stafi i komisioneve të ekspertëve.

Komisioni profesional bën përcaktimin e gjendjes fizike dhe mentale të fëmijës gjatë:

- regjistrimit të rregullt në klasë të parë në shkollë fillore;
- regjistrimi i hershëm i fëmijës në klasë të parë në shkollë fillore;
- prolongimi i regjistrimit në klasë të parë në shkollë fillore;
- programi përkatës për arsimin fillor për nxënësit me nevoja të veçanta.

Komisioni i ekspertëve të shkollës përfshinë: mjekun e specializuar mjekësor të shkollës, kuadrin profesional të punësuar në shkollë (mësimdhënësit dhe/ose këshilltar, / ose bashkëpunëtor pedagog social), mësimdhënës dhe mësues të gjuhës kroate[51].

Komisioni i ekspertëve të Zyrës përcakton gjendjen fizike të fëmijës /nxënësit gjatë:

- regjistrimit të hershëm të fëmijës në klasë të parë në arsimin fillor;
- prolongimin e regjistrimit në klasë të parë në arsimin fillor;
- lirimi i përkohshëm në regjistrimin në klasë të parë në arsimin fillor;
- lirimi i përkohshëm nga arsimi i filluar;
- krijimi i një programi përkatës për arsim fillor ose të mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta;
- heqja e vendimit të programit adekuat për arsimin fillor ose të mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta;
- përfshirja e fëmijës /nxënësit në mësimin përgatitor ose plotësues në gjuhën kroate.

51 https://www.european-agency.org/country-information/croatia

Anëtarët e Komitetit Evropian të Zyrës janë specialistë të mjekësisë në shkollë, një mjek i shkollës në qark ose në qytetin e Zagrebit, psikolog klinik, asistent psikolog, asistent-mësues, asistent edukator-rehabilitator, asistent-logoped, asistent-pedagog, mësim-dhënës, mësimdhënës-mentor dhe mësues të gjuhës kroate, të cilët janë të punësuar në shkollë. Numri i anëtarëve të Komisionit të ekspertëve doemos të jetë tek.

3.4.2. Përkrahja e programit

Plani mësimor dhe/ose programi për arsim është përkatës dhe siguron përparim arsimor të nxënësve, duke respektuar specifikimin e problemeve të identifikuara, specifikat e funksionimit të tij dhe nevojat arsimore.

Programet arsimore përkatëse për nxënësit janë:

- programi i rregullt me procedura të individualizuara;
- programi i rregullt me përshtatjen e përmbajtjes dhe procedurave të individualizuara;
- programi i veçantë me procedura të individualizuara;
- programet e veçanta për marrjen e kompetencave në aktivitetet nga përditshmëria dhe puna me procedura të individualizuara.

Programet arsimore përkatëse realizohen në:

- klasë të rregullt;
- pjesërisht në klasë të rregullt, ndërsa pjesërisht në repartin e klasës speciale;
- repartin e klasës speciale;
- grupin arsimor.

Programet plotësuese arsimore dhe programet për rehabilitim, të cilat janë caktuar si pjesë e programit përkatës për edukimin e nxënësve janë:

- programi për edukim dhe rehabilitim;
- programi për procedurë profesionale të zgjeruar;
- programet për rehabilitim.

Programet përkatëse për arsimin e nxënësve në shkollë në klasa dhe grupe arsimore janë strukturuar në bazë të moshës së nxënësve dhe llojit të programit arsimor përkatës.

Format e përkohshme të arsimit janë:

- detyrat e shtëpisë;
- mësimi në institucion shëndetësor;
- mësimi në largësi.

3.5. ARSIMI INKLUZIV NË MAL TË ZI

3.5.1. Zhvillimi i arsimit inkluziv

Mundësimi i kushteve për arsimin inkluziv paraqet pjesë të reformës së përgjithshme të sistemit edukativo-arsimor dhe nënkupton themelimin e institucioneve arsimore të cilat do të plotësojnë nevojat dhe mundësitë e të gjithë fëmijëve. Shkaqet e inkluzionit janë të shumta, si dhe përfitimet nga ky proces i kanë të gjithë pjesëmarrësit[52].

Ndryshimet të cilat filluan prej vitit 1997 në nivelin e edukimit dhe arsimit parashkolor, me realizimin e projektit ,,Kopshti dhe

52 http://www.skolskiportal.edu.me/Inkluzivno%20obrazovanje/Strategija%20inkluzivnog%20obrazovanja%202019-2025.pdf

shkolla sipas përmasës së fëmijës'' realizuar në partneritet me HBO (Save the Children, UNICEF, Qendra Pedagogjike e Malit të Zi) dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Malit të Zi, paraqet përpjekjen e parë për të ofruar kushte për arsimin inkluziv në Malin e Zi.

Nga shtatori i vitit 1998 filloi pilot-projekti „Integrimi i fëmijëve me pengesa në zhvillim në grupet e rregullta në kopshte". Atëherë janë kyçur katër fëmijë në dy grupe edukative në Podgoricë. Në vitin shkollor 1999/2000 janë përfshirë dhjetë fëmijë, ndërsa në vitin shkollor 2000/2001, përveç katërmbëdhjetë fëmijëve në dy grupet edukative në Podgoricë, janë përfshirë edhe gjashtëmbëdhjetë fëmijë në shtatë komuna (Berane, Bijelo Pole Plijevla, Cetinë, Tivar, Kotor dhe Herceg Novi). Në vitin 2001/2002 këtij projekti i janë bashkangjitur edhe shtatë komuna (Nikshiq, Plav, Mojkovac, Danilovgrad, Ulqin, Tivar dhe Budvë), ndërsa në 23 grupe në kopshte janë përfshirë 46 fëmijë me vështirësi në zhvillim.

Ligji i arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta është miratuar në vitin 2004 nga i cili pasojnë vendimet e reformave, rekomandimet dhe standardet nga legjislacioni evropian në këtë fushë. Tranzicioni nga modelet konvencionale arsimore ndaj inkluzionit është një proces afatgjatë. Të gjitha burimet arsimore në shoqëri (kadrovike, organizative dhe materiale) doemos të jenë të angazhuar gjatë realizimit të modelit inkluziv të arsimit.

Projekti finlandez „Drejt arsimit inkluziv", realizuar në periudhën 2006-2008, përfshinte 40 drejtorë dhe ndihmësdrejtorë, 38 këshilltarë për përmirësimin e procesit arsimor nga Instituti për arsim, 39 mësimdhënës dhe persona profesionistë.

Sipas nenit 19 të Ligjit për edukimin dhe arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe në bazë të Rregullores për kriteret e përcaktimit të formave dhe shkallën e pengesës, përkatësisht vështirësitë e fëmijëvedhe të rinjëve me nevoja të veçanta dhe mënyrën e përfshirjes në programin arsimor, në vitin 2008 u formuan komisione lokale për udhëzime. U formuan komisione të shkallës së parë për udhëzimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Komisionet japin propozime për udhëzimet në programin arsimor përkatës, institucioni parashkollor, shkolla ose institucioni i posaçëm në të cilin do të përfshihet nxënësi me nevoja të veçanta arsimore[53].

Në bashkëpunim me UNICEFI-n realizohet edhe Projekti ,,Edukimi i komisioneve për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin edukativo-arsimor". Janë formuar grupe punuese për përpilimin e instrumenteve të punës dhe definimi i Doracakut për punën e Komisionit. Është formuar Komisioni i shkallës së dytë për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Strategjia e përgjithshme për arsimin inkluziv, të cilën e miratoi Qeveria e Malit të Zi

53 http://www.zzs.gov.me/naslovna/inkluyivno/naslovna_inkluzivno_podrska_inkluzivnom_obrazovanj/

në vitin 2008, përqendrohet në promovimin dhe sigurimin e cilësisë dhe qasje në arsim për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta në arsim, në përputhje me interesat, aftësitë dhe nevojat e tyre.

Për të ndihmuar në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, në Entin për arsim organizohen shërbime mobile të specializuara të cilat bashkëpunojnë me institucionet parashkollore, shkollat dhe institucionet shëndetësore në mënyrë që të ofrojnë ndihmë shtuese dhe ndihmë profesionale në përputhje me zgjidhjet e orientimit të fëmijëve me nevoja të veçanta[54].

3.6. ARSIMI INKLUZIV NË SERBI

3.6.1. Zhvillimi i arsimit inkluziv

Arsimi cilësor është thelbësor për zhvillimin e shoqërive dhe individëve dhe ndihmon në krijimin e kushteve për një ardhmëri të suksesshme dhe produktive. Kur të gjithë fëmijët të kenë qasje për arsim cilësor, i cili bazohet në të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, atëherë efektet pozitive ndjehen përmes disa gjeneratave.

Sot fëmijët në Serbi kanë qasje më të mirë ndaj arsimit se 10 vite më parë, dhe shkollat gjithnjë e më shumë regjistrojnë ata fëmijë për të cilët dera ishte e mbyllur më parë në sistemin arsimor. Sidoqoftë, ende ka shumë nxënës të privuar ekonomikisht, dhe fëmijë nga grupet e rrezikuara të cilët janë anashkaluar.

54 http://www.skolskiportal.edu.me/Pages/Inkluzivnoobrazovanje.aspx

Në Serbi shumë fëmijë nga grupet e rrezikuara herët e lëshojnë shkollën, ndërsa të tjerët fare nuk ndjekin shkollën. Shkalla e braktisjes së shkollës në Serbi është më e lartë te fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët të cilët jetojnë në varfëri të skajshme, fëmijët e lagjjeve rome dhe fëmijët e rajoneve më të largëta[55].

Arsimi inkluziv është një përgjigje ndaj nevojave të ndryshme arsimore të fëmijëve. Me pjesëmarrjen në arsimin cilësor fillor dhe të mesëm, grupet e rrezikuara mund të rrisin mundësinë për një jetë më të mirë dhe pjesëmarrje të rëndësishme në shoqëri.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit teknologjik në Republikën e Serbisë jep mbështetje të plotë në implementimin e programeve që dedikohen për pengimin e fëmijëve që braktisin shkollën, madje punohet edhe në rritjen e regjistrimit të vajzave rome në shkollat e mesme, me qëllim të përmirësimit të barazisë në arsim.

Aktivitetet në këtë sferë janë orientuar ndaj ngritjes së cilësisë të mësimdhënësve dhe personelit të shkollës në zbatimin e arsimit inkluziv për mbështetjen e komisioneve ndërsektoriale lokale, që t'iu sigurojnë fëmijëve ndihmë plotësuese arsimore, shëndetësore dhe sociale njëherit edhe t'i inkurajojnëprindërit e grupeve të rrezikuara në mënyrë aktive të angazhohen dhe të kërkojnë të drejtat për fëmijët e tyre.

55 https://www.unicef.org/serbia/inkluzivno-obrazovanje

Inkluzioni është një proces i mësimit dhe arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta së bashku me fëmijët të cilët nuk kanë nevoja të tilla. Këta fëmijë kanë mundësi të barabarta në zhvillimin e aftësive të tyre fizike, emocionale, sociale dhe aftësi të tjera. Inkluzioni iu mundëson fëmijëve me nevoja të veçanta t'i mbikëqyrin monitorojnë dhe drejtpërdrejtë të komunikojnë me fëmijët që kanë zhvillim tipik. Shumë hulumtues besojnë se interaksioni shoqëror me moshatarët kontribuon në zhvillimin dhe socializimin e fëmijës. Në rast më të mirë, këto raporte mund të kontribuojnë për arritje më të larta të fëmijës dhe në zhvillimin e tij social dhe mendor[56].

Ekzistojnë disa fusha kryesore ku raportet apo marrëdhëniet me bashkëmoshatarët kanë ndikim të madh, edhe atë:

- Zhvillimin e vlerave shoqërore, qëndrimeve, pikëpamjeve të botës dhe aftësitë e përgjithshme.
- Parashikimi dhe ndikimi ndaj shëndetit mendor të fëmijës në të ardhmen. Fëmijët që kanë marrëdhënie të brishta me bashkëmoshatarët e tyre dhe mbeten të izoluar në mënyrë shoqërore, janë të prirur ndaj problemeve mendore gjatë zhvillimit të tyre.
- Ndikimi ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve me sjellje problematike, siç është përdorimi i drogës.
- Mësimin e fëmijëve si ta kontrollojnë sjelljen agresive. Tejkalimi i agresivitetit në shoqëri me bashkëmoshatarët.
- Ndihmë për zhvillimin e identitetit gjinor. Familja është pjesëmarrësi i parë në proces, ndërsa bashkëmoshatarët e zgjerojnë dhe e zhvillojnë atë.
- Ndihmë në zhvillimin e pikëpamjes më të gjerë të botës dhe ndryshimi nga ekzocentrimi.
- Ndikimi ndaj arritjes së fëmijës dhe qëllimet e tyre për të ardhmen.

3.6.2. Përfitimet për fëmijën me inkluzion:

- mundësinë për shoqërim me bashkëmoshatarët;
- shembuj të bashkëmoshatarëve për shkathtësi dhe sjellje;
- vetëbesimi i madh për qëndrimin në një grup të rregullt;
- përparësitë për fëmijët tjerë në program;
- mundësitë e mësimit për dallimet;
- vetëbesimi i madh për të ndihmuar të tjerët;
- të mësuarit e shkathtësive të reja sociale për interaksionin ndaj fëmijëve me aftësi të ndryshme;
- zhvillimi i kuptimit të vështirësive te fëmijët me nevoja të veçanta;
- bëhen të ndjeshëm ndaj nevojave të të tjerëve dhe më së miri e kuptojnë diversitetin;
- fëmijët mësojnë se individi mund t'i kalojë vështirësitë e tij dhe në atë mënyrë të ketë sukses;
- njohja e aftësive dhe shkathtësive të veta.

56 http://gmr.uis.unesco.org/ViewTable.aspx

3.6.3. Përfitimet për prindërit e fëmijës me inkluzion:

- ndjenja se fëmija i tyre është i pranuar;
- njohuria se fëmija fiton mundësi të shumta;
- pranimi i dallimeve;
- informata për fëmijën në krahasim me fëmijët tjerë.

3.6.4. Përparësitë për prindërit e fëmijëve të tjerë në program:

- njohja e dallimeve individuale ndërmjet fëmijëve dhe mënyrat si familje të caktuara punojnë me fëmijët e tyre me nevoja të veçanta.
- Zbulimi i mënyrave të reja që të ndihmohen njëri me tjetrin.

3.6.5. Përfitimet e kuadrit edukativo-arsimor:

- zhvillimi profesional/mësimi i shkathtësive të reja;
- sfidë, interesim të ri për punë;
- sigurimi i shërbimeve të nevojshme;
- definimi i mundësive individuale të fëmijëve dhe nevojat specifike për mësim të fëmijëve në veçanti;
- rritja e aftësisë për punë individuale.

Studimi „Siguron përkrahje plotësuese ndaj nxënësve të grupeve të rrezikuara në arsimin parashkollor" është përgatitur nga UNICEF-i dhe nga ekipi i Qeverisë për përfshirjen sociale dhe zvogëlimin e varfërisë. Ky studim jep një pasqyrë të kornizës institucionale dhe juridike, politikat dhe masat në drejtim të grupeve të përmirësimit të arsimit të fëmijëve të varfër dhe fëmijëve të grupeve të rrezikuara në Serbi (me theks të veçantë në masat e sistemit për arsim dhe mbrojtje sociale).

Masat e rekomanduara janë të grupuara në tre kategori:

- kategoria e parë është për përforcimin e themelores, mbështetjen themelore materiale dedikuar për fëmijët e grupeve të rrezikuara dhe të margjinalizuara;
- kategoria e dytë ka të bëjë me një sërë masash për përmirësimin e përkrahjes të arsimit të këtyre fëmijëve;
- kategoria e tretë ka të bëjë me promovimin e shërbimeve për përkrahjen e përfshirjes aktive në terren[57].

57 https://www.iserbia.rs/studentska/kakvo-je-stvarno-stanje-inkluzije-u-obrazovanju-4886

PJESA II
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

1. Lënda e hulumtimit
2. Definimi i koncepteve themelore i subjektit të hulumtimit
3. Qëllimi dhe karakteri i hulumtimit
4. Detyrat e hulumtimit
5. Hipotezat e hulumtimit
6. Variablat e hulumtimit
7. Metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit
8. Ekzemplari i hulumtimit
9. Përpunimi i të dhënave nga hulumtimi
10. Organizimi dhe vijimi i hulumtimit



1. LËNDA E HULUMTIMIT

Perceptimi i rritjes të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e rregullta në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe angazhimet e të gjithë faktorëve relevant për mundësimin e arsimit cilësor për të gjithë fëmijët e imponoi nevojën për një hulumtim të këtillë, që të shqyrtohet gjendja e arsimit inkluziv nga aspekti i përfshirjes së burimeve për ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e rregullta.

Në pjesën e burimeve njerëzore, si faktor i rëndësishëm për arsim inkluziv cilësor, është punësimi intervenues i një numri të madh defektologësh (edukatorë specialistë dhe rehabilitorë) në dy vitet e fundit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe angazhimi i asistentëve personal pedagogjik si ndihmë dhe përkrahje plotësuese ndaj nxënësve me nevoja të veçanta arsimor gjatë viteve të fundit.

Në fakt, interesi i hulumtimit është orientuar ndaj marrjes së një pasqyre subjektive për inkluzionin në shkolla nga aspekti i funksionimit të ekipit inkluziv në shkollë dhe pjesëmarrja e bashkëpunëtorëve profesional (pedagog, psikolog dhe defektolog), asistentët personal dhe pedagogjik në dhënien e ndihmës dhe përkrahjes përkatëse ndaj të gjithë participuesve në procesin e inkluzionit (nxënësit, mësimdhënësit, prindërit).

Qëllimi i hulumtimit është të detektojë qëndrimet dhe mendimet e mësimdhënësve, bashkëpunëtorët profesional (defektologët, psikologët, pedagogët) dhe drejtorët e shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut për komponentet e rëndësishme të cilat kontribuojnë për arsim inkluziv cilësor në shkollat fillore, edhe atë:

- struktura e ekipit të inkluzionit me përfshirjen e anëtarëve të cilët janë të paraparë në Ligjin për arsimin fillor;

- programin e punës dhe planifikimin aksional të ekipit;
- procedura dhe formulari i përgatitur për planin arsimor individual (PAI) dhe procedura për monitorimin e përparimit/ rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual;
- trajnimi i mësimdhënësve për përgatitjen e planit arsimor individual dhe të diferencuar, qasje e individualizuar në punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA);
- fusha e përfshirjes të një asistenti personal dhe një asistenti pedagogjik në procesin e inkluzionit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- burimet e nevojshme për një realizim më të suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollat fillore të rregullta.

Hulumtimi i gjendjes të inkluzionit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin fillor padyshim ka një rëndësi për përcaktimin e nevojës për një sistematizim dhe konkretizim të kompetencave dhe standardeve për asistent personal dhe pedagogjik dhe zbërthimin e tyre nga kompetencat dhe standardet kryesore për bashkëpunëtorin profesional-defektolog, i cili do të kontribuojë për punën më cilësore edukative - arsimore me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, si dhe përforcimin e punës ekipore ndërmjet anëtarëve të ekipit të inkluzionit.

Njëherësh, puna e bashkëpunëtorëve profesional (pedagogu, psikologu dhe defektologu) është sublimuar në dokumentin „Kompetencat themelore profesionale dhe standardet për bashkëpunëtorët profesional" implementuar nga Qendra maqedonase për arsim qytetar, në bashkëpunim me Byronë e zhvillimit të arsimit, si dhe në Ligjin e arsimit fillor.

Hulumtimi, në fakt është në drejtim të marrjes së një pasqyre subjektive për gjendjen e arsimit inkluziv nga aspekti i përfshirjes të burimeve arsimore të nevojshme për ndihmë dhe përkrahje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore të rregullta[58] dhe të jep përgjigje përkatëse për projeksionet e ardhshme në lidhje me zhvillimin e kompetencave profesionale të defektologut, asistentit personal dhe atij pedagogjik,shikuar nga prizma e zhvillimit të akteve dhe nënakteve ligjore, me qëllim të përparimit të arsimit inkluzivdhe përforcimit të funksionalitetit të punës ekipore, eksterne ndërmjet ekipeve dhe interne ndërmjet anëtarëve të ekipit konkret.

Në bazë të kësaj **lëndë e** hulumtimit janë burimet kadrovike dhe organizative për ndihmë dhe përkrahje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore të rregullta**,** me theks për ekipin inkluziv të shkollës dhe pjesëmarrjes së punëtorëve profesional (pedagog, psikolog dhe defektolog), asistent personal dhe pedagogjik në dhënien e ndihmës përkatëse

58 Përdorimi i konceptit fëmijë me nevoja të veçanta arsimore bazohet në ripërdorimin e tij në shumë vende të botës, duke iu referuar fëmijëve të talentuar, me pengesa dhe fëmijëve të kulturave të bashkësive të ndryshme (multikulturore). Arsimi inkluziv i fëmijëve të talentuar nuk përfshihet me këtë hulumtim.

dhe përkrahje ndaj të gjithë participuesve në procesin inkluziv (nxënës, mësimdhënës, prindër), si dhe zbërthimin e kompetencave të bashkëpunëtorit profesional-defektolog dhe asistentit pedagogjik-defektolog, që paraqet risi në konceptin aktual të arsimit inkluziv në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Duke u nisur nga një **lëndë** e tillë e përcaktuar, hulumtimi do të përqëndrohet në:

1.1. ANALIZA E DOKUMENTEVE LIGJORE

nga fusha e kompetencave profesionale të bashkëpunëtorëve profesional me theks të veçantë të bashkëpunëtorit profesional - defektolog në shkollat fillore të rregullta:

- „Kompetencat themelore profesionale dhe standardet për bashkëpunëtorët profesional" implementuar nga Qendra maqedonase për arsim qytetar në bashkëpunim me Byronë e zhvillimit të arsimit;
- Ligji për arsimin fillor;
- Ligji për Byronë e zhvillimit të arsimit;
- Ligji për inspektimin e arsimit.

1.2. ANALIZA E DOKUMENTEVE NACIONALE DHE PROGRAMORE

në të cilat bazohet arsimi inkluziv:

- Strategjia për zhvillimin e arsimit gjatë vitit 2005-2015;
- Strategjia për arsimin gjatë vitit 2018-2025;
- Analiza e qëllimeve për kompetencat e bashkëpunëtorit profesional - defektolog në shkollat fillore të rregullta.

1.3. ANALIZA E STRUKTURËS DHE ORGANIZIMI I PUNËS

në shkollat fillore të rregullta në:

- përmbledhja e numrit të nxënësve me pengesa, nxënësve me pengesa me udhëzim (diagnozë) dhe mendim, numri i nxënësve të talentuar, numri i nxënësve romë me pengesa, nxënësve të përkatësisë rome me pengesa me diagnozë dhe udhëzim, numri i nxënësve romë të talentuar, numri i nxënësve romë me vështirësi në mësim, numri i nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet plani arsimor individual. Shqyrtimi i përgjithshëm është sistematizuar sipas klasave dhe gjuhës mësimore ku mësojnë nxënësit që janë të përfshirë në hulumtim;
- përbërja, programi për punë dhe plani aksional i Ekipit të inkluzionit të shkollës (EISH);
- procedura e përpunuar dhe formulari për përgatitjen e planit arsimor individual;
- procedura e përpunuar dhe formulari për monitorimin e përparimit/rezultateve të nxënësit i cili punon sipas planit arsimor individual;
- kapaciteti, gatishmëria e mësimdhënësve për përgatitjen dhe përdorimin e planit arsimor individual;
- kapaciteti i mësimdhënësve për përdorimin e diferencimit në mësim;
- përfshirja e personave për ndihmë dhe përkrahje të nxënësve (asistent personal dhe pedagogjik) relacioni me nxënësin, mbikëqyrje në profesionin e tyre, organi dhe burimi i angazhimit të tyre dhe financimi, segmentet dhe etapat e procesit edukativo-arsimor ku përfshihen këta, intervali kohor i përfshirjes dhe inkuadrimi i fëmijëve të nxënësve me të cilët punojnë;

- hulumtimi i qëndrimeve dhe mendimeve të drejtorëve të shkollave fillore për një profil më përkatës i cili mund të jep përkrahje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, në cilësinë e asistentit personal dhe pedagogjik, mundësitë për përmirësimin e punës të ekipit të inkluzionit dhe burimet e nevojshme për realizimin më të suksesshëm të arsimit inkluziv në të gjitha shkollat fillore të rregullta në vend.

1.4. SHQYRTIMI I QËNDRIMEVE DHE MENDIMEVE TË MËSIMDHËNËSVE për rolin e tyre në:

- përgatitjen dhe monitorimin e realizimit të planit arsimor individual (PAI);
- zbatimin e diferencimit në punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- përshtatjen e kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa;
- monitorimin e arritjeve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- përkrahjen të cilën e marrin nxënësit nga nga bashkëpunëtorët profesional (pedagogu, psikologu, defektologu).

1.5. SHQYRTIMI I QËNDRIMEVE DHE MENDIMEVE TË MËSIMDHËNËSVE për:

- bashkëpunimin me asistentët personal dhe pedagogjik;
- ndihmën dhe përkrahjen të cilën e marrin nxënësit nga asistentët personal dhe ato pedagogjik në shkollë.

1.6. SHQYRTIMI I QËNDRIMEVE DHE MENDIMEVE TË BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL SI pedagogu, psikologu dhe defektologu, për pjesëmarrje në:

- përgatitjen dhe monitorimin e realizimit të planit arsimor individual, kryesisht edhe qëndrimin për pjesëmarje personale në aktivitetin e theksuar;
- segmentet dhe etapat në procesin edukativo-arsimor në të cilat bashkëpunëtorët profesional janë përfshirë në dhënien e përkrahjes individuale ndaj nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- shqyrtimi i qëndrimeve dhe mendimeve të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore për bashkëpunimin e tyre të drejtpërdrejtë me asistentët personal dhe ata pedagogjik, nga aspekti i realizimit të detyrave të punës që kanë të bëjnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

2. PËRCAKTIMI I KONCEPTEVE THEMELORE TË PËRMBAJTURA NË TEMËN E HULUMTIMIT

Në këtë hulumtim përmbahen këto koncepte vijuese:

- Arsimi inkluziv
- Nxënës me nevoja të veçanta arsimore
- Ekipi inkluziv i shkollës (EISH) dhe Ekipi inkluziv i nxënësit (EIN)
- Bashkëpunëtorë profesional
- Asistenti pedagogjik
- Asistenti personal
- Kompetencat

Arsimi inkluziv

Arsimi inkluziv nënkupton përfshirjen e **të gjithë fëmijëve** në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore të shkollës. Kjo mundëson mjë qasje me të cilën përmbushen nevojat për mësimin e të gjithë fëmijëve në një sistem arsimor. Parimet e tij bazohen në të drejtat e Konventës për të Drejtat e Njeriut.

Arsimi inkluziv ka për qëllim krijimin e sistemeve të cilat janë fleksibile dhe ofrojnë përkrahje të mjaftueshme që të përmbushen nevojat e ndryshme të nxënlsve, me origjinë të ndryshme, në klasat dhe shkollat e rregullta. Ka shumë definicione, por thënë më thjesht arsimi inkluziv është proces cilësor edukativo-arsimor i cili për TË GJITHË fëmijët, si qytetarë të ardhshëm të shoqërisë inkluzive, nënkupton qasje, pjesëmarrje dhe suksese të arritura në bazë të potencialit individual.

Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

Nxënësit kanë pengesa gjatë mësimit nëse mësojnë me vështirësi në krahasim me shumicën e nxënësve të moshës së njëjtë, ose pengesë e cila i pengon në arritjet e tyre në krahasim me nxënësit të moshës së njëjtë.

Nocioni nevoja të veçanta arsimore përdoret edhe si nocion për nxënësit të cilëve iu nevojitet mësimi plotësues, sepse kanë mundësi të cilët janë në nivel shumë më të lartë nga moshatarët e tyre.

Ekipi inkluziv i shkollës (EISH) dhe ekipi inkluziv i nxënësit (EIN)

Në shkollë janë formuar një ekip inkluziv, i cili kujdeset për politikat inkluzive dhe praktikat në nivel të shkollës në përgjithësi, dhe ekipi inkluziv i nxënësit i cili punon sipas planit individual arsimor (PAI). Këto kanë një ndërlidhje reciproke në dy mënyra: EISH i kuptimëson dhe realizon aktivitetet në nivel të shkollës në tërësi dhe përkujdeset ato të harmonizohen dhe realizohen në punë, ndërsa ekipi inkluziv për nxënësit (EIN) në përqëndrimin e punës së tyre i kanë nxënësit konkret, përgatitjen dhe realizimin të PAI të tyre. Anëtari i ekipit inkluziv të shkollës (EISH) është edhe anëtar i ekipit të caktuar të inkluzionit për nxënësit (EIN), ose është përgjegjës për lidhjen me ekipet konkrete të inkluzionit për nxënësit.

Bashkëpunëtorët profesional

Bashkëpunëtorët profesional kompetent dijnë se si fëmijët mësojnë dhe zhvillohen dhe njëkohësisht i përkrahin të gjithë fëmijët. Dijnë se çdo fëmijë mund të arrijë maksimumin e vet në qoftë se i jepet mundësia përkatëse. Ndërmarrin aktivitete përkatëse për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në procesin arsimor dhe për pranimin e tyre në mënyrë përkatëse në kontekst të shkollës. Ata i trajtojnë nxënësit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, por i njohin dallimet individuale të tyre dhe i marrin në konsideratë në punën e tyre me ata. Pastaj, bashkëpunëtorët profesional e bazojnë punën në vrojtimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin për interesin

më të mirë të nxënësve, si dhe vlerësimin e vazhdueshëm në përparimin e njohurive të tyre, potencialin e tyre, pikat e forta, shkathtësitë dhe mjedisin familjar.

Bashkëpunëtorët profesional kanë njohuri dhe shkathtësi për punë individuale dhe grupore me nxënësit, me qëllim të nxitjes dhe mbështetjes së zhvillimit intelektuale dhe socioemocional të nxënësit, njohurinë dhe përparimin e tij.

Asistenti pedagogjik

Asistenti pedagogjik është anëtar profesional i kualifikuar nga kuadri i shkollës, i cili në punën me mësimdhënësit, nxënësit, familjet dhe bashkësinë, iu ndihmon fëmijëve të grupeve të margjinalizuara q t'i shfrytëzojnë të gjitha përparësitë e arsimit dhe t'i tejkalojnë vështirësitë me të cilat përballen gjatë shkollimit.

Asistenti personal

Asistent personal është personi i cili ndihmon në pjesën e nevojave personale të cilat i ka personi me nevoja të veçanta arsimore.

Kompetencat

Me kompetenca nënkuptojmë një sërë njohurish të fituara, aftësi, shkathtësi dhevlera profesionale, përkatësisht një njohuri të dëshmuar për të përdorur njohuritë dhe shkathtësitë në situata në mësimnxënie ose në punë.

3. QËLLIMI DHE KARAKTERI I HULUMTIMIT

3.1. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit është që të fitohet një pasqyrë objektive për gjendjen e arsimit inkluziv në shkollat fillore të rregullta në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga aspekti i përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, madje në përputhje të programit **,,Arsimi inkluziv në shkollat fillore'',** me theks të veçantë në përkrahjen e mësimit të nxënësve të përkatësisë etnike rome dhe nxënësve me vështirësi, të cilët janë përfshirë në shkollat fillore të rregullta, burimet momentale për ndihmë dhe përkrahje me të cilat disponojnë shkollat, trajnimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional (pedagog, psikolog dhe defektolog) për punë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, puna e ekipit inkluziv të shkollës dhe pjesëmarrja e bashkëpunëtorëve profesional dhe asistentëve pedagogjik në dhënien e ndihmës përkatëse dhe ndihmë ndaj të gjithë participuesve në procesin inkluziv (nxënësit, mësimdhënësit, prindërit). Njëherësh, të shqyrtohet nevoja e zbërthimit të kompetencave të defektologut-bashkëpunëtorit profesional dhe defektologut- asistentit pedagogjik, që paraqet risi në konceptin aktual të arsimit inkluziv në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3.2. KARAKTERI I HULUMTIMIT

Sipas karakterit të tij ky hulumtim është:

- bashkëkohor, sepse merret me nevojat aktuale të përvojës inkluzive, për qasjen gjithpërfshirëse në arsimin inkluziv si segment me rëndësi të posaçme në sistemin edukativo-arsimor të përgjithshëm;
- përshkrues, cilësor dhe sasior.

Inspektimi dhe analiza e materialeve dhe dokumenteve të shkruara duhet të japë karakteristikën përshkruese të hulumtimit, ndërsa qasja cilësore dhe sasiore me teknikat përkatëse të hulumtimit do të mundësojë marrjen e të dhënave të rëndësishme për lëndën/temën e hulumtimit, me intencë për studimin më thelbësor të saj.

4. DETYRAT E HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit është konkretizuar përmes ***detyrave*** në vijim:

- ➔ të bëhet analizë e regullativës ligjore ekzistuese dhe dokumenteve programore në të cilat bazohet arsimi inkluziv në Republikën e Maqedonisë;
- ➔ të përcaktohet numri i nxënësve me pengesa, me vështirësi në mësim dhe nxënësit e talentuar, sipas klasave dhe përkatësisë etnike në shkollat fillore në shtet;
- ➔ të përcaktohet stafi i ekipit inkluziv në shkollë, programi dhe plani aksional për punë, procedura dhe formulari për përgatitjen e planit arsimor individual, procedurën e zhvilluar për monitorimin e përparimit/rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual;
- ➔ të përcaktohet trajnimi i mësimdhënësve për përpilimin dhe monitorimin e planit arsimor individual, zbatimi i diferencimit, përshtatja e kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa, ndjekja e arritjeve të tyre;
- ➔ të shqyrtohen qëndrimet e mësimdhënësve për një realizim sa më të suksesshëm të arsimit inkluziv;
- ➔ të përcaktohet përkrahja të cilën e marrin mësimdhënësit nga bashkëpunëtorët profesional në shkolë (pedagogu, psikologu dhe defektologu), e cila ka të bëjë me punën për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- ➔ të përcaktohen kompetencat e asistentëve personal dhe pedagogjik në dhënien e mbështetjes së nxënësve, përputhjes të profesionit të tyre,

angazhimit momental dhe disperzimit nëpër shkolla dhe segmentet në të cilat janë përfshirë për ndihmë dhe përkrahje ndaj nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;

- ➔ të shqyrtohet qëndrimi i bashkëpunëtorit profesional - pedagogut në lidhje me pjesëmarrjen në përpilimin dhe monitorimin e realizimit të planit arsimor individual, kryesisht edhe për pjesëmarrjet e tij të drejtpërdrejtë, intervalet kohore në të cilën realizohet përkrahja individuale e nxënësit dhe lloji i bashkëpunimit me asistentin personal dhe pedagogjik;
- ➔ të shqyrtohet qëndrimi i bashkëpunëtorit profesional – psikologut në lidhje me pjesëmarrjen në përpilimin dhe monitorimin e realizimit të planit arsimor individual, kryesisht edhe për pjesëmarrjet e tij të drejtpërdrejtë, intervalet kohore në të cilën realizohet përkrahja individuale e nxënësit dhe lloji i bashkëpunimit me asistentin personal dhe pedagogjik;
- ➔ të shqyrtohet qëndrimi i bashkëpunëtorit profesional – defektologut në lidhje me pjesëmarrjen në përpilimin dhe monitorimin e realizimit të planit arsimor individual, kryesisht edhe për pjesëmarrjet e tij të drejtpërdrejtë, intervalet kohore në të cilën realizohet përkrahja individuale e nxënësit dhe lloji i bashkëpunimit me asistentin personaldhe pedagogjik;

5. HIPOTEZAT E HULUMTIMIT

5.1. HIPOTEZA E PËRGJITHSHME

Kuadri edukativo-arsimor në shkollat fillore të rregullta konsideron se burimet e nevojshme (kadrovike dhe organizative për përforcimin e kapaciteteve për arsimin inkluziv) janë deficitar sasior dhe cilësor, ndërsa realizimi i punës edukative-arsimore me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore pengohet apo vështirësohet nga më shumë faktorë dhe shkaqe.

5.2. HIPOTEZAT E POSAÇME

- ◆ Në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullativa e konceptit të inkluzionit arsimor e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore bazohet në përvojat pozitive botërore, në dokumentet kryesore ndërkombëtare dhe konventat që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, të përshtatura në kontekstin tonë nacional dhe janë pjesë përbërëse e Ligjit për arsim fillor.
- ◆ Gjendja numerike e nxënësve me pengesa, me vështirësi në mësimnxënie dhe nxënësve të talentuar, sipas klasave dhe përkatësisë etnike në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut është interpretuar në mënyra të ndryshme.
- ◆ Ekipet inkluzive të shkollës në një numër të madh të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk korrespondojnë strukturisht me nenin 51 të Ligjit për arsim fillor sipas

të cilit ekipi inkluziv përbëhet nga pedagogu, përkatësisht psikologu i shkollës, mësimdhënësi i nxënësit, prindi, përkatësisht tutori i nxënësit, defektologu, nëse ka shkolla, dhe sipas nevojës mund të inkuadrohet edhe mjeku i nxënësit.

- Ekipet inkluzive shkollore në një numër të madh të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë përgatitur akte interne, procedura dhe protokolle për punën e tyre (programin dhe planin aksional për punën e tyre, kanë përgatitur procedurat dhe formular për përpilimin e planit arsimor individual për punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe kanë hartuarprocedurë për monitorimin e përparimit/rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual).
- Mësimdhënësit e shkollave fillore një numër i madh i tyre nuk janë trajnuar për përgatitjen dhe monitorimin e planit arsimor individual, zbatimit të diferencimit, përshtatjes së kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa dhe monitorimit e arritjeve të tyre.
- Mësimdhënësit e shkollave fillore pjesërisht e marrin përkrahjen e nevojshme nga bashkëpunëtorët profesional në shkollë (pedagogu, psikologu dhe defektologu), e cila ka të bëjë për punën me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (marrin pjesë në definimin, përshtatjen dhe shqyrtimin e qëllimeve nga plani arsimor individual, në vlerësimin e aftësive psiko-fizike dhe mundësitë e nxënësve me nevoja të kufizuara, në përkrahje të mësimdhënësve në monitorimin e realizimit të planit arsimor individual).
- Asistentët personal dhe ata pedagogjik nuk kanë kompetenca të dallueshme në përkrahjen të cilën ua japin nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.
- Nuk ekzistojnëkompetenca profesionale dhe standarde të definuara qartë për asistentët personal dhe pedagogjik në dhënien e përkrahjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.
- Përkrahjen individuale të cilën nxënësit me nevoja të veçanta arsimore e marrin nga bashkëpunëtorët profesional (pedagogët, psikologët dhe defektologët) në të gjitha segmentet e procesit edukativo-arsimor (gjatë orës mësimore, pushimit, aktiviteteve jashtëmësimore, aktiviteteve të lira të nxënësve, mësimit plotësues) në mënyrë kognitive dallohet varësisht nga kompetencat e posaçme të bashkëpunëtorëve profesional.
- Bashkëpunimin të cilin bashkëpunëtorët profesional (pedagogët, psikologët dhe defektologët) e kanë me asistentët personal dhe pedagogjik në mënyrë sasiore dallohet varësisht nga kompetencat e posaçme të bashkëpunëtorëve profesional.

6. VARIABLAT E HULUMTIMIT

6.1. VARIABLAT E PAVARURA

Dukuritë që ndryshojnë dhe paraqiten në vlera ose në kategori të ndryshme duke marrë parasysh individualitetet e mësimdhënësve, pedagogëve, psikologëve, defektologëve dhe drejtorëve në shkollat fillore.

6.1. VARIABLAT E PAVARURA

Qëndrimet dhe mendimet e mësimdhënësve, pedagogëve, psikologëve, defektologëve dhe drejtorëve në shkollat fillore në lidhje me përbërjen, programin dhe planin aksional për punën e ekipit inkluziv në shkollë, procedurën dhe formularin për përpilimin e planit arsimor individual, procedurën për monitorimin e përparimit (rezultateve) të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual, trajnimin e mësimdhënësve për përpilimin dhe monitorimin e planit arsimor individual, zbatimin e diferencimit, përshtatja ndaj kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa, monitorimin e arritjeve të tyre, përkrahjen të cilën e marrin nga nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, konceptet e asistentëve personal dhe pedagogjik në përkrahjen e nxënësve, angazhimi momental dhe disperzimin nëpër shkolla dhe segmentet në të cilat janë të përfshira për ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, intervalet kohore në të cilat realizohet përkrahja individualee nxënësit dhe llojii bashkëpunimit me asistentin pedagogjik dhe personal.

7. METODAT, TEKNIKAT DHE INSTRUMENTET E HULUMTIMIT

7.1. METODAT E HULUMTIMIT

Për nevojat e hulumtimit një zbatim i posaçëm do të hasë në më shumë metoda.

- **Analiza e përmbajtjes** – do të zbatohet në analizën e burimeve të literaturës nga vendi dhe ato të jashtme.
- **Analiza krahasuese** – do të përdoret me qëllim që të bëhet një përzgjedhje e pjesërishme e sasisë dhe cilësisë dhe një analizë e të dhënave të përmbledhura me qëllim që të bazohen faktet relevante në bazë të fakteve për të konfirmuar ose mohuar hipotezën.
- **Metoda induktive-deduktive** - do të përdoren për të nxjerrë përfundime nga pikëpamjet dhe mendimet teorike mbi gjendjen konkrete të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- **Metoda përshkruese** – do të aplikohet për krahasimin cilësor, studimin dhe krahasimin e të dhënave të mbledhura, si dhe kundërshtimin, vlerësimin dhe interpretimin e tyre, me qëllim përmirësimin e njohurive shkencore.

7.2. TEKNIKAT HULUMTUESE

- **Analizë** e dokumentacionit
- **Anketimi** – do të aplikohet për konfirmimin e të dhënave objektive për statusin personal e të anketuearve (shkalla e arsimit, vitet e përvojës së punës, gjinia, profesioni), ekzaminimi i mendimit, qëndrimet subjektive, gjykatat dhe interesat.

7.3. INSTRUMENTET

Nga instrumentet në hulumtim do të përdoren tre pyetësorë, edhe atë:

- **Pyetësor për shkollën** (Shtojca 1)
- **Pyetësor për mësimdhënësin** (Shtojca 2)
- **Pyetësor për pedagogun/psikologun/defektologun** (Shtojca 3).

Tre pyetësorët përmbajnë pyetje të tipit të hapur, të mbyllur dhe të kombinuar, të cilat në aspektin e llojit të përgjigjeve të ofruara janë alternative, përzgjedhëse dhe pyetje që kërkojnë të dhëna të inventarit.

Pyetësori i parë përmban gjithsej 23 pyetje të llojit të ndryshëm, përkatësisht pohime, pyetësori i dytë përmban 15 pyetje dhe pyetësori i tretë 14 pyetje.

Të tre pyetësorët janë anonim me plotësimin elektronik dhe dorëzimin në mënyrë që të mbledhin sa më shumë të dhëna të besueshme që të jetë e mundur. Të dhënat e marra gjatë anketës janë analizuar dhe konkluzionet janë përmbledhur.

Me realizimin e këtij hulumtimi duhet të konfirmohen hipotezat e posaçme dhe të konfirmohet se vallë burimet kadrovike dhe organizative për ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e rregullta në Republikën e Maqedonisë së Veriut, janë sasiore dhe cilësore në nivelin e duhur, përkatësisht vallë i përmbushin kërkesat elementare të cilat i imponon procesi i inkluzionit.

Për zhvillimin e instrumenteve në hulumtim u përdor një shkallë e shkallëzimit të pikëpamjeve të llojit Likert.

8. EKZEMPLARI I HULUMTIMIT

Në hulumtimin janë përfshirë gjithsej 367 shkolla fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në 293 shkolla mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, ndërsa në 74 shkolla mësimi realizohet në gjuhën shqipe.

Ekzemplari i përgjithshëm i mësimdhënësve që iu përgjigjën pyetësorit është 739 mësimdhënës. Prej tyre 262 janë mësimdhënës klasor, ndërsa 477 mësimdhënës lëndor.

Ekzemplari i bashkëpunëtorëve profesional që iu përgjigjën pyetësorit është 335 bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prej të cilëve 141 janë pedagogë, 130 psikologë dhe 64 defektologë (edukatorë special dhe rehabilitues).

Hulumtimi në shkollat fillore të përmendura është realizuar gjatë muajit Maj dhe Qershor të vitit 2018, me ç'rast Byroja e zhvillimit të arsimit me ndihmën e sistemit elektronik për menaxhim të mësimit (Learning Management System-LMS) parashtroi një version elektronik të pyetësorit për mësimdhënës (Shtojca 1) në shkollat fillore (sipas adresave elektronike në bazën e të dhënave në ditarin elektronik). Gjithashtu, një pjesë e të dhënave të nevojshme për këtë hulumtim, u përmblodhën dhe u përpunuan në formë elektronike me aplikimin e sistemit elektronik Survey monkey.



9. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA HULUMTIMI

Karakteri i hulumtimit, karakteristikat e ekzemplarit, teknikat dhe instrumentet hulumtuese të parapara ofrojnë aplikimin e përpunimit cilësor dhe sasior e të dhënave të fituara.

9.1. Në mënyrë cilësore u përpunuan të dhënat e fituara nga analiza e rregullativës ligjore dhe dokumentet tjera relevante strategjike për problemin hulumtues (Rregullore për kompetencat kryesore profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme, Regullore për kompetencat kryesore profesionale sipas fushave të bashkëpunëtorit professional në shkollat fillore dhe të mesme, dokumente nacionale dhe ndërkombëtare, akte ligjore dhe nënligjore nga fusha e arsimit inkluziv) si dhe të dhënat e fituara përmes pyetjeve të hapura dhe të kombinuara nga vetë instrumentet (Pyetësor për drejtorin, Pyetësor për mësimdhënësin dhe Pyetësor për bashkëpunëtorin profesional).

9.2. Në mënyrë sasiore u përpunuan të dhënat e fituara përmes pyetjeve alternative dhe të përzgjedhura, të përfshira në vetë pyetësorët/instrumentet (Pyetësor për drejtorin, Pyetësor për mësimdhënësin dhe Pyetësor për bashkëpunëtorin professional).

Për analizën e rezultateve të fituara dhe testimin e hipotezave të parashtruara u përdor procedura statike: shpërndarja e frekuencës së përcaktuar (f), përqindja (%).

10. ORGANIZIMI DHE VIJIMI I HULUMTIMIT

Hulumtimi u realizua në etapa gjatë intervalit kohor maj-dhjetor 2018 dhe realizohej sipas aktiviteteve të numëruara:

- hartimi i planit aksional për hulumtim;
- delegimi i detyrimeve ndërmjet anëtarëve të ekipit hulumtues;
- analizë e dokumenteve ligjdhënëse dhe strategjike të cilat e trajtojnë problematikën e arsimit inkluziv në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- analizë e literaturës profesionale kompatibile të problemit hulumtues;
- elaborimi teorik i problemit hulumtues;
- përgatitja dhe realizimi i instrumenteve hulumtuese;
- informimi dhe kërkimi i pëlqimit nga drejtori i Byrosë së zhvillimit të arsimit për realizimin e hulumtimit;
- informimi i shkollave fillore në lidhje me hulumtimin;
- përpunimi sasior dhe cilësor i të dhënave të fituara;
- analizë dhe interpretim të rezultateve të fituara nga hulumtimi;
- njohuritë përmbyllëse;
- përgatitja e raportit dhe dërgimi i tij në institucionet kompetent

PJESA III

ANALIZA DHE INTERPRETIMI I RESURSEVE NGA HULUMTIMI



Në këtë pjesë të hulumtimit do të bëhet analiza e të dhënave të fituara nga drejtorët, mësimdhënësit, pedagogët, psikologët dhe defektologët në mënyrë që të arrihet një pasqyrë objektive e gjendjes në arsimin inkluziv në shkollat fillore të rregullta në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga aspekti i përfshirjes së nxënësve me me nevoja të veçanta arsimore, resurset momentale për ndihmë dhe përkrahje me të cilat disponojnë shkollat, trajnimi i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional (pedagogu, psikologu dhe defektologu) për punë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, puna e ekipit arsimor inkluziv dhe pjesëmarrja e bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve personal dhe pedagogjik në dhënien e ndihmës përkatëse dhe përkrahje ndaj të gjithë participuesve në procesin e inkluzionit (nxënësit, mësimdhënësit, prindërit). Njëherësh, të shqyrtohet nevoja e përkufizimit të kompetencave të defektologut – bashkëpunëtorit profesional dhe defektologut – asistentit pedagogjik që paraqet risi në konceptin aktual të arsimit inkluzivnë Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1. ANALIZA E DOKUMENTACIONIT

Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese e dokumenteve kryesore ndërkombëtare në të cilat bazohet koncepti i inkluzionit në arsim. Disa nene të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si dhe dokumente dhe konventa të tjera lidhur me të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore janë pjesë përbërëse e Ligjit për arsimin fillor.[59]

Në ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut theksohet kujdesi për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, kështu që në nenin 2 të Ligjit për arsimin fillor theksohet se „secili fëmijë ka të drejtë për arsim fillor", përderisa, gjithashtu, në nenin 3 të ligjit të njëjtë, përveç tjerash, theksohet se roli i arsimit fillor është përfshirja dhe përkujdesi për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

59 Ligji për arsimin fillor, tekst i konsoliduar, neni 51paragrafi 2. http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-24-06-34-40/zakoni

Me nenin 42 pika 9 të Ligjit për arsimin fillor përcaktohet e drejta e shkollës për të angazhuar defektolog për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Në bazë të nenit 51 të Ligjit për arsimin fillo, prindi ka të drejtë fëmijën me nevoja të veçanta arsimore ta regjistrojë në shkollë fillore, prej ku del edhe e drejta e fëmijës me nevoja të veçanta arsimore të përfshihet dhe të trajtohet njësoj me fëmijët tjerë, në përputhje me ligjet dhe dispozitat në fuqi.

Në nenin 24 të Konventës së KB për të drejtat e personave me invaliditet[60] vendet nënshkruese e pranojnë të drejtën e arsimimit të këtyre personave pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta sigurojnë sistemin e përfshirjes së arsimit në të gjitha nivelet dhe mësimit të përjetshëm.

Gjatë realizimit të kësaj të drejte, vendet nënshkruese të kësaj konvente, mes tjerash, sigurojnë personat me invaliditet ta marrin përkrahjen e nevojshme në kuadër të sistemit arsimor të përgjithshëm, që të thjeshtëzohet arsimi i tyre efektiv.

Neni 26 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut[61] përmban parimin që secili ka të drejtën e arsimit, ndërsa prindërit kanë të drejtën parësore të përzgjedhin llojin e arsimit për fëmijët e tyre.

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor të rregullt nënkupton inkluzion të plotë në punën dhe jetën e përgjithshme në shkollë.

Ky proces preferon mundësinë e më shumë kushteve për një inkluzion të suksesshëm në mesin e të cilave edhe mundësinë për sigurimin e qasjes ekipore gjatë zgjidhjes së problemeve dhe përmbushjen e nevojave në shkollë.

Për këtë qëllim, në bazë të nenit 51 pika 2 të Ligjit për arsim fillor, për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të regjistruar në shkollat fillore të rregullta, shkolla formon ekipin inkluziv në përbërje të pedagogut, përkatësisht psikologut të shkollës, mësimdhënësit të nxënësit, prindit, përkatësisht tutorit të nxënësit, defektologut nëse ka në shkollë dhe sipas nevojës mund të përfshihet edhe mjeku i nxënësit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullativa e procesit të inkluzionit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore është bazuar në përvojat pozitive botërore të përshtatura në kontekstin tonë nacial.

Parimi i arsimit për të gjithë e pranon të drejtën e arsimit përkatës në përputhje me mundësitë e fëmijëve dhe të rinjve pa marr parasysh shkallën e pengesës së tyre ose nevojën sociale.

Përpjekjet e arsimit për të gjithë nënkupton inkuadrimin e fëmijëve në shkollat e rregullta me pengesa të lehta dhe të vështira në zhvillim të cilët nuk kanë aftësi shkollore, por parashikon mundësinë dhe nevojën e

60 http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf

61 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut („Gazeta zyrtare e RM" nr. 57/93)

organizimit të modeleve përkatëse të mësimit në funksion të socializimit, që paraqet obligim shoqëror dhe e drejtë natyrore e këtyre fëmijëve.

Njëra nga masat e përfshira në pjesën ,,Arsimi'' nga Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara (2010-2018) ka të bëjë me punën e drejtpërdrejtë edukative-arsimore me nxënësit me nevoja të veçanta, e cila duhet të jetë e individualizuar, e kahëzuar nga defektologu dhe ekipi profesional në shkollë. Theksohet se për këtë qëllim nevojitet përfshirje e detyrueshme e defektologëve në sistemin e rregullt të arsimit, si dhe në klasat për arsim në vetqeverisjen lokale. Në dokumentin ,,Indikatorët për cilësi të punës në shkollë''[62] të Inspektoratit shtetëror të arsimit ekzistojnë disa tregues që i referohen arsimit inkluziv.

Në kompetencat kryesore profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme[63] në fushën e inkluzionit social dhe arsimor është dhënë përshkrimi i kompetencave që kanë të bëjnë në njohjen e mësimdhënësit për kompetenca dhe modele të ndryshme për arsimin inkluziv, konventat për të drejtat e fëmijëve dhe kundërdiskriminuese, llojet e ndryshme të nxënësve të cilëve iu nevojitet përkrahja plotësuese në arsim: nevojat e veçanta arsimore, vështirësi në mësim dhe ngecje nga shkaqet socio-ekonomike, si dhe kuptimin e faktorëve social dhe kulturor dhe mënyra në të cilën ato ndikojnë në arsim dhe kohezioni social.

Në kompetencat themelore profesionale dhe standardet për bashkëpunëtorët profesional[64] përfshihen kompetencat për arsimin inkluziv në fusha të ndryshme në punën e bashkëpunëtorëve profesional, ndërsa e drejta e barazisë, inkluzionit dhe sociales janë një nga vlerat prej të cilave zhvillohen në punën e tyre profesionale.

Kjo konfirmon hipotezën e veçantë 1:

„Në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullativa e konceptit e inkluzionit arsimor të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore bazohet në përvojat pozitive botërore, në dokumentet kryesore ndërkombëtare dhe në konventat e ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës me nevoja të veçanta arsimore, të përshtatura në konceptin tonë nacional dhe janë pjesë përbërëse e Ligjit për arsimin fillor".

62 Treguesit e cilësisë së punës të shkollave, http://dpi.mon.gov.mk/index.php/regulations/pravilnici/119-2016-01-26-12-38-42

63 Rregullorja për kompetencat themelore profesionale të mësimdhënësvenë shkollat fillore dhe të mesme sipas lëmive, ,,Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/15

64 Rregullorja për kompetencat themelore profesionale sipas lëmive të bashkëpunëtorëve professional në shkollat fillore dhe të mesme http://www.mon.gov.mk/images/Osnovni_profesionalni_kompetencii_MON.pdf

2. TË DHËNAT E MARRA NGA ANKETIMI I DREJTORËVE TË SHKOLLAVE FILLORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Ekzemplarin e përbëjnë gjithsej 367 shkollat fillore, ndërsa 293 drejtorë i janë përgjigjur pyetësorit në gjuhën maqedonase dhe 74 në gjuhën shqipe.

2.1. INDIKATORËT PËR PËRQINDJEN E NXËNËSVE TË CILËT MËSOJNË NË GJUHËN MAQEDONASE NË MËSIMIN KLASOR

Në paraqitjen tabelare (tabela 1) është dhënë përqindja e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor për secilën klasë sipas: përfshirja e nxënësve romë, nxënësit me vështirësi në mësimnxënie, nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie, numri i nxënësve të talentuar, numri i nxënësve romë të talentuar, numri i nxënësve me pengesa, numri i nxënësve me pengesa me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve romë me pengesa, numri i nxënësve romë me pengesa dhe me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet plani arsimor individual.

Nga analiza e të dhënave vërehet se nga nxënësit të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor, me përqindje më të madhe 8,27 % përfshihen nxënësit me vështirësi në mësim dhe nxënësit që kanë prirje dhe talent me 7,18 %. Nëse bëhet krahasimi i numrit të nxënësve me pengesa me udhëzim dhe mendim arrin përqindjen 1,76 % me numrin e nxënësve për të cilët përgatitet PAI me përqindje 2,01 %, do të konstatohet se PAI përgatitet edhe për nxënësit të cilët nuk kanë rekomandim nga mjeku, udhëzim dhe mendim.

Tabela 1: Struktura e ekzemplarit të nxënësve prej klasës I – V në gjuhën maqedonase

Nxënësit me NVA	I	II	III	IV	V	Gjithsej
Nxënësit romë	3,35	3,49	2,86	2,2	2,47	**14,37**
Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie	1,41	2,06	1,95	1,53	1,32	**8,27**
Nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie	0,53	0,77	0,77	0,53	0,46	**3,06**
Nxënësit e talentuar	0,84	1,13	1,44	1,67	2,1	**7,18**
Nxënësit romë të talentuar	0,05	0,05	0,08	0,06	0,12	**0,36**
Nxënësit me pengesa	0,46	0,52	0,54	0,61	0,49	**2,62**
Nxënësit me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,27	0,37	0,38	0,37	0,37	**1,76**
Nxënësit romë me pengesa	0,07	0,05	0,07	0,06	0,06	**0,31**
Nxënësit romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,01	0,04	0,04	0,02	0,01	**0,12**
Nxënësit për të cilët përgatitet PAI	0,28	0,38	0,44	0,48	0,43	**2,01**
Nxënësit romë për të cilët përgatitet PAI	0,04	0,03	0,05	0,07	0,06	**0,25**

2.2. INDIKATORËT PËR PËRQINDJEN E NXËNËSVE TË CILËT MËSOJNË NË GJUHËN MAQEDONASE NË MËSIMIN LËNDOR

Në paraqitjen tabelare (tabela 2) është dhënë përqindja e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin lëndor për secilën klasë sipas: përfshirja e nxënësve romë, nxënësit me vështirësi në mësimnxënie, nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie, numri i nxënësve të talentuar, numri i nxënësve romë të talentuar, numri i nxënësve me pengesa, numri i nxënësve me pengesa me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve romë me pengesa, numri i nxënësve romë me pengesa dhe me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet plani arsimor individual.

Nga analiza e të dhënave vërehet se në mësimin lëndor me përqindje më të madhe ose 9,11% përfshihen nxënësit e talentuar, ndërsa, përfshirja e nxënësve me vështirësi

Tabela 2: Struktura e ekzemplarit të nxënësve prej klasës VI - IX. në gjuhën maqedonase

Nxënësit me NVA	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
Nxënësit romë	2,69	2,41	2,55	2,62	**10,27**
Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie	1,31	1,12	1,10	1,05	**4,58**
Nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie	0,45	0,3	0,31	0,24	**1,30**
Nxënësit e talentuar	1,8	2,1	2,47	2,74	**9,11**
Nxënësit romë të talentuar	0,08	0,06	0,07	0,1	**0,31**
Nxënësit me pengesa	0,44	0,41	0,44	0,3	**1,59**
Nxënësit me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,35	0,31	0,38	0,24	**1,28**
Nxënësit romë me pengesa	0,09	0,07	0,05	0,03	**0,24**
Nxënësit romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,05	0,02	0,01	0,02	**0,10**
Nxënësit për të cilët përgatitet PAI	0,43	0,34	0,37	0,26	**1,40**
Nxënësit romë për të cilët përgatitet PAI	0,08	0,04	0,01	0,05	**0,18**

në mësim është 4,58 %, që është shumë më e vogël krahasuar me mësimin klasor ku gjendja numerike e nxënësve me vështirësi në mësim është 8,27 %. Mesiguri ky dallim ka të bëjë me procesin e përshtatjes të nxënësve në klasat fillestare, përkatësisht bëhet fjalë për vështirësinë e përkohshme. Nëse bëhet krahasimi i numrit të nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe i cili është 1,28 % me numrin e nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual i cili është 1,40 %, do të konstatohet se edhe në mësimin lëndor plani arsimor individual përgatitet edhe për nxënësit të cilët nuk kanë udhëzim dhe mendim.

2.3. INDIKATORËT PËR PËRQINDJEN E NXËNËSVE TË CILËT MËSOJNË NË GJUHËN SHQIPE NË MËSIMIN KLASOR

Tabela 3: Struktura e ekzemplarit të nxënësve prej klasë I - V në gjuhën shqipe

Nxënësit me NVA	I	II	III	IV	V	Gjithsej
Nxënësit romë	0,09	0,21	0,23	0,13	0,13	**0,79**
Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie	0,63	0,99	1,02	0,79	1,03	**4,46**
Nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie	0,01	0,03	0,04	0	0	**0,08**
Nxënësit e talentuar	1,24	1,37	1,45	1,63	1,84	**7,53**
Nxënësit romë të talentuar	0	0,01	0	0	0	**0,01**
Nxënësit me pengesa	0,19	0,26	0,33	0,22	0,21	**1,21**
Nxënësit me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,15	0,13	0,17	0,12	0,17	**0,74**
Nxënësit romë me pengesa	0	0,02	0	0	0	**0,02**
Nxënësit romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0	0,01	0	0	0	**0,01**
Nxënësit për të cilët përgatitet PAI	0,26	0,29	0,34	0,28	0,39	**1,56**
Nxënësit romë për të cilët përgatitet PAI	0	0,01	0	0,01	0	**0,02**

Në paraqitjen tabelare (tabela 3) është dhënë përqindja e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhën shqipe për mësimin klasor për secilën klasë sipas: përfshirja e nxënësve romë, nxënësit me vështirësi në mësimnxënie, nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie, numri i nxënësve të talentuar, numri i nxënësve romë të talentuar, numri i nxënësve me pengesa, numri i nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve romë me pengesa, numri i nxënësve romë me pengesa dhe me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet plani arsimor individual.

Nga analiza e të dhënave vërehet se me përqindje më të madhe 7,53 % janë përfshirë nxënësit e talentuar. Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie përfshihen me 4,46 % për

qind. Në qoftë se bëhet krahasimi i numrit të nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim është 0,74 % me numrin e nxënësve për të cilët përgatitet PAI është 1,56 %, do të konfirmohet konstatimi i njëjtë ashtu edhe për nxënësit të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor, përkatësisht se plani arsimor individual përgatitet edhe për nxënësit të cilët nuk kanë udhëzim dhe mendim.

2.4. INDIKATORËT PËR PËRQINDJEN E NXËNËSVE TË CILËT MËSOJNË NË GJUHËN SHQIPE NË MËSIMIN LËNDOR

Në paraqitjen tabelare (tabela 4) është dhënë përqindja e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhën shqipe në mësimin lëndor për secilën klasë: përfshirja e nxënësve romë, nxënësit me vështirësi në mësimnxënie, nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie, numri i nxënësve të talentuar, numri i nxënësve romë të talentuar, numri i nxënësve me pengesa, numri i nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve romë me pengesa, numri i nxënësve romë me pengesa dhe me udhëzim dhe mendim,

Tabela 4: Struktura e ekzemplarit të nxënësve prej klasës VI - IX në gjuhën shqipe

Nxënësit me NVA	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
Nxënësit romë	0,13	0,13	0,08	0,11	**0,35**
Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie	0,70	0,91	1,07	0,78	**3,46**
Nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie	0,03	0	0	0,03	**0,06**
Nxënësit e talentuar	1,86	1,71	1,88	2,08	**7,53**
Nxënësit romë të talentuar	1,06	1,02	0,99	1,17	**4,24**
Nxënësit me pengesa	0,10	0,06	0,08	0,15	**0,39**
Nxënësit me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,17	0,22	0,13	0,11	**0,63**
Nxënësit romë me pengesa	0	0	0,01	0,03	**0,04**
Nxënësit romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0	0	0	0	**0,00**
Nxënësit për të cilët përgatitet PAI	0,28	0,29	0,23	0,13	**0,93**
Nxënësit romë për të cilët përgatitet PAI	0	0	0,01	0,01	**0,02**

numri i nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet plani arsimor individual.

Nga analiza e të dhënave vërehet se me përqindje më të madhe 7,53 % janë përfshirë nxënësit e talentuar, numër identik me nxënësit e mësimit klasor të cilët mësojnë në gjuhën shqipe. Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie janë të përfshirë me 3,46 % për qind.

Në qoftë se bëhet krahasimi i numrit të nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim është 0,63 % me numrin e nxënësve për të cilët përgatitet PAI është 0,93 %, do të konfirmohet konstatimi i njëjtë ashtu edhe për nxënësit të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe në mësimin lëndor, përkatësisht se plani arsimor individual përgatitet edhe për nxënësit të cilët nuk kanë udhëzim dhe mendim.

Tabela 5: Struktura e ekzemplarit të nxënësve prej klasës I - IX në gjuhën maqedonase

Nxënësit me NVA	Numri i përgjithshëm i nxënësve prej klasës I-V në gjuhën maqedonase	Numri i përgjithshëm i nxënësve prej klasës VI-IX në gjuhën maqedonase	Numri i përgjithshëm i nxënësve prej klasës I-IX në gjuhën maqedonase
Nxënësit romë	0,13	0,13	0,08
Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie	0,70	0,91	1,07
Nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie	0,03	0	0
Nxënësit e talentuar	1,86	1,71	1,88
Nxënësit romë të talentuar	1,06	1,02	0,99
Nxënësit me pengesa	0,10	0,06	0,08
Nxënësit me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,17	0,22	0,13
Nxënësit romë me pengesa	0	0	0,01
Nxënësit romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0	0	0
Nxënësit për të cilët përgatitet PAI	0,28	0,29	0,23
Nxënësit romë për të cilët përgatitet PAI	0	0	0,01

2.5. INDIKATORËT PËR PËRQINDJEN E NXËNËSVE TË CILËT MËSOJNË NË GJUHËN MAQEDONASE NË MËSIMIN KLASOR DHE LËNDOR

Në paraqitjen tabelare (tabela 5) është dhënë përqindja e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor dhe në atë lëndor për secilën klasë, sipas: përfshirja e nxënësve romë, nxënësit me vështirësi në mësimnxënie, nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie, numri i nxënësve të talentuar, numri i nxënësve romë të talentuar, numri i nxënësve me pengesa, numri i nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve romë me pengesa, numri i nxënësve romë me pengesa dhe me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet plani arsimor individual.

Nga analiza përmbledhëse e indikatorëve shqyrtohet se në mësimin e përgjithshëm prej klasës I - IX me përqindje më të madhe ose 16,22 % janë përfshirë nxënësit e talentuar dhe ata me prirje, ndërsa, gjithashtu përfshirja e nxënësve me vështirësi në mësimnxënie arrinë 12,85 %.

Në qoftë se bëhet krahasimi i numrit të nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim i cili arrinë 3,04 % me numrin e nxënësve për të cilët përgatitet PAI i cili arrinë 3,41 %, do të konstatohet gjendja paraprake, përkatësisht se plani arsimor individual përgatitet edhe për nxënësit të cilët nuk kanë udhëzim dhe mendim.

Në krahasim të përqindjes së nxënësve romë të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor dhe lëndor përfshirja është 24,64 %, prej të cilëve me vështirësi në mësimnxënie janë 4,36 %, ndërsa me pengesa ai numër arrinë në 0,55 %.

Në bazë të analizës së bërë të këtyre parametrave mund të konstatohet se numri i nxënësve romë me vështirësi në mësimnxënie (4,36 %) krahasuar me numrin e përgjithshëm të nxënësve me vështirësi në mësimnxënie të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor dhe lëndor (12,85 %) përafërsisht është një e treta.

Në qoftë se bëhet krahasimi i numrit të nxënësve romë me pengesa në mësimnxënie e që arrinëa 0,55 % me numrin e përgjithshëm të nxënësve me pengesa është 4,21 %, mund të konstatohet se përfshirja e romëve me pengesa në mësimnxënie të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor dhe lëndor është pothuajse (9) herë më i ulët.

Rezultate të ngjashme janë marrë edhe gjatë krahasimit të bërë me nxënësit romë me pengesa në mësimnxënie e që arrinë 0,55 %, me nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie (4,36 %) ku gjithashtu, përfshirja e romëve me pengesa në mësimnxënie të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor dhe lëndor është pothuajse (9) herë më i ulët.

Gjendja e këtillë tregon se një numër i madh i nxënësve romë ose 4,36 %, të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor dhe lëndor ballafaqohen me vështirësi në mësimnxënie të cilët nuk i përkasin ndonjë lloji të pengesës.

Për këtë qëllim nevojitet të bëhet një analizë më e hollësishme për gjendjen e këtillë, të detektohen shkaqet të cilat shpiejnë deri te vështirësitë në mësimnxënie te nxënësit romë dhe të ndërmerren masa përkatëse për shmangien e tyre, me çka konfirmohet hipoteza e posaçme 2:

„Përqindja e nxënësve me pengesa, me vështirësi në mësimnxënie dhe nxënësve të talentuar, sipas klasave dhe përkatësisë etnike në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut është interpretuar ndryshe".

2.6. INDIKATORËT PËR PËRQINDJEN E NXËNËSVE TË CILËT MËSOJNË NË GJUHËN SHQIPE NË MËSIMIN KLASOR DHE LËNDOR

Në paraqitjen tabelare (tabela 6) është dhënë përqindja e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor për secilën klasë, sipas: përfshirja e nxënësve romë, nxënësit me vështirësi në mësimnxënie, nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie, numri i nxënësve të talentuar, numri i nxënësve romë të talentuar, numri i

Tabela 6: Struktura e ekzemplarit të nxënësve prej klasës I - IX në gjuhën shqipe

Nxënësit me NVA	Numri i për-gjithshëm i nxënësve prej klasës I-V në gjuhën shqi-pe	Numri i për-gjithshëm i nxënësve prej klasës VI-IX në gjuhën shqipe	Numri i për-gjithshëm i nxënësve prej klasës I-IX në gjuhën shqipe
Nxënësit romë	0,79	0,35	1,14
Nxënësit me vëshirësi në mësimnxënie	4,46	3,46	7,92
Nxënësit romë me vëshirësi në mësimnxënie	0,08	0,06	0,14
Nxënësit e talentuar	7,53	7,53	15,06
Nxënësit romë të talentuar	0,01	4,24	4,25
Nxënësit me pengesa	1,21	0,39	1,6
Nxënësit me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,74	0,63	1,37
Nxënësit romë me pengesa	0,02	0,04	0,06
Nxënësit romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,01	0	0,01
Nxënësit për të cilët përgatitet PAI	1,56	0,93	2,49
Nxënësit romë për të cilët përgatitet PAI	0,02	0,02	0,04

nxënësve me pengesa, numri i nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve romë me pengesa, numri i nxënësve romë me pengesa dhe me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet plani arsimor individual.

Nga analiza përmbledhëse e të dhënave vërehet se në mësimin e përgjithshëm prej klasës I - IX me përqindje më të madhe ose 15,06 % përfshihen nxënësit e talentuar dhe me prirje, madje, gjithashtu, përfshirja e nxënësve me vështirësi në mësim arrinë 7,92 %. Përfshirja e nxënësve të talentuar dhe nxënësit me prirje të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor pothuajse është i ngjajshëm, por dallimi vërehet në përfshirjen e nxënësve me vështirësi në mësim ku 12,85 % përfshihen në paralelet në gjuhën maqedonase kundrejt 7,92 % në paralelet me mësim në gjuhën shqipe. Ky dallim ka të bëjë, para së gjithash në përfshirjen e ndryshme të nxënësve romë në paralelet maqedonase dhe shqipe. Përfshirja në paralelet me mësim në gjuhën maqedonase është 24,64 %, ndërsa në paralelet me mësim në gjuhën shqipe është vetëm 1,14 %.

Në qoftë se bëhet krahasimi i numrit të nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim i cili është 1,37 % dhe numrit të nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual, i cili arrinë 2,49 %, do të konstatohet gjendja paraprake, përkatësisht se plani arsimor individual përgatitet edhe për nxënësit të cilët nuk kanë udhëzim dhe mendim.

Sa i përket numrit të nxënësve romë të cilët mësojnë në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor përfshirja është 1,14 %, prej të cilëve me vështirësi në mësim janë 0,14 %, ndërsa me pengesa numri arrinë në 0,06 %.

Në bazë të analizës së bërë të këtyre parametrave mund të konstatohet se përqindja e nxënësve romë me vështirësi në mësimnxënie i cili është 0,14 % krahasuar me numrin e përgjithshëm të nxënësve me vështirësi në mësimnxënie të cilët mësojnë në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor është 7,92 % një përqindje e madhe. Ky dallim ka të bëjë me numrin e vogël të nxënësve romë të cilët mësojnë në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor, ose 1,14 %.

Në qoftë se bëhet krahasimi i numrit të nxënësve romë me vështirësi në mësimnxënie (0.14 %) me numrin e përgjithshëm të nxënësve romë të cilët ndjekin mësimin në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor është 1,14 %, mund të konstatohet se dallimi është 9 herë më i vogël krahasuar me numrin e nxënësve romë me vështirësi në mësimnxënie. Ky raport i parametrave është identik edhe te nxënësit romë me pengesa të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në mësimin klasor dhe lëndor. Duke pasur parasysh numrin e vogël të nxënësve romë të cilët mësojnë në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor, këto rezultate dhe raporte nuk kanë relevancë në marrjen e ndonjë konkluzioni.

2.7. INDIKATORËT PËR PËRQINDJEN E NXËNËSVE TË CILËT MËSOJNË NË GJUHËN MAQEDONASE DHE NË GJUHËN SHQIPE NË MËSIMIN KLASOR DHE LËNDOR

Tabela 7: Struktura e ekzemplarit të nxënësve prej klasës I - IX në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe

Nxënësit me NVA	Numri i përgjithshëm i nxënësve prej klasës I-IX në gjuhën maqedonase	Numri i përgjithshëm i nxënësve prej klasës I–IX në gjuhën shqipe	Numri i përgjithshëm i nxënësve prej klasës I–IX në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe
Nxënësit romë	24,64	1,14	25,78
Nxënësit me vështirësi në mësimnxënie	12,85	7,92	20,77
Nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie	4,36	0,14	4,50
Nxënësit e talentuar	16,22	15,06	31,28
Nxënësit romë të talentuar	0,49	4,25	4,74
Nxënësit me pengesa	4,21	1,6	5,81
Nxënësit me pengesa, me udhëzim dhe mendim	3,04	1,37	4,41
Nxënësit romë me pengesa	0,55	0,06	0,61
Nxënësit romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim	0,22	0,01	0,23
Nxënësit për të cilët përgatitet PAI	3,41	2,49	5,9
Nxënësit romë për të cilët përgatitet PAI	0,43	0,04	0,47

Në paraqitjen tabelare (tabela 7) është dhënë përqindja e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor për secilën klasë, sipas: përfshirja e nxënësve romë, nxënësit me vështirësi në mësimnxënie, nxënësit romë me vështirësi në mësimnxënie, numri i nxënësve të talentuar, numri i nxënësve romë të talentuar, numri i nxënësve me pengesa, numri i nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve romë me pengesa, numri i nxënësve romë me pengesa dhe me udhëzim dhe mendim, numri i nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual dhe numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet plani arsimor individual.

Nga analiza përmbledhëse e të dhënave vërehet se në mësimin e përgjithshëm prej

klasës I - IX me përqindje më të madhe 31,28 %, sipas të dhënave të marra nga drejtorët, janë përfshirë nxënësit e talentuar dhe me prirje, ndërsa, poashtu përfshirja e nxënësve me vështirësi në mësim arrinë 20,77 %.

Në raport me gjendjen numerike të nxënësve romë të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor përfshirja është 25,78 %, prej të cilëve me vështirësi në mësim janë 4,50 %, ndërsa me pengesa përqindja arrinë 0,61 %.

Në qoftë se bëhet krahasimi i numrit të nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim i cili është 4,41 % dhe numrit të nxënësve për të cilët përgatitet plani arsimor individual i cili është 5,9 %, do të vërtetohet konstatimi i njëjtë edhe për nxënësit të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në mësimin klasor dhe lëndor, përkatësisht se plani arsimor individual përgatitet edhe për nxënësit të cilët nuk kanë udhëzim dhe mendim.

Tabela 8:
Përgjigjet e drejtorëve sa i përket programit të përgatitur për punën e ekipit të shkollës dhe të nxënësit

Po	Jo
83,1 %	16,9 %

Sipas pohimeve të drejtorëve 83, 1 % e shkollave kanë përgatitur programin për punë të ekipit inkluziv të shkollës, ndërsa 16,9 % kanë dhënë përgjigje negative.

Tabela 9:
Përgjigjet e drejtorëve sa i përket planit aksional të përgatitur për punën e ekipit inkluziv të shkollës

Po	Jo
67,6 %	32,4 %

Sipas pohimeve të drejtorëve 67, 6 % e shkollave kanë përgatitur programin për punë të ekipit inkluziv të shkollës, ndërsa 32,4 % kanë dhënë përgjigje negative.

Tabela 10:
Përgjigjet e drejtorëve në lidhje me procedurën e hartuar dhe formularin për përgatitjen e planit arsimor individual (PAI) nga ekipi inkluziv i shkollës (EISH)

Po	Jo
71,7 %	28,3 %

Një përqindje e madhe e drejtorëve të shkollave ose 71,7 % janë deklaruar se ekipi inkluziv i shkollës ka hartuar procedurën dhe formularin për përgatitjen e planit individual arsimor, ndërsa 28,3 % kanë dhënë përgjigje negative.

Drejtorët e shkollave të cilët janë deklaruar se ekipi inkluziv i shkollës nuk ka hartuar procedurën dhe formularin për përgatitjen e planit arsimor individual, në përqindje më të madhe ose 34,6 % kanë dhënë arsyetim se nuk janë trajnuar për aktivitet të tillë; 30,8 % për shkak të mungesës së nxënësve me NVA; 18,5 % se ata deri kohët e fundit nuk kishin ekipin inkluziv të shkollës; 8,6 % se shkaku është mungesa e stafit të kompletuar nga bashkëpunëtorët profesional 7,4 % kanë dhënë arsyetim se shkolla është në procedurë të hartimit dhe formularit për përgatitjen e planit arsimor individual (PAI).

Tabela 11:
Përgjigjet e drejtorëve në lidhje me procedurën e hartuar për ndjekjen e indikatorëve/rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual (PAI)

Po	Jo
68,9 %	31,1 %

Një përqindje e madhe e shkollave, përkatësisht 68,9 % kanë hartuar procedurën për ndjekjen e përparimit/rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual, ndërsa 31,1 % janë përgjigjur negativisht, me arsyetim se nuk kanë ndjekur trajnime për këtë qëllim dhe nuk kanë një staf profesional për përkrahje në realizimin e një aktiviteti të tillë.

Në bazë të përgjigjeve të marra nga drejtorët e shkollave vërtetohet hipoteza e posaçme 4: **,,Ekipet inkluzive të shkollës në shumë shkolla fillore të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë përgatitur akte interne, procedura dhe protokolle për punën e tyre (programin dhe planin aksional për puinën e tyre, procedurën dhe formularin për hartimin e planit arsimor individual për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe procedurën për ndjekjen e përparimit/rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual)''.**

Tabela 12:
Mendimi i drejtorëve sa i përket trajnimit të mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor për përgatitjen e planit arsimor individual

Mësimi klasor		Mësimi lëndor	
Po	Jo	Po	Jo
50,4 %	49,6 %	47,7 %	52,3 %

Gjysma e drejtorëve të anketuar ose 50,4 % janë të mendimit se mësimdhënësit në mësimin klasor mund të përgatisin planin arsimor individual.

Më pak se gjysma e drejtorëve të anketuar ose 47,7 % janë të mendimit se mësimdhënësit e mësimit lëndor mund të përgatisin planin arsimor individual.

Tabela 13:
Mendimi i drejtorëve sa i përket trajnimit të mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor për zbatimin e metodave të diferencimit

Mësimi klasor		Mësimi lëndor	
Po	Jo	Po	Jo
52,2 %	47,8 %	49 %	51 %

Më shumë se gjysma e drejtorëve të anketuar, përkatësisht 52,2 % mendojnë se mësimdhënësit në mësimin klasor mund të përdorin metodat për diferencim.

Më pak se gjysma e tyre ose 49 % janë të mendimit se mësimdhënësit e mësimit lëndor mund të përdorin metodat për diferencim.

Tabela 14:
Përgjigjet e drejtorëve në lidhje me përfshirjen e asistentëve personal (personat që nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmë dhe përkrahje ndaj nxënësve

Po		Jo	
54	23 %	181	77 %

Prej gjithsej 235 drejtorëvetë cilët u përgjigjën në pyetjen për përfshirjen e asistentëve personal në ndihmë dhe përkrahje të nxënësit, 181 ose 77 % janë përgjigjur se nuk kanë asistent personal, ndërsa 54 ose 23 % janë përgjigjur pozitivisht.

Gjithsej 54 shkolla fillore kanë asistentë personal: 21 shkolla kanë nga 1 asistent personal; 19 shkolla – 2 sistentë; tre shkolla nga 3 asistentë personal; 3 shkolla nga 4 asistentë; një shkollë - 5 asistentë; një shkollë - 6 asistentë dhe dy shkolla kanë paraqitur nga 9 asistentë.

Tabela 15: Mendimi i drejtorëve në lidhje me përfshirjen e asistentëve personal (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmë dhe përkrahje ndaj nxënësve

Vallë është në lidhje farefisi me nxënësin?	Çfarë profesioni ka asistenti profesional?	Posedon certifikatë nga trajnimi i ndjekur nga MASH	Kush e angazhon/ financon asistentin personal?
94,8 % - jo 5,2 % - po	34,8 % – defektolog 17,9 % - arsim të mesëm profesional 17,8 % – psikolog 10,7 % – mësimdhënës klasor 3,6 % – punonjës social 2,7 % – pedagog 2,7 % – mësimdhënës lëndor 0,9 % – edukator 0,9 % – filolog 0,9 % – filozof 0,9 % – administratë publike 0,9 % - sociolog 3,5 % – nënë 0,9 % – gjyshe 0,9 % – motër	74,8 % – jo 25,2 % - po	38,3 % – familja 61,7 % - komuna

Nga paraqitja tabelare shihet se drejtorët e shkollave janë deklaruar se 94,8 % nga përfshirja e asistentëve personal (persona që nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmë dhe përkrahje të nxënësvenuk janë në lidhje farefisnore me nxënësin, kundrejt 5.2 % të cilët janë në lidhje farefisnore me personin me nevoja të veçanta arsimore.

Në aspektin e profesionit të asistentëve profesional vërehet një diapazon më i madh i profesioneve prej të cilave me përqindje më të madhe ose 34,8 % janë përfshirë defektologë, 17,9 % janë me profesione me shkollë të mesme, 17,8 % janë psikologë, 10,7 % janë mësimdhënës klasor. Me përqindje më të vogël janë përfshirë: punëtori social, pedagogu, mësimdhënësi lëndor, edukatori, filologu, filozofi, administratori publik, sociologu, nëna, gjyshja dhe motra.

Në aspektin e posedimit të certifikatës për trajnimin e ndjekur, 74,8 % janë përgjigjur se nuk kanë certifikatë dhe 25,2 % kanë certifikatë për trajnimin e ndjekur për asistent personal.

Për këtë nga kush janë angazhuar ose financuar asistentët personal, 38,3 % e drejtorëve kanë thënë familja, ndërsa, a 61,7% komuna.

Tabela 16: Mendimi i drejtorëve në lidhje me aktivitetet në të cilat përfshihen asistentët personal

I ndihmon nxënësit me NVA në realizimin e detyrave gjatë orëve	I ndihmon nxënësit me NVA në realizimin e detyrave në aktivitetet jashtëmësimore	I ndihmon nxënësit me NVA në realizimin e detyrave në mësimin shtues/ plotësues	I ndihmon nxënësit me NVA në realizimin e aktiviteteve fizike dhe aktiviteteve në pozicion ulur	I ndihmon nxënësit me NVA në mirëmbajtjen e higjienës personale
92,2 %	**80 %**	**76,5 %**	**69,5 %**	**59,1 %**

Nga paraqitja tabelare shihet qëndrimi i drejtorëve në lidhje me aktivitetet ku përfshihen asistentët personal: 92,2 % se asistentët personal i ndihmojnë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në realizimin e detyrave gjatë orës, 80 % i ndihmojnë nxënësit në realizimin e detyrave në aktivitetet jashtëmësimore, 76,5 % i ndihmojnë nxënësit me NVA në realizimin e detyrave në mësimin plotësues, 69,5 % e drejtorëve mendojnë se asistentët personal iu ndihmojnë nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në realizimin e aktiviteteve fizike dhe aktiviteteve në pozicion ulur dhe ne përfshirje më të vogël ose 59,1 % mendojnë se asistentët personal iu ndihmojnë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në mirëmbajtjen e higjienës personale.

Nga këta tregues konstatohet se asistentët personal pjesëmarrje më të madhe kanë në ndihmën e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në realizimin e detyrave gjatë orëve ku, gjithashtu, dëshmojnë se asistentët personal në masë të madhe depërtojnë në kompetencat e asistentit pedagogjik, përkatësisht e rimarrin rolin e tyre në këtë aktivitet të rëndësishëm gjatë orës. Nëse merret parasysh edhe profesioni i asistentëve personal, përkatësisht se 17,9 % prej tyre janë me arsim të mesëm profesional, atëherë vie në shprehje përshtatshmëria e mbështetjes e cila iu jepet nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në procesin e mësimit, me çka vërtetohet hipoteza e shtatë e posaçme:

,,Asistentët personal dhe pedagogjik nuk kanë kompetenca të dallueshme në përkrahjen të cilën ua japin nxënësve me nevoja të veçanta arsimore''.

Tabela 17:
Përgjigjet e drejtorëve në lidhje me përfshirjen e asistentëve (arsimor) pedagogjik (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve

Po		Jo	
46	20 %	187	80 %

Në lidhje me përfshirjen e asistentëve pedagogjik (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmë dhe përkrahje të nxënësve janë deklaruar 233 drejtorë të shkollave.

Prej tyre 46 ose 20 % kanë paraqitur se për ndihmë dhe përkrahje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore kanë asistentë pedagogjik; në 20 shkolla ka nga 1 asistent; në 14 shkolla ka nga 2 asistentë pedagogjik; 4 shkolla kanë nga 3 asistentë pedagogjik; 3 shkolla kanë nga 4 asistentë pedagogjik; 3 shkolla kanë nga 5 dhe nga një shkollë kanë 6, përkatësisht 9 asistentë.

Tabela 18:
Mendimi i drejtorëve në lidhje me përfshirjen e asistentëve pedagogjik (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve

Shkalla e arsimit	Profesioni i asistentit pedagogjik	Posedon certifikatë nga trajnimi i ndjekur nga MASH	Kush e angazhoi/ financoi asistentin pedagogjik?
98,9 % - sipëror	23,4 % – defektolog	60,6 % - po	77,7 % - komuna
1,1 % - të mesëm	23, 4 % – mësimdhënës klasor	39,4 %- jo	22,3 % - familja
	19,1 % – psikolog		
	8,5 % – pedagog		
	8,5 % – mësimdhënësit lëndor		
	4,2 % – punonjës social		
	3,1 % - filolog		
	2,1 % - sociolog		
	2,1 % - logoped		
	2,1 % – filozof		
	2,1 % – edukator		
	1 % – e mesme-ekonomike		

Nga paraqitja tabelare shihet se drejtorët e shkollave janë deklaruar se 98,9 % nga përfshirja e asistentëve pedagogjik (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve janë me arsim sipëror, ndërsa 1,1 % janë me arsim të mesëm.

Sa i përket profesionit të asistentëve pedagogjik vërehet një diapazon i madh i profesioneve prej të cilëve në përqindje më të madhe ose 23,4 % janë defektologë; 23,4 % mësimdhënës klasor; 19,1 % janë psikologë, ndërsa 8,5 % janë pedagogë dhe me përqindje të njëjtë janë përfshirë mësimdhënësit lëndor. Me përqindje më të vogël përfshihen: punonjës social, filolog, sociolog, logoped, filozof, edukator dhe një asistent pedagogjik është me arsim të mesëm ekonomik.

Sa i përket asistentëve personal përfshirja e defektologëve është 34,8 %, ndërsa përfshirja e defektologëve si asistentë pedagogjik është shumë më e vogël dhe arrinë 23,4 %. Mësimdhënësit klasor në rolin e asistentit personal përfshihen me 10,7 %, ndërsa me rolin e asistentit pedagogjik përfshihen me 23,4 %.

Sa i përket posedimit të certifikatës për trajnimin e ndjekur 60,6 % e asistentëve pedagogjik janë përgjigjur se kanë certifikatë dhe 39,4 % nuk kanë certifikatë të tillë.

Krahasuar me asistentët personal vërehet dallim i madh në posedimin e certifikatës për trajnimin e ndjekur. Njëherësh, 60,6 % e asistentëve pedagogjik kanë certifikatë, kundrejt 25,2 % asistentëve personal të cilët nuk kanë certifikatë dhe 39,4 % e

Tabela 19: Përgjigjet e drejtorëve sa i përket aktiviteteve në të cilat përfshihen asistentët pedagogjik

Merr pjesë në punët administrative-teknike të shkollës	Merr pjesë në punën e ekipit të inkluzionit të nxënësit	Bashkëpunon me mësimdhënësin në planifikimin dhe realizimin e mësimit, përgatitjen dhe ndjekjen e PAI	Bashkëpunon me shërbimin profesional	I ndihmon nxënësit me NVA gjatë mësimit
3,2 %	62,8 %	85,1 %	97,9 %	97,9 %
Ndihmon në përfshirjen e nxënësit në aktivitetet e përbashkëta me nxënësit tjerë dhe në aktivitetet jashtëmësimore	I ndihmon nxënësit me NVA në tejkalimin e barrierave gjuhësore	I ndihmon nxënësit në aktivitetet e përbashkëta me nxënësit tjerë në aktivitetet jashtëmësimore	Bashkëpunon me bashkësinë lokale	
95,7 %	72,3 %	95,7 %	67 %	

asistentëve pedagogjik nuk kanë certifikatë, kundrejt 74,8 % asistentëve personal të cilët nuk kanë certifikatë, që tregon faktin se asistentët pedagogjik janë më të trajnuar për ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore për dallim nga asistentët personal.

Sa i përket asaj se nga kush angazhohen ose financohen asistentët pedagogjik, 22,3 % e drejtorëve kanë theksuar se nga familja, ndërsa 77,7 % nga komuna.

Krahasuar me angazhimin dhe financimin e asistentëve personal vërehet se një numër i madh i tyre financohen nga familjet - 38,3 %, kundrejt 22,3 %, asistentëve personal në numër të madh financohen nga komunat 77,7 % kundrejt 61,7 %.

Drejtorët e shkollave sa i përket aktiviteteve ku janë të përfshirë asistentët pedagogjik kanë dhënë këto përgjigje: 97,9 % janë përgjigjur se asistentët pedagogjik bashkëpunojnë me shërbimin profesional; 97,9 % iu ndihmojnë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë mësimit; 95,7 % e përgjigjeve janë se i ndihmojnë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në aktivitetet e përbashkëta me nxënësit tjerë dhe në aktivitetet jashtëmësimore; 95,7 % e drejtorëve konsiderojnë se asistentët pedagogjik marrin pjesë në aktivitetet e përbashkëta me nxënësit tjerë dhe në aktivitetet jashtëmësimore; 85,1 % mendojnë se asistentët pedagogjik bashkëpunojnë me mësimdhënësin në planifikimin dhe realizimin e mësimit, përgatitjen dhe ndjekjen e planit arsimor individual, 72,3 % janë përgjigjur se asistenti pedagogjik i ndihmon nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në tejkalimin e barrierave gjuhësore; 67 % bashkëpunojnë me bashkësinë lokale; 62,8 % janë përgjigjur se asistenti pedagogjik merr pjesë në punën e ekipit inkluziv dhe 3,2 % merr pjesë në punët administrative-teknike në shkollë. Konstatimi i përgjithshëm është se asistenti pedagogjik përfaërsisht janë të angazhuar në këto aktivitete: bashkëpunimi me shërbimin profesional, ndihmën e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, në aktivitetet jashtëmësimore, në aktivitetet e përbashkëtame nxënësit tjerë, në planifikimin dhe realizimin e mësimit, përgatitjen dhe monitorimin e planit arsimor individual, ndihmë nxënësit për tejkalimin e barrierave gjuhësore, bashkëpunimi me bashkësinë lokale dhe pjesëmarrje në punën e ekipit të inkluzionit.

Tabela 20:
Përgjigjet e drejtorëve për atë se vallë asistenti pedagogjik njëkohësisht realizon edhe aktivitete të asistentit personal

Po (numri)	Përqindja
21	45,6 %

Nga paraqitja tabelare shihet se 21 ose 45,6 % nga asistentët pedagogjik njëkohësisht realizojnë edhe aktivitete të asistentit personal. Nëse merren parasysh përgjigjet e drejtorëve sa i përket aktiviteteve në të cilat janë të përfshirë asistentët (tabela 14)

atëherë vërtetohet hipoteza 8 e posaçme: **,,Nuk ka kompetenca profesionale dhe standarde qartë të definuara për asistentët personal dhe pedagogjik në dhënien e përkrahjes ndaj nxënësve me nevoja të veçanta arsimore''.**

Tabela 21:
Përgjigjet e drejtorëve për numrin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore me të cilët punon njëkohësisht një asistent pedagogjik gjatë orës mësimore

Me një nxënës	Me dy nxënës
93 %	7 %

Nga paraqitja tabelare mund të konstatohet se 93 % e drejtorëve të shkollave janë përgjigjur se secili asistent pedagogjik duhet të punojë vetëm me një nxënës dhe 7 % prej tyre janë deklaruar se secili asistent pedagogjik duhet të punojë me dy nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Sa i përket periudhës kohore të orës në të cilën asistenti pedagogjik punon me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore, 84 % e drejtorëve të shkollave janë deklaruar se asistenti pedagogjik punon në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë orës, ndërsa vetëm 16 % se përfshihen përkohësisht varësisht nga nevojat.

Sa i përket mënyrës në të cilën mësimdhënësi dhe asistenti pedagogjik punojnë gjatë orës: 54,3 % e drejtorëve konsiderojnë se mësimdhënësi punon me të gjithë nxënësit, ndërsa asistenti pedagogjik përfshihet me përkrahjen e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në bazë të planit paraprak (me marrëveshje) për realizimin e orës, të cilin e kanë bërë në mënyrë të përbashkët; 28,3 % janë të mendimit se mësimdhënësi punon me të gjithë nxënësit (duke përfshirë edhe nxënësin me nevoja të veçanta arsimore), ndërsa asistenti pedagogjik inkuadrohet përkohësisht dhe i ndihmon nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe 8 % e drejtorëve konsiderojnë se asistenti pedagogjik punon me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore, ndërsa mësimdhënësi paralelisht punon me nxënësit tjerë, pa marrëveshje paraprake për mënyrën në të cilën do të realizohet mësimi.

Sa i përket asaj se cili profil është më përkatës për punë si asistent pedagogjik: 34 % e drejtorëve të shkollave janë deklaruar se më i përshtatshëm është profili për defektolog; 21,4 % konsiderojnë se është pedagogu; 20,2 % se profil më i përshtatshëm është psikologu; 17,6 % kanë vendosur për profilin e mësimdhënësit dhe vetëm 6,5 % konsiderojnë se më adekuate për asistent pedagogjik është prindi i nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Tabela 22: Përgjigjet e drejtorëve për atë se çka duhet të përmirësohet në funksionimin e ekipit inkluziv të shkollës

Kategoritë e përgjigjes	Përqindja
Trajnimet për kuadrin edukativo-arsimor	41,8 %
Punësimi i defektologëve	18,7 %
Përforcimi i bashkëpunimit me prindërit	11,2 %
Takime më të shpeshta, komunikime, bashkëpunime, shkëmbimin e informatave	8,8 %
Sigurimi i instrumenteve përkatëse për punën e ekipit	6 %
Rregullimi ligjor i punës së EISH	5,2 %
Bashkëpunimi me institucionet kompetente	5,2 %
Punësimi i asistentëve	3,2 %

Nga paraqitja tabelare mund të konstatohet: 41,8 % e drejtorëve të shkollave janë përgjigjur se për një funksionim më të mirë të ekipit inkluziv të shkollës nevojiten trajnime për kuadrin edukativo-arsimor; 18,7 % konsiderojnë se nevojitet të punësohen defektologë 11,2 % e drejtorëve janë të mendimit se është e nevojshme përforcimi i bashkëpunimit me prindërit; 8,8 % mendojnë se takimet e shpeshta, komunikimet, bashkëpunimet dhe shkëmbimet e informatave do të kontribuonin për një funksionim më të mirë të ekipit inkluziv të shkollës; 6 % referojnë sigurimin e instrumenteve përkatëse për punën e ekipit; 5,2 % theksin e vënë në rregullimin ligjor të punës së ekipit inkluziv të shkollës dhe bashkëpunimit me institucionet kompetente dhe 3,2 % konsiderojnë se janë për funksionim më të mirë të ekipit inkluziv të shkollës nevojitet të punësohen asistentë.

Tabela 23: Përgjigjet e drejtorëve sa i përket resurseve të nevojshme për një realizim më të suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollën e tyre

Kategoritë e përgjigjes	Përqindja
Trajnimet për kuadrin edukativo-arsimor	49,3 %
Ekipimi i EISH me bashkëpunëtorë profesional (në veçanti defektologë)	18 %
Sigurimi i mjeteve didaktike	11,2 %
Përforcimi i bashkëpunimit me prindërit	10,2 %
Rregullimi ligjor i punës së EISH	5,4 %
Punësimi i asistentëve	3,9 %
Bashkëpunimi me institucionet kompetente	1,9 %

Nga paraqitja tabelare mund të konstatohet se: 49,3 % e drejtorëve të shkollave janë të mendimit se për një realizim sa më të suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollën e tyre nevojiten trajnime të kuadrit edukativo-arsimor; 18 % konsiderojnë se është i nevojshëm ekipimi i ekipit inkluziv të shkollës me bashkëpunëtorë profesional (në veçanti defektologë); 11,2 % e drejtorëve janë të mendimit se është e nevojshme sigurimi i mjeteve didaktike; 10,2 % mendojnë se përforcimi i bashkëpunimit me prindërit do të kontribuonte për realizim më të suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollën e tyre; 5,4 % preferojnë rregullimin ligjor të punës të EISH; 3,9 % theksin e vënë në punësimin e asistentëve dhe 1,9 % konsiderojnë se për realizim më të suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollën e tyre nevojitet bashkëpunimi me institucionet kompetente.

3. TREGUESIT E FITUAR PËRMES ANKETIMIT TË MËSIMDHËNËSVE NË SHKOLLAT FILLORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

EKZEMPLARI

Ekzemplari i përgjithshëm i mësimdhënësve të cilët iu përgjigjën pyetësorit është 739. Prej tyre 262 janë mësimdhënës klasor, ndërsa 477 janë mësimdhënës lëndor. Në shtojcën 2 është dhënë një rishikim i shkollave nga të cilat janë inkuadruar mësimdhënës në hulumtim.

Tabela 24:
Numri i mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor të cilët janë përgjigjur pyetësorit.

Numri i mësimdhënësve	Mësimdhënësit e mësimit klasor	Mësimdhënësit e mësimit lëndor
	262	477
Gjithsej	**739**	

Në tabelë është dhënë numri i mësimdhënësve të mësimit klasor dhe mësimit lëndor të cilët iu përgjigjën pyetësorit Gjthsej janë përgjigjur 739 mësimdhënës prej të cilëve 262 janë të mësimit klasor dhe 477 të mësimit lëndor.

Tabela 25:
Përfshirja e mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor të cilët iu janë përgjigjur pyetësorit sipas gjinisë

Numri i mësimdhënësve sipas gjinisë	Meshkuj	Femra
	106	633
Gjithsej	**739**	

Paraqitja tabelare ka të bëjë me përcaktimin e mësimdhënësve sipas gjinisë. Nga gjithsej 739 mësimdhënës 106 janë të gjinisë mashkullore dhe 633 të gjinisë femërore, gjë që tregon faktin se raporti i mësimdhënësve meshkuj dhe femra është 1:6 (një ndaj gjashtë).

Në paraqitjen tabelare shihet se nga gjithsej 739 mësimdhënës pyetjes për rolin e tyre në përgatitjen e planit arsimor individual (PAI) iu janë përgjigjur 671 mësimdhënës, ndërsa 68 prej tyre nuk iu janë përgjigjur kësaj pyetje.

Nga përmbajtja dhe kuptimi i përgjigjeve vërehet se mësimdhënësit përgjigjet e tyre i japin në drejtim me kë përgatisin, në vend të rolit të tyre në përgatitjen e planit arsimor individual. Megjithatë, 13,4 % e mësimdhënësve janë përgjigjur se nuk kanë

Tabela 26:
Përgjigjet e mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor në raport me rolin e tyre në përgatitjen e planit arsimor individual

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Nuk kam përgatitur	189	25,6 %
Përgatis në mënyrë të pavarur	162	21,9 %
Përgatis në bashkëpunim me defektologun	99	13,4 %
Përgatis në bashkëpunim me shërbimin profesional	60	8,1 %
Përgatis në bashkëpunim me ekipin e inkluzionit të shkollës	55	7,4 %
Përgatis në bashkëpunim me aktivin e mësimdhënësve	54	7,3 %
Përgatis në konsultim me prindërit	28	3,8 %
Përgatis; jap mendim; reduktoj materialin dhe zvogëloj qëllimet; bëj përshtatjen e programit; bëj përshtatjen e formave dhe metodave të punës dhe kërkoj ndihmë; i përcaktoj pikat e forta dhe të dobëta të nxënësit; bëj vlerësimin diagnostik të mundësive dhe aftësive; bëj planifikimin me përshtatjen e programeve mësimore sipas niveleve të kompleksitetit; e planifikoj hapësirën në klasë; siguroj resurse; nxis përkrahjen me nxënësit tjerë; planifikoj metodat e vlerësimit dhe reflektimin e arritjeve; diferencoj qëllimet, mjetet, format, metodat, strategjitë dhe mënyrat e vlerësimit; konsultoj literaturë profesionale dhe Internetin; bëj përshtatjen e përmbajtjeve; ndjekjen e PAI.	14	1,9 %
Përgjigje të papërcaktuara	10	1,4 %
Nuk janë përgjigjur	68	9,2 %
Gjithsej	**739**	

nxënës me nevoja të veçanta arsimore, përkatsisht se nuk kanë marrë pjesë në përgatitjen e planit arsimor individual 7,3 % janë përgjigjur se pavarësisht/plotësisht me rolin kryesor/të rëndësishëm përgatisin planin arsimor individual, 8,1 % se planin arsimor individual e përgatisin në bashkëpunim me defektologun, ndërsa 7,4 % përgatisin planin arsimor individual në bashkëpunim me shërbimin profesional në shkollë (psikolog, pedagog, defektolog). Një përqindje e vogël e mësimdhënësve 3,8 %, janë përgjigjur se planin arsimor individual e përgatisin në bashkëpunim me ekipin inkluziv të shkollës, 1,9 % përgatisin planin arsimor individual në bashkëpunim me aktivet e mësimdhënësve dhe 1,4 % e mësimdhënësve përgatisin planin arsimor individual në konsultim me prindërit.

Vetëm 21,9 % e mësimdhënësve kanë dhënë përgjigje përkatëse, përkatësisht e kuptojnë rolin e tyre në procesin e përgatitjes së PAI.

- *„Roli im si mësimdhënësështë që të caktoj qëllimet që dëshiroj t'i arrijë, format dhe metodat që do t'i zbatoj dhe të kërkoj ndihmë nga bashkëpunëtorët profesional."*
- *„Mbikëqyrjen e nxënësit dhe përcaktimin e pikave të tij të forta dhe të dobëta."*
- *„Shqyrtimi i arritjeve, përcaktimi i pikave të forta dhe të dobëta të nxënësit, më çka vijon përshtatja e qëllimeve, përcaktimi i modifikimeve të domosdoshme, përshtatjeve, mjeteve ndihmëse, pajisjes, si dhe mënyra e vlerësimit."*
- *„Si pjesë e aktivit profesional nga arsimi fizik dhe shëndetësor së bashku me kolegët përpiluam planin dhe programin për punën në lëndën tonë, pastaj çdo herë kishim parasysh që t'i detektojmë pikat e forta dhe të dobëta të nxënësit, afinitetet e tij, kornizën kohore për përvetësimin e temës ose njësisë të caktuar metodike, metodat të cilat do t'i përdorim, mënyrën e ndjekjes së të arriturave të nxënësve dhe ngjashëm."*
- *„Si mësimdhënës rregullisht i ndjeki nxënësit me NVA dhe përgatis PAI për nxënësit që kanë nevojë, duke i arsyetuar pikat e forta dhe të dobëta, përshtatshmërinë e hapësirëssipas nevojave, përparimit, lëmisë së përkrahjes, bashkëpunimit dhe socializimit me bashkënxënësit dhe mësimdhënësin, sjelljen gjatë orës dhe gjatë pushimit, periudhën e observimit me qëllim të krijimit të mjedisit stimulues për zhvillimin e aftësive dhe mundësive të nxënësit."*
- *„Pas një mendimi paraprak nga defektologu dhe në bashkëpunim me prindin bëj diferencimin e qëllimeve mësimore, bëj përzgjedhjen e mjeteve përkatëse, format, metodat dhe strategjitë, mënyrën e vlerësimit në përputhje me stilin e mësimnxënies të nxënësit dhe funksionimit të tij momentale."*

Një përqindje e madhe e mësimdhënësve 25,6 % kanë dhënë përgjigje jopërkatëse. **Nga analiza e përgjigjeve bëhet e qartë se ata nuk e kuptojnë esencën e planit arsimor individual, si dhe rolin e tyre në përgatitjen e tij.**

- *„Unë si mësimdhënëse nuk jam kompetente të përgatis PAI të tillë, sepse arsimi im është puna në paralele normale, ndërsa për plane të këtilla janë kompetent personat profesional si defektologët të cilët duhet të punojnë me nxënës të tillë."*
- *„Roli i mësimdhënësit i cili mundohet për të përshtatur programin për nxënësit me nevoja të tilla."*
- *„Si mësimdhënës i lëndës së informatikës përpiloj për nevojat e tyre planin arsimor individual. "*
- *„Nëse mendohet në planifikimin për realizimin e mësimit, vetë i përgatis sipas planit dhe programit të paraparë nga Byroja e zhvillimit të arsimit."*
- *„Përpilimi në mënyrë të pavarur i planit për punë."*
- *„Planin individual për zhvillimin personal e përgatis në bazë të planeve globale dhe tematike nga lënda e informatikës për klasën e gjashtë dhe të shtatë, si dhe planin tematik për projekte nga informatika, me përshtatje përkatëse të qëllimeve dhe metodave ndaj nevojave individuale të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore varësisht nga aftësitë e tij."*
- *„Kryesore, drejtpërdrejtë, duke i kushtuar vëmendje vitit të fundit shkollor, duke i shqyrtuar pikëpamjet nga orët e realizuara mësimore."*
- *„Personalisht e përgatiti programin vjetor të lëndës sime."*
- *„Parashikoj planin arsimor individual, përgatiti dhe realizoj në sferën e orëve të parapara për mësimin plotësues dhe shtues."*
- *„Planin arsimor individual e përgatis vetë, duke kërkuar shembuj në Internet, duke konsultuar kolegët, duke u interesuar në përgjithësi. Kjo nënkupton se roli im është i plotë."*
- *„Përpilimi i planifikimit vjetor dhe tematik dhe përpilimi i qëllimeve të posaçme."*
- *„Në bazë të planeve dhe programeve vjetore për çdo vit shkollor bëj përgatitjen e planit tim për punë për vitin shkollor, sipas kalendarit për punë, nevojave të planit vjetor të shkollës etj."*
- *„Nuk përgatis plan vetë, por përdori plan të përgatitur dhe e përshtati me planet dhe programet e mia mësimore."*
- *„Pas trajnimit të realizuar në shkollë, kam përpiluar katër plane arsimore individuale dhe të njëjtat i zbatoj gjatë vlerësimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore."*
- *„ Planin arsimor individual e përgatiti me qëllim të një ore mësimore më efektive (çdo orë ka qëllimet e veta, të cilat duhet të realizohen)."*
- *„Për çdo vit përpiloj planin arsimor individual pa dallim se në klasë ka ose nuk ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore."*
- *„Përgatiti PAI në testet, fletat e punës për ata nxënës të cilët më dobët përparojnë në mësim."*

Tabela 27: Përgjigjet e mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor sa i përket rolit të tyre në ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Përgjigje të padefinuara/nuk e njeh procesin e ndjekjes/monitorimit	289	39,1 %
Nuk përgatis PAI	105	14,2 %
Evaluimi dhe revizioni i PAI (vlerësimi formativ dhe sumativ); përmbledhja e dëshmive në portfolio; shkruarja e raportit	67	9,1 %
Për çdo ditë monitoroj/ndjek	62	8,4 %
Udhëheqja me listat (çek lista dhe analitike); testet; detyrat e shtëpisë; shënime anekdotike; pyetje me gojë; aktivitete praktike	57	7,7 %
Vëzhgim, ndihmë dhe shënimi i rezultateve	20	2,7 %
Monitoroj në nivel të orës	16	2,2 %
Ndjeki në mënyrë të pavarur	10	1,4 %
Reflektimi	9	1,2 %
Me ndihmën e shërbimit profesional	9	1,2 %
Monitoroj përmes punës individuale me nxënësin	8	1,1 %
Definimi i kritereve për arritjet	2	0,2 %
Nuk janë përgjigjur	85	11,5 %
Gjithsej	**739**	

Në paraqitjen tabelare shihet se nga gjithsej 739 mësimdhënës, 654 janë përgjigjur pyetjes për rolin e tyre në monitorimin/ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual, ndërsa 85 mësimdhënës nuk janë deklaruar në këtë pyetje.

Nga përgjigjet vërehet se mësimdhënësit janë fokusuar në sqarimet e intervalit kohor të monitorimit (si për shembull ,,monitoroj gjatë orës'' ose ,,monitoroj për çdo ditë''), por jo edhe me mënyrat në të cilat e bëjnë këtë.

Përqindje më e madhe e përgjigjeve (39,1 %) i referohen një përgjigje joadekuate që shfaq atë se mësimdhënësit nuk e njohin mjaftueshëm procesin e monitorimit/ndjekjes:

- *„Drejtpërdrejtë nuk kam ndjekur realizimin e planit arsimor individual, por kjo ka qenë jo e drejtpërdrejtë gjatë realizimit të planit arsimor"*
- *„Nuk kam realizuar monitorim të tillë."*
- *„Ulem dhe bisedoj me nxënësit."*
- *„Ndihma, gjetja e mënyrës më të lehtë të ballafaqimit të nxënësit me shkathtësitë e tij, për të mësuar diçka."*
- *„Monitorim individual afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtë."*

- *„Nuk kam nevojë për monitorim në realizimin e PAI."*
- *„Në paralelet normale është shumë vështirë të ndiqen ata nxënës sepse anashkalohen nxënësit tjerë, madje edhe plani arsimor individual krijon vështirësi për ndjekje/monitorim."*
- *„Për dallim nga koleget tjera që kopjojnë programet dhe ndryshojnë vetëm emrin e fëmijës, unë vetë e përgatis programin duke e ndjekur pasqyrën reale të deklaruar më parë."*
- *„Realizimi i planit arsimor individual është punë plotësuese dhe stresuese për mësimdhënësin."*
- *„Unë gjindem ashtu siç di dhe mundem vetë, zbatoj mënyrat e mia për të cilat mendoj se janë përkatëse, të përshtatshme."*

Një përqindje shumë e vogël kanë dhënë përgjigje konkrete, si për shembull: Udhëheqja e listave (çek dhe analitike); Testet; Detyrat e shtëpisë; Shënimet anekdotike; Pyetje gojore; Aktivitete praktike, si dhe Evaluimi dhe revizioni i planit arsimor individual (vlerësimi formativ dhe sumativ); Përmbledhja e dëshmive në portfolio; Shkrimi i një raporti.

- *„Nivelin e realizimit të suksesshëm e konstatoj përmes ndjekjes së nxënësve dhe njëkohësisht shënimin e arritjeve të tyre në nivel të një ore mësimore (përmes reflektimit) ose për një periudhë më të gjatë, përmes shkrimeve të mia që i kam përgatitur vetë në të cilat bëj evidencën për çdo ndryshim nga aspekti i ndryshëm."*
- *„Rregullisht e ndjeki punën e nxënësit përmes analizës të fletave të punës të cilat i përgatis veçmas për nxënësin sipas planit arsimor individual. Bëj çek listat, përkatësisht reflektimin e të njëjtave dhe shqyrtoj deri ku janë përvetësuar qëllimet. Nxënësit i përgatis edhe kontrollime me shkrim në të njëjtën kohë, ashtu edhe nxënësve tjerë me qëllim që të ndjehen të barabartë. Ua jap mundësinë të përgjigjen me gojë dhe bëj ndjekjen e aktivitetit të tij."*
- *„Bëj ndjekjen e vazhdueshme ndaj punës së nxënësit, bashkëpunoj me nxënësit tjerë përmes bisedës me nxënësin, çek lista dhe lista mësimore me nivele sipas vështirësisë."*

Në paraqitjen tabelare vërehet se nga ana e mësimdhënësve janë marrë gjithsej 1561 përgjigje të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e diferencimit në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Nga rezultatet e fituara mund të konstatohet se mësimdhënësit zbatojnë diferencimin në të gjitha segmentet e procesit arsimor, varësisht nga nevojat, mundësitë, lloji dhe shkalla e pengesës ose vështirësisë, me të cilën ballafaqohet nxënësi me NVA në procesin mësimor. Diferencimin e qëllimeve dhe rezultatet e pritura e bëjnë 2,2 % e mësimdhënësve, të përmbajtjeve 1,4 %, të materialeve mësimore 0,6 %, të detyrave dhe pyetjeve 3,8 %, të mjeteve ndihmëse 14 %, të testeve 1 %, të fletave/listave mësimore 2 %, të kohës dhe hapësirës 0,4 %, të kritereve për vlerësim 0,6 %.

Tabela 28: Përgjigjet e mësimdhënësit të mësimit klasor dhe lëndor sa i përket përdorimit/ zbatimit të metodave të diferencimit në punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Nuk përdori qasje diferencuese	186	11,9 %
Nuk kam nxënës me nevoja të veçanta	126	8,0 %
Forma e punës individuale dhe e individualizuar	122	7,8 %
Punë në çifte	87	5,6 %
Punë në grupe të vogla	86	5,5 %
Punë e përbashkët	81	5,2 %
Ndihmë nga bashkënxënësit/mbështetje mes mocanikëve	70	4,5 %
Përshtatja e qëllimeve dhe pritja e rezultateve	64	4,1 %
Përshtatja e përmbajtjeve	60	3,8 %
Përshtatja e mjeteve mësimore	55	3,5 %
Përshtatja e materialeve mësimore	54	3,4 %
Listat mësimore të individualizuara	53	3,4 %
Përshtatja e kohës dhe hapësirës	46	2,9 %
Përshtatja e kritereve për vlerësim	41	2,6 %
Reduktimi i nivelit të vështirësisë të detyrave dhe pyetjeve	35	2,2 %
Teste të përshtatura	34	2,2 %
Zbatimi i TIK dhe teknologjisë asistive	32	2,0 %
Zbatimi i metodës të shprehjes me gojë	29	1,8 %
Metoda e vizatimit dhe ngjyrosjes	28	1,8 %
Metoda e lojës	27	1,7 %
Metoda vizuale	25	1,6 %
Metoda auditive	23	1,5 %
Metoda e dialogut	23	1,5 %
Punë praktike	22	1,4 %
Metoda e bisedës	22	1,4 %
Metoda ilustrative	17	1,1 %
Metoda demonstrative	16	1%
Metoda e veprimit	15	1%
Metoda e lavdëratës dhe nxitjes	10	0,6 %
Metoda eksperimentuese	10	0,6 %
Metoda e shprehjes me shkrim	9	0,6 %
Metoda përshkruese	9	0,6 %
Metoda e tekstit	9	0,6 %
Metoda e mbikëqyrjes/vëzhgimit	8	0,5 %
Metoda e njohjes	7	0,4 %
Aplikimi i muzikës	6	0,4 %
Aplikimi i teknikave të ndryshme në mësim (pushim për sqarim, kubi, shënjestra e fantazisë, Diagrami i Venit, rrushit, fruljetë, stuhi ideshë, harta logjike, lojë fati)	6	0,4 %
Ndihmë nga asistenti personal dhe defektologu	5	0,3 %
Përgjigje/mjete të papërshtatshme	3	0,2 %
Gjithsej	**1561**	

Nga diferencimi i formave të punës përqindje më e madhe ose 11,9 % e mësimdhënësve janë deklaruar se e zbatojnë formën individuale ose të individualizuar të punës me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Realizimin e punës në grupe të vogla e bëjnë 3,4 % e mësimdhënësve, ndërsa punë në çifte bëjnë 2,9 %.

SHEMBUJ:

- *„Qasje individuale me mjete mësimore të manualit, njësi mësimore të thjeshta të paraqitura në mënyrë grafike iu prezantohen nxënësit, fleta/lista mësimore ku parashtrohen pyetje të larmishme ose pyetje duke rrethuar, me formate të mëdha të fletave mësimore, detyra numerike vetëm me një operacion."*
- *„Pranimi dhe respektimi i dallimeve të nxënësve, ndërlidhjet dhe zgjerimet e njohurive tanimë me të njohurën, ligjërim dhe mësimnxënie graduale, mundësimi i hapësirës së mjaftueshme për nxënësin, punë në grupe të vogla, qasje individuale të punës."*
- *„Mësimi individual dhe i individualizuar."*
- *„Përdori qasje individuale, punë në çifte dhe në grupe të vogla."*
- *„Puna individuale, punë në çifte, ku nxënësi tjetër i çiftit do ta orientojë bashkënxënësin e vet me vështirësitë në mësimt'i realizojë qëllimet e orës, metodën demonstrative, metodën e vëzhgimit, përmes ilustrimeve, tekstit, incizimeve, simulimeve, të mund t'i arrijë rezultatet e pritura gjatë orës."*
- *„Aplikohet qasja e individualizuar për nxënësin, përdoret përkrahja e bashkëmoshatarëve përmes sigurimit të ndihmës nga shoku gjatë detyrave të caktuara, nxitjes së punës në çifte, grupe dhe ngjashëm. Aplikohen metodat e ndryshme të punës me qëllim të stimulimit të mësimdhënësit dhe animimit për të përqëndruar vëmendjen e duhur (metoda e lojës, metoda e vëzhgimit, metoda ilustrative, metoda e dialogut, metoda e punës praktikedhe aktiviteteve manipuluese)."*
- *„Shpeshherë qasja individuale ose puna në çifte me nxënësin më mirë i arrin qëllimet e parashtruara."*

Nga analiza e përgjigjeve mund të konstatohet se disa nga mësimdhënësit nuk bëjnë dallimin ndërmjet qasjes individuale dhe asaj të individualizuar në punën e drejtpërdrejtë të mësimdhënësit dhe nxënësit.

Sa i përket diferencimit të metodës mësimore, mësimdhënësit janë deklaruar se aplikojnë metoda të ndryshme të cilat janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me mundësitë individuale, aftësitë dhe nevojat e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Me përqindje më të madhe ose 5,6 % përfshihet metoda ilustruese, ndërsa për nuancë më të vogël ose 5,5 % metodën demonstruese. Me 5,2 % përfshihet metoda e bisedës, ndërsa 4,5 % e mësimdhënësve aplikojnë aktivitete përmes lojës. Mësimdhënësit më së paku e aplikojnë metodën shkallë-shkallë 1 %, metodën e lavdëratës 0,5 %, metodën e shprehjes me shkrim dhe metodën përshkruese me 0.6% përfshirje, metodën e njohjes 0,4 % dhe muzikë 0,2 %. Mësimdhënësit në përqindje të vogël ose 0,3 %, aplikojnë edhe teknikat

përkatëse në qasjen e punës me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Një 8 % e lartë e përgjigjeve të mësimdhënësve nuk përputhen me pyetjen e parashtruar për zbatimin e diferencimit në punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, që tregon se ata jomjaftueshëm e njohin dhe e aplikojnë diferencimin në punën e drejtpërdrejtë me nxënësit e këtillë.

SHEMBUJ:

- „Shfrytëzoj programin për sjelljen e individualizuar."
- „Metodat janë të njëjta, ndërsa koha që ndahet ndonjëherë është e humbur, sepse këto metoda dhe ky program janë tepër të vështira për nxënësit me nevoja të këtilla."
- „Interaksioni mësimdhënës-nxënës."
- „Mësimi në bashkësi."
- „Qasje e heshtur."
- „Metodë e drejtpërdrejtë."
- „Në punën dhe përvojën time të deritanishme kam njohur shumë nxënës të cilët kanë pasur ndonjë pengesë, por prindërit e tyre nuk kanë sjellë vërtetim mjekësor, e as nuk kanë dashur të bisedojnë për këtë temë si problem me të cilin janë përballur. E gjithë kjo nuk më lejon të përdori metoda tjera ndaj nxënësve të këtillë përveç asaj që më është përcaktuar, sepse kjo nënkupton se e thyej ligjin, përkatësisht sillem në mënyrë profesionale (kokë më vete)."
- „I aplikoj ato metoda të cilat mi propozon ekipi profesional."
- ,,Metoda e një minutëshit pritje."
- „I përdori metodat e njëjta edhe për nxënësit tjerë."
- „Nuk jamë mjaftueshëm profesionist për të bërë diferencimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore."
- „Për shkak të mungesës së trajnimeve përkatëse nuk jam i njohtuar me metodat e diferencimit."
- „Nuk jemi të trajnuar për temën, hulumtoj në Internet."
- „E pazbatueshme."
- „Shpeshherë, për fat të keq improvizojmë."
- „Nuk jam e trajnuar sa duhet për të aplikuar metodat profesionale".

Paraqitja tabelare ka të bëjë me përgjigjet e ndryshme të mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor të cilët i kanë dhënë duke iu përshtatur kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa.

Kësaj pyetje iu janë përgjigjur gjithsej 764 mësimdhënës. Përqindja më e madhe e tyre ose 14,8 % nuk kanë punuar me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Një përqindje e madhe kanë dhënë përgjigje joadekuate (13,6 %) gjë që tregon se mësimdhënësit jomjaftueshëm ose janë përgjigjur në mënyrë joadekuate i kanë përshtatur kushtet, metodat dhe aktivitetet e nevojave të nxënësve me pengesa.

Tabela 29: Përgjigjet e mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor sa i përket përshtatjes të kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Përgjigje të papërshtatshme	104	14,8 %
Nuk ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore	113	13,6 %
Aktivitete sipas mundësive dhe aftësive	84	11%
Me qëllime më të zakonshme/të diferencuara	75	9,8 %
Me përkrahje të nxënësit tjetër	34	9%
Shumë vështirë	31	5,5 %
Aspak	37	0,65 %
Sipas shkallës së pengesës	5	4,45 %
Reduktimi i kritereve	13	4%
Sipas nevojave të nxënësit	75	1,7 %
Sipas llojit të pengesës	29	3,8 %
Varësisht nga disponimi momental i nxënësit	3	9,8 %
Me ndihmën e shërbimit profesional / defektologut	22	3,3 %
Nuk bëj përshtatjen	5	2,9 %
Sipas dëshirave dhe interesimit të nxënësit	3	0,4 %
Reduktimit të përmbajtjeve	19	2,5 %
Përmes detyrave të posaçme	10	2,5 %
Me ndihmën e asistentit personal	17	2,2 %
Vendi ku ulet nxënësi	17	2,2 %
I jepet më tepër kohë	15	1,9 %
Përshtatja me hapësirën/inventarin	13	1,7 %
Përmes zbatimit të metodës së diferencimit	11	1,4 %
Metoda e bisedimit, ilustrues dhe demonstrues	10	1,3 %
Lëvdata	10	1,3 %
Punë individuale/ qasje individuale	8	1%
Punë në grupe të vogla/hap pas hapi	8	1%
Punë në çifte	7	0,9 %
TIK në mësim	5	0,65 %
Aplikimi i teknologjisë asistive	5	0,65 %
Përmes vizatimit dhe ngjyrosjes	5	0,65 %
Përmes lojës	4	0,5 %
Përmes përshtatjes së testeve dhe detyrave	4	0,5 %
Ushtrime për zhvillimin e motorikës	3	0,4 %
Fletëza mësimore të individualizuara	3	0,4 %
Përshtatja e mjeteve ndihmëse (vizuale, auditive,taktile)	3	0,4 %
Gjithsej	**764**	

NË SHTOJCË JANË DHËNË DEKLARIMET E MËSIMDHËNËSIT:

- *„Këtyre nxënësve iu nevojiten kushte për punë, përkushtimi ndaj tyre është i pamjaftueshëm gjatë orëve të rregullta, sepse punojmë në paralele në të cilat ka prej 27 deri 30 nxënës dhe secili nxënës ka kërkesat e veta. Aktivitetet janë të ndryshme prej nxënësve në mësimin e rregullt."*
- *„Sipas ndryshimit të Hënës (persona të tillë kanë lloj tjetër të sjelljes kur Hëna është e plotë)."*
- *„Kushtet për punë janë ato, sikurse edhe për fëmijët tjerë."*
- *„Improvizimi."*
- *„Në punën/përvojën time të deritanishme kam njohur nxënës të cilët kanë ndonjë pengese, por prindërit e tyre nuk kanë sjellë vërtetim nga mjeku, e as që dëshirojnë të bisedojnë për këtë tematikë si problem me të cilin ballafaqohen. E gjithë kjo nuk më lejon të përdori metoda tjera ndaj këtyre nxënësve përveç asaj që është e përcaktuar, sepse kjo nënkupton se punoj kundër ligjit përkatësisht veproj në mënyrë profesionale (kokë më vete)."*
- *„Kur paralelja është me 26 nxënës ose më shumë dhe keni një nxënës me pengesa, me të vërtetë është shkathtësi e mësimdhënësit për t'i organizuar 40 minutat e orës dhe të përkushtohet ndaj nxënësit me pengesa dhe ndaj të tjerëve."*
- *„Veproj ashtu siç di dhe mundem."*
- *„Pikësë pari bëj përshtatjen sipas disponimit të tij momental."*
- *„Duke pasur parasysh atë se shkolla jonë, paralelet janë me numër të madh të nxënësve, pothuajse është e pamundur të punohet me këtë lloj të nxënësve. Mungesa e kohës, kushteve, mjeteve mësimore përkatëse, kuadër mësimor jopërkatës."*
- *„Kushtet, metodat dhe aktivitetet për nevojat e nxënësve të cilët kanë çfardo lloji të pengesës, nuk janë në ndonjë nivel të lakmueshëm. Që të sigurohen kushte për punë me nxënës të këtillë nevojitet më shumë kohë ose paralele më e vogël që të përmbushen qëllimet e orës për të gjithë nxënësit."*
- *„Në qoftë se ekziston nevoja, varësisht nga e njëjta, janë shterrur të gjitha mundësitë sipas nevojave."*
- *„I përshtati ato disi."*
- *„Sipas përbërjes të nxënësve tjerë."*
- *„Varësisht nga detyrat të cilat punohen, vëmendje i kushtohet atyre nxënësve në orët e detyrueshme dhe në orët e mësimit plotësues."*
- *„Me kombinimin e muzikës, artit dhe multimedias."*
- *„Sigurohen materiale didaktike, mjetet ndihmëse të cilat do t'ia lehtësojnë mësimnxënien nxënësit."*
- *„Sipas asaj sa është përqendrimi i tij, në cilën pjesë të ditës dhe çka mund të bëjë."*
- *„Në orën e madhe planifikojë kohë në mënyrë adekuate për punën individuale me nxënësin, apo parashoh aktivitete që nxënësi i punon me asistentin arsimor."*
- *„Kushtohet vëmendje për mënyrën me të cilën nxënësi mëson më leht, përkatësisht stilin e mësimit."*
- *„Sipas njohurive ku arrij nga hulumtimi i pavarur apo nga disa udhëzime dhe disa njohuri të pakta në trajnimet e përcjellura."*

- *„Varësisht nga disponimi momental i nxënësit."*
- *„Në fillim të orës ua jap detyrën dhe i përcjelli gjatë orës."*
- *Një numër i vogël por i rëndësishëm i nxënësve, kryesisht (4%), theksin e vendosin në vështirësitë me të cilat ballafaqohen gjatë përshtatjes së kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa. Në shtojcën e këtij gjykimi janë pjesë e përgjigjeve të mësimdhënësve:*
- *„Mundohem të luaj ndërmjet kërkesave dhe nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta edhe pse është shumë vështirë meqë nxënësit me nevoja të veçanta kërkojnë vëmendje të posaçme që nxënësit tjerë nuk lejojnë ta mer (përshkak të egocentrikës së tyre është rezultat i vetë moshës."*
- *„Vështirë ecë përshtatja, veçanërisht nëse nxënsësi të bashkëpunojë, ndërsa gjendet në klasën me mbi 20 nxënës."*
- *„Shumë vështir për kushtet, punohet në socializimin e nxënësit ndaj nxënësve tjerë dhe e kundërta, pranimi i nxënësit nga ana e nxënësve tjerë."*
- *„Shumë vështirë meqë nuk ka kushte."*
- *„Shumë vështirë për ata nevojitet program i veçantë dhe mësimdhënës të posaçëm si dhe mësimdhënës që do t'i mësojnë nxënësit shkrim - lexim."*
- *„Vështirë, ajo më mer shumë kohë nga realizimi i mësimit ndaj nxënësve tjerë."*
- *„Nuk është lehtë, meqë kushtet nuk e lejojnë atë, një numër i madh i nxënësve në paralele."*
- *„Mesatarisht vështirë."*
- *„Shumë vështirë është në sallën sportive të realizohet dhe përshtatet mësimi me të gjithë nxënësit, duke përfshi edhe fëmijë me vështirësi."*
- *„Vështirë balancoj ndërmjet nxënësve tjerë dhe nxënësit me NVA, më duhet më shumë kohë."*
- *„Shumë vështirë dhe në përgjithshsi nuk kemi kushte të posaçme për atë mënyrë të punës.*

Përshtatja e aktiviteteve sipas mundësive dhe aftësive të nxënësve me nevoja të veçanat arsimore zbatojnë 11 % të mësimdhënësve të anketuar, ndërsa sipas nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore përshtatje bëjnë 9,8 % nga mësimdhënësit e anketuar.

SHEMBUJT POZITIV TË PËRSHTATJES GJITHPËRFSHIRËSE TË KUSHTEVE, METODAVE DHE AKTIVITETEVE TË NEVOJAVE TË NXËNËSVE ME PENGESA:

- *„Shpesh herë nxënësi ulet në afërsinë time të drejtëpërdrejtë që të ndihet i sigurtë. Ndonjëherë angazhoj edhe nxënës (asistent) i cili i ndihmon nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Përpiloj fleta pune, zgjedh tekste interesante, harta, kuize të cilat do t'ia tërheqin vëmendjen''*
- *„Kushtet janë krijuar me vetëm vendosjen e bashkëpunimit total me prindërit dhe koordinimin e tërësishëm me shërbimin profesional dhe drejtorin e shkollës, ndërsa kushtet e mira për punë i ofro edhe vetë shkolla, që furnizohet nga mjetet mësimore dhe ndihmëse gjithçka që nevojitet. Praktikoj ligjeratë në grupe të vogla, njëkohësisht TIK në mësim, përdori ilustrime të ndryshme (të gatshme), të bëra nga unë por edhe nga vetë fëmijët. Kam kujdes në koncentrimin (kohëzgjatjen) e tyre, vendosi lojëra gjatë realizimit të detyrave të punës''*
- *„Nxënësi pranohet mirë nga nxënësit tjerë dhe i ka kushtet e njëjta ashtu si tjerët, ka hapësirë të mjaftueshme për lëvizje dhe punë, shpesh herë ka aktivitete të njëjta. Kur nevojitet ndihmë më e madhe me qasje individuale, nxitje, lëvdata dhe inkurajim plotësohen qëllimet."*
- *„Punën e pavarur, e kryejnë vetëm në karrike që të ulen mundësitë për pengesën dhe ulja e koncentrimit, puna në çift është me nxënës të ndryshëm apo me mësimdhënësin. Metodat janë shpeshherë audio – visuale, të shkruarit, dialogu. Aktivitetet shpeshherë janë ndërlidhje e fotografisë me fjalën, me pjesët e shprehjeve të theksuara apo mësimi i mësuar përmendsh vjersha të shkurtëra."*
- *„Përmes përpilimit të fletave mësimore të adaptuara për qëllimet e tyre, përpilimi i mjeteve ndihmëse, të siguruarit e materialit të ndryshëm manipulues për realizimin e aktiviteteve, si dhe puna me nxënës mentor i cili ndihmon në realizimin e aktiviteteve."*
- *„Materialet, metodat dhe teknikat në mësim që nënkuptojnë përdorimin e materialeve të ndryshme (visuale, ilustrime, të zëshme, sende konkrete që janë të domosdoshme në përkrahjen e mësimit të fëmijëve (nxënësve) fleta të përsshtatura pune dhe detyra për ushtrime, si dhe tekste shkollore, qasje e ndryshme si nxënës ,,hap pas hapi'', mësim me përvojë, metoda praktike, puna në çifte etj."*
- *„Zbatimi i udhëzimeve të shkurtëra dhe të qarta, sqarimi dhe biseda e zbatimit të intonacionit të ndryshëm të zërit, t'i jepet kohë të mjaftueshme në përfundimin e aktivitetit adekuat, mos të bëhet formë pyetëse ,,vallë dëshiron'', por të ofrohet opsioni për zgjedhjen me angazhimin e dy apo tre aktiviteteve të njejta, lidhshmëria e përmbajtjeve dhe detyrave me interesin, zbatimi i pauzave të shpeshta, zbatimi i tërheqjes dhe theksimi i fakteve kryesore nga instruksionet dhe leksionet përsëritje e njëpasnjëshme e informatave, zbatimi i shprehjeve ilustrative të pjesëve të materialit, zbatimi i ilustrimeve dhe materialet konkrete."*

Nga përgjigjet e theksuara vërehet ajo se nuk bëjnë një distiksion të qartë ndërmjet metodave dhe formave të punës, si dhe ndërmjet aktiviteteve dhe mjeteve ndihmëse si dhe materialet didaktike.

Tabela 30: Përgjigjet e mësimdhënësve nga mësimi klasor dhe lëndor sa i përket mënyrës sipas të cilës i përcjellin arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore

Kategoritë e përgjigjeve	Numri	Përqindja
Nuk kam nxënës të tillë/nuk përcjelli	104	14,1 %
Çek listat (shkallët e vlerësimit, fletat e pikëve)	100	13,5 %
Përgjigje me shkrim dhe gojarisht	100	13,5 %
Informata reciproke me gojë	99	13,4 %
Teste të përshtatshme	79	10,7 %
Fletat mësimore individuale	41	5,5 %
Sipas qëllimeve të zvogluara	39	5,3 %
Për çdo ditë/në secilën orë	38	5,1 %
Vëzhgim	35	4,7 %
Vizatime dhe përpunime të nxënësve	35	4,7 %
Portfolio e nxënësve	27	3,6 %
Vetëvlerësim	25	3,4 %
Nuk janë përgjigjur	17	2,3 %
Gjithsej	**739**	

Nga pasqyra tabelare mund të konstatohet se numri i përgjithshëm i mësimdhënësve është gjithsej 739 mësimdhënës nga mësimi klasor dhe lëndor, vetëm 17 nuk kanë dhënë përgjigje se si i përcjellin arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, ndërsa 14,1,% janë përgjigjur se nuk kanë nxënës të tillë. Çek listat (shkallët e vlerësimit, fletat e pikëve) dhe përgjigjet me shkrim dhe me gojë zbatojnë 13,5 % të mësimdhënësve përmes informatës reciproke gojore, i përcjellin arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.Teste të përshtatshme për përcjelljen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.Teste të përshtatshme për përcjelljen e arritjeve zbatojnë 10,7 %, fleta mësimore individuale 5,5 %, sipas qëllimeve të zvogluara 5,3 %, përmes përcjelljes së përditshme të secilës orë 5,1 %, përmes vështrimit të vizatimeve dhe përpunimeve të nxënësve 4,7 %, përmes porfolios së nxënësve 3,6 % dhe përmes vetëvlerësimit 3,4 % nga mësimdhënësit e kryejnë përcjelljen e arritjeve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Nga e theksuara mund të konkludojmë se mënyrat më të përfshiera për përcjelljen e arritjeve të nxënësve me nevoja të veçanat arsimore të cilat mësimdhënësit i realizojnë në mësim janë çek listat (shkallët e vlerësimit, fletat e pikëve), përgjigje me shkrim dhe me gojë dhe informata reciproke me gojë.

SHEMBUJ KONKRET NGA MËSIMDHËNËSIT:

- *„Në përgatitjen ditore i përcaktoj qëllimet që duhet të arrihen në orë, ndërsa njëherit zgjedh edhe aktivitete adekuate me të cilat do të realizohen ata qëllime – fleta mësimore me aktivitete të planifikuara, detyra dhe pyetje. Punimet i mbledh në portfolion për atë nxënës."*
- *„Secilën orë e përcjelli arritjen e nxënësit me nevoja të veçanat arsimore. Në çdo tre javë kërkoj informatë reciproke nga prindërit për përparimin e nxënësit, si dhe për interesimin e lëndës. Një herë në muaj dërgoj kërkesë te pedagogu dhe psikologu që të marrin pjesë në orën time ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe kërkoj informata reciproke prej tyre në lidhje me mënyrën time të punës."*
- *„Përcillet për çdo ditë, në fund të muajit bëj analizë të qëllimeve të arritjeve dhe në qoftë se nuk arrihen përsëri kthehem në të njejtat. Njohja e të arriturave në fund të trimujorit dhe gjysmëvjetorit dhe sipas nevojës, revizioni i PAI. Treguesit e suksesit – vizatimet, fletat e punës, përgjigjet e pyetjeve etj."*
- *„Përmes vizatimeve përgjigjeve – me shkrim dhe me gojë, instrumenteve për përcjelljen e arritjeve: vlerësimi praktik, observimi, fletat e adaptuara mësimore të përpiluara në veçanti për ata, teste të përshtatura të mundësive individuale dhe arritjeve të nxënësve. Pesha e detyrave të planifikuara detyrimisht është e riaftësuar për aftësitë individuale të nxënësve."*

Në bazë të rezultateve të fituara të cilët kanë të bëjnë me qëndrimet e mësidhënësve të mësimit lëndor dhe klasor në raport me përgatitjen dhe përcjelljen e planit individual arsimor, zbatimi i diferencimit, përshtatja e kushteve, metodave dhe ektiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa dhe përcjellja e arritjeve të tyre, analiza dhe interpretimi i tyre, mund të konstatohet **hipoteza e pestë e veçantë:**

Mësimdhënësit e shkollave fillore në pjesë të madhe nuk janë të trajnuar për përpilimin dhe përcjelljen e planit individual arsimor, zbatimin e diferencimit, përshtatjen e kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësve me pengesa dhe përcjellja e arritjeve të tyre.

Tabela 31: Përgjigjet e mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor sa i përket llojit të përkrahjes të cilën e marrin për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore nga bashkëpunëtori profesional/ pedagogu

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Konsultative	156	21,1 %
Këshillëdhënëse	116	15,7 %
Nuk ka pedagog në shkollë	79	10,7 %
Bisedë	70	9,5 %
Nuk kam nxënës me NVA	60	8,1 %
Nuk kam përkrahje	55	7,4 %
Planifikimi i mësimit	47	6,4 %
Përpunimi i PAI	38	5,1 %
Përpilimi i materialeve didaktike	35	4,7 %
Vizita në orë	27	3,6 %
E merr nxënësin dhe punon individualisht me atë	26	3,5 %
Minimale	18	2,4 %
Morale	12	1,6 %
Gjithsej	**739**	

Nga paraqitja tabelare vërehet se nga numri i përgjithshëm 739 mësimdhënës të mësimit klasor dhe lëndor, përqindje më të madhe apo 21,1 % konsiderojnë se kur e marrin përkrahjen për nxënësin me nevoja të veçanat arsimore nga ana e pedagogut është konsultative, 15,7 % mendojnë se është këshillëdhënëse, 9,5 % janë deklaruar për bisedën si lloj i përkrahjes, 6,4 % marrin përkrahjen në planifikimin e mësimit dhe 5,1% se përkrahjen nga pedagogu e marrin gjatë përpunimit të planit arsimor individual. Një përqindje më e madhe e mësimdhënësve të anketuar apo 10,7 % janë përgjigjur se nuk ka pedagog në shkollë, 8,1 % se nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe 7,4 % se nuk kanë përkrahje nga pedagogu në punën me nxënësin me nevoja të veçantë arsimore. Një përqindje e vogël e mësimdhënësve apo 4,7 % janë përgjigjur se përkrahjen që e marrin nga pedagogu është gjatë përpunimit të materailit didaktik, 3,6 % përmes vizitës së orës, 3,5 % janë përgjigjur se padagogu e merr nxënësin dhe punon individualisht me atë, 2,4 % janë deklaruar se përkrahjen që e marrin nga pedagogu është minimale dhe se 1,6 % e mësimdhënësve se përkrahjen që e marrin nga pedagogu në raport me nxënësit me nevoja të veçanra arsimore është vetëm nga aspekti moral.

Një pjesë e madhe e mësimdhënësve janë përgjigjur se përkrahjen e kanë marrë para orëve.

Tabela 32: Përgjigjet e mësimdhënësve të grupit klasor dhe mësimit lëndor sa i përket llojit të përkrahjes të cilën e marrin për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore nga bashkëpunëtori profesional/ psikologu

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Këshillëdhënëse	199	26,9 %
Konsultative	166	22,5 %
Nuk ka psikolog në shkollë	65	8,7 %
Nuk kam nxënës me NVA	60	8,1 %
Nuk kam përkrahje	50	6,7 %
Në përpunimin PAI	50	6,7 %
Përkrahja emocionale	49	6,6 %
Trajnime interne për përshtatjen e tematikës	29	3,9 %
Socializimi	27	3,6 %
Testimi	24	3,2 %
Përcjellja e realizimit të qëllimeve të vendosura	20	2,7 %
Gjithsej	**739**	

Nga pasqyra tabelare vërehet se nga gjithsej 739 mësimdhënës të mësimit klasor apo lëndor përqindja më e madhe apo 26,9 % supozojnë se përkrahjen që e marrin për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nga psikologu është këshilldhënëse, 22,5% supozojnë se është konsultative, 6,7% se përkrahjen nga psikologu e marrin gjatë përpunimit të planit arsimor individual dhe 6,6 % janë deklaruar për përkrahjen emocionale të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Përqindja më e madhe e mësimdhënësve të anketuar apo 8,7 % janë përgjigjur se nuk kanë psikolog në shkollë, 8,1 % se nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe 6,7 % se nuk kanë përkrahje nga psikologu në punën me nxënësin me nevoja të veçanata arsimore. Një përqindje më e vogël e mësimdhënësve apo 3,9 %, janë përgjigjur se përkrahjen që e marrin nga psikologu është në trajnime interne për përafrimin e temës, 3,6 % në procesin e socializimit të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, 3,2 % janë përgjigjur se psikologu ju ndihmon në procesin e testimit të nxënësit 2,7 % se përkrahja e psikologut është në raport me përcjelljen e realizimit të qëllimeve të caktuara. Pjesa më e madhe e mësimdhënësve kanë theksuar se përkrahjen e marrin para orëve.

Tabela 33: Përgjigja e mësimdhënësve nga mësimi klasor dhe lëndor sa i përket llojit të përkrahjes që e marrin për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore nga bashkëpunëtori profesional/ defektologut

Kategoritë e përgjigjeve	Numri	Përqindja
Nuk ka defektolog në shkollë	265	35,8 %
Në pëprunimin dhe përcjelljen e PAI	120	16,2 %
Konsultative	67	9,1 %
Puna individuale	65	8,8 %
Këshilldhënëse	63	8,5 %
Nuk kam nxënës me NVA	60	8,1 %
Përpunimi i materialit	52	7 %
Adaptimi i klasave	32	4,3 %
Nuk kam përkrahje	15	2 %
Gjithsej	**739**	

Nga pasqyra tabelare vërehet se nga gjithsej 739 mësimdhënës të mësimit klasor dhe mësimit lëndor një përqindje më e madhe apo 35,8 % janë deklaruar se nuk kanë defektolog në shkollë. 16,2 % supozojnë se përkrahjen që e marrin për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nga defektologu është në bashkëpunim dhe përcjellje të PAI. 9,1 % nga mësimdhënësit është se përkrahjen që e marrin është me karakter konsultativ 8,8% e mësimdhënësve fitojnë përkrahje nga defektologu në punën individuale me nxënës me NVA, ndërsa 8,5 % janë deklaruar se përkrahjen që e marrin nga defektologu është këshillëdhënëse, 8,1 % e mësimdhënësve nuk kanë nxënës me NVA, 7 % mësimdhënës, bashkëpunimi me defektologun realizojnë në pjesën e përpunimit të materialit, 4,3 % në adaptimin e klasave dhe 2 % mësimdhënës janë deklaruar se nuk marrin përkrahje nga defektologu i shkollës.

Pjesa më e madhe e mësimdhënësve kanë theksuar se përkrahjen e marrin para orëve. Nëse bëhet krahasim i llojeve të përkrahjes të cilën më tepër e fitojnë mësimdhënësit nga pedagogët, psikologët dhe defektologët, do të konstatojmë se pedagogu në masë të madhe është i fokusuar në përkrahjen konsultative 21,1 %, këshilldhënëse 15,7 % dhe përkrahjen në llojin e bisedës 9,5 %. Psikologu së pari është i orientuar në përkrahjen këshilldhënëse 26,9 %, konsultativ 22,5 % dhe përkrahja në përpilimin e planit arsimor këshilldhënës 6,7 %, përderisa përkrahja me prioritet nga defektologu të cilën e fitojnë mësimdhënësit është përpunimi dhe përcjellja e PIA 16,2 **%**, konsultativ 9,1 % dhe puna individuale me nxënësin me NVA 9,1 %.

Sa i përket përkrahjes që e marrin mësimdhënësit duhet theksuar edhe mungesa e pedagogut 10,7 %, psikologut 8,7 % dhe defektologut 35.8% në shkolla.

Kjo tregon në faktin se ekipet shkollore inkluzive në të gjithë shkollat e rregullta fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk janë të kompletuara me bashkëpunëtorët profesional të nevojshëm, pedagogun, psikologun dhe defektologun me çka edhe vërtetohet **hipoteza e veçantë 1**:

„ Ekipet shkollore inkluzive në disa shkolla të rregullta fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas strukturës nuk përshtaten me nenin 51 të Ligjit për arsim fillor, sipas të cilit ekipi inkluziv është i përbërë nga pedagogu përkatësisht psikologu i shkollës, mësimdhënësi i nxënësit, prindi, kryesisht tutori i nxënësit, defektologu nëse ka në shkollë dhe sipas nevojës mund të përfshihet edhe mjeku i nxënësit".

Tabela 34: Përgjigjet e mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor lidhur me trajnimet që i kanë përcjellur në tre vitet e kaluara për përforcimin e kompetencave personale për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Nuk kam përcjell trajnim	342	45,8 %
Trajnimi i përcjellur përmes diseminimit në shkollë	124	16,6 %
Temat e trajnimeve:		
Modulet e trajnimeve në kuadër të programit për arsim inkluziv, UNICEFI, Byroja e zhvillimit të arsimit dhe Qendra maqedonase për arsim qytetar	139	18,6 %
Disleksia, Shoqata „Ajnshtajn"	33	4,4 %
Përdorimi i teknologjisë asistive në punën me NVA	33	4,4 %
Puna me fëmijë me autizëm	14	1,9 %
Trjanim i organizuar në kuadër të programit ,,Komuna sipas përmasave të fëmijës"	12	1,6 %
Inkluzioni i nxënësve me NVA„Hapni dritaret"	12	1,6 %
Arsimi inkluziv,Erasmus + projekti	9	1,2 %
Zhvillimi i shkathtësive komunikative dhe sociale te fëmijët me autizëm ,,Drita e kaltërt"	8	1,1 %
Puna me fëmijët me NVA, Këshilli Britanik	4	0,5 %
Puna me nxënësit e talentuar dhe ato me prirje	4	0,5 %
Si deri në arsim cilësor inkluziv, Instituti shoqëri i hapur	2	0,3 %
Trajnim për inkluzionin e nxënësve me çrregullim në të pamurit	2	0,3 %
Procedura dhe instrumente për evaluimin e mësimit dhe nxënies, „Kontinium"	2	0,3 %
Inkluzioni i fëmijëve me NVA, „Kouçing"	2	0,3 %
Puna me nxënësit e talentuar dhe ato me prirje	2	0,3 %
Puna me fëmijë me NVA, Peace Corps	2	0,3 %
Gjithsej	**746**	

Nga pasqyra tabelare mund të konstatohet se nga ana e mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor sa i përket llojit të trajnimeve të cilat i kanë përcjell tre vitet e fundit, për përforcimin e kompetencave personale për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, janë fituar gjithsej 746 përgjigje.

Përgjigjet janë paraqitur në tabelën e sipërme sipas temës së trajnimit dhe provajderit. Trajnimet e organizuara nga Byroja e zhvillimit të arsimit në bashkëpunim me Qendrën maqedonase për arsim qytetar dhe me përkrahjen e UNICEF – it janë përcjellur nga një numër i madh i mësimdhënësve apo 18,6%. Ata janë të strukturuara në disa module: Moduli 1 ,,Vizioni, teoria dhe koncepti''; Moduli 2 ,,Puna bashkërisht për formimin e shkollave inkluzive''Moduli 3 ,,Mjediset që e ndihmojnë mësimin individual'', Moduli 4 ,,Vlerësimi formativ te nxënësit me vështirësi në mësim'' Moduli 5 ,,Mësimi diferencial në klasën inkluzive'', dhe Moduli 6 ,,Përkrahja individuale e nxënësve me vështirësi në mësim''. Diseminimet të cilat i kanë theksuar mësimdhënësit (16,6%) kanë të bëjnë pikërisht me përmbajtjet e këtyre moduleve.

Përqindja e madhe e mësimdhënësve, kryesisht 45,8 % janë përgjigjur se asnjëher nuk kanë përcjellur trajnim gjatë tre viteve të fundit, me çka vërtetohet **hipoteza ndihmëse 3**:

,,Një numër i madh i mësimdhënësve në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk kanë përcjellur trajnime për përforcimin e kompetencave personale për punën me nxënësit me nevoja të veçanata arsimore përkatësisht nuk janë mjaft të trajnuar për përpilimin dhe përcjelljen e planit individual arsimor, zbatimin e diferencimit në mësim, përshtatjen e kushteve, metodave dhe aktiviteteve për nevojat e nxënësve me pengesa dhe ndjekja e arritjeve të tyre''.

Tabela 35:
Përgjigjet e mësimdhënësve të mësim klasor dhe lëndor sa i përket llojit të ndihmës dhe përkrahjes të cilën asistentët personal ja japin nxënësit me pengesa

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Detyra pune për asistentin pedagogjik gjatë orës	82	59,9 %
Përgjigje jo adekuate	35	25,5 %
Kryerja e detyrimeve/obligimeve të përditshme të nxënësit në përmbushjen e nevojave personale/fizike	20	14,6 %
Gjithsej	**137**	

Në paraqitjen tabelare janë përfshi përgjigjet e mësimdhënësve prej 90 shkollave fillore në të cilët janë përfshirë asistentë personal (persona që nuk janë në punë në shkollë) për përkrahjen dhe ndihmën e nxënësve me pengesa.

Nga gjithsej 137 përgjigje 25,5 % janë joadekuate.

Përqindja më e madhe e mësimdhënësve (59,9 %) detyrat e punës për asistentin personal i përshtatin me detyrat e punës së asistentit pedagogjik.

SHEMBUJ:

- *„Shoqërimi i përditshëm dhe ndihma në mësim."*
- *„Ndihmë në të gjithë pjesët e orës dhe të gjithë detyrat e parashtruara."*
- *„Asistenti personal i ndihmon nxënësit gjatë orës, ndërsa asistenti për jashtë."*
- *„ I ndihmon nxënësit në të gjithë segmentet e orës."*
- *„Vijojnë orë së bashku me nxënësit dhe përfshihen dhe ndihmojnë në realizimin e qëllimeve dhe detyrave."*

Pothuajse 26 % e mësimdhënësve kanë dhënë përgjigje joadekuate në krahasim me detyrat e punëve të cilat i realizojnë asistentët personal.

- *„Atë që e shikoj në punë me asistentët personal supozoj se më tepër ju pengon këtyre nxënësve sesa ju ndihmon."*
- *„I përcjellin nxënësit në secilin aktivitet edhe atë nuk e bëjnë në mënyrë të padukshme edhe kur ju nevojitet përkrahje nga nxënësit, me një sjellje të tillë të tyre fëmijët vërehen dhe veçohen nga tjerët e kjo nuk është inkluzion."*
- *„Asistenti vjen në orë, ulet pranë nxënësit, e përcjell mësimin dhe i ndihmon në kryerrjen e detyrave gjatë orës."*

Vetëm një përqindje e vogël kryesisht 14,6% e mësimdhënësve janë përgjigjur se asistentët personal janë të përfshirë në kryerjen e detyrave/obligimeve të nxënësve në përmbushjen e nevojave fizike/personale, kryesisht i kanë orientuar detyrat e punës të cilat përshtaten me profilin asistenti personal.

SHEMBUJ:

- *„I ndihmon nxënësit në kryrjen e detyrave të përditshme: t'i nxjerr librat, ti rradhis në tavolinë, ta shoqëroj për në toalet, ta shëtis gjatë orës kur është shumë i shqetësuar, ja mban dorën gjatë shkruarjes, ia sqaron pjesërrisht detyrat, qëndron që të përshkruaj, bashkarisht i ploëtosjnë fletat e punës, e pengon që të lëndoj shokun, të hedh dhe të gjuaj me gjësende në klasë, e mban për dore në orën e arsimit fizik dhe shëndetësor me çka i plotëson kërkesat e mia dhe merr pjesë në lojë."*
- *„Asistenti personal i ndihmon për kryerjen e nevojave fizike të nxënësve."*
- *„I ndihmon nxënësit në kryerjen e nevojave personale."*
- *„Ti ndihmojë nxënësit në nevojat personale: ngrënie (gjatë të ushqyerit), shkuarjen në toalet, ngjitjen dhe zbritjen nëpër shkallë, shkuarja prej njërit në kabinetin tjetër."*
- *„I ndihmon nxënësit për lëvizjen pa pengesë në shkollë."*
- *„Ndihmë gjatë aktiviteteve fizike."*

Bashkëpunimin me asistentët personal mësimdhënësit e kanë vlerësuar në mënyrën vijuese:

- *„Asistenti i përcjell udhëzimet dhe sugjerimet e mia (përderisa ja sqaroj nxënësit) i ndihmon në realizimin e ushtrimeve të dhëna me çka pandërprerë mund të zhvillohet procesi mësimor."*
- *„Më ndihmon në përvetësimin e materialit të fëmijës me nevoja të veçanta arsimore."*
- *„Konsultimi dhe përcaktimi i aktiviteteve që munden të plotësohen nga nxënësit."*

- *„Korrekt dhe shumë profesional, ndërsa gjithçka me qëllim ti ndihmohet nxënësit me pengesa në zhvillim."*
- *„Me plotkuptim, përpiqemi në interes të nxënësit t'i barazojmë kërkesat dhe arritjet. Dakordohemi për peshën, vëllimin dhe vështirësitë e detyrave, pranoj kur thekson për atë se në orë për shkak të mjedisit nuk mund ta shpreh."*
- *„Ndihmon gjatë orës gjatë realizimit të kërkesave të parashtruara edhe në aktivitetet jashtëmësimore."*
- *„Pas secilës ditë të punës që takohemi i shkëmbejmë vëzhgimet nga dita e punës dhe bisedojmë se çfarë metoda të përdorim që ta realizojmë përmbajtjen mësimore."*
- *„Bisedë për përparimin e nxënësit me pengesa në zhvillim në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore, socializimin e tij dhe ndihmën rreth realizimit të aktiviteteve."*
- *„Biseda dhe ndarja e informatave."*
- *„Dakordohemi për udhëzimet dhe përmbajtjet që duhet ti përvetësojë."*
- *„Komunikimi i përditshëm me asistentin, në lidhje me fletat e punës, përparimin e nxënësit, nevojën për ndryshimin e aktiviteteve etj."*
- *„Bashkëpunimi është në nivelin e përbushur."*
- *„Meqë bashkëshoqëruesi është defektolog i diplomuar roli i tij është si asistent personal dhe pedagogjik."*
- *„Bashkëpunmi është i shkëlqyeshëm. I jap udhëzimet dhe kahjet se si të punohet në orë dhe në shtëpi janë me qëllim të arrihen qëllimet e parapara."*
- *„Bashkëpunimi është i shkëlqyeshëm dhe arrihen rezultatet pozitive"*
- *„Bashkëpunimi është i shkëlqyeshëm, asistenti arsimor i përcjell udhëzimet e mia për punë, shumë i ndihmon nxënësit që të mbetet i skocentruar në detyrë dhe ta mbarojë në kohën e paraparë."*

Tabela 36: Përgjigjet e mësimdhënësve nga grupi klasor dhe lëndor sa i përket llojit të ndihmës dhe përkrahjes të cilën asistentët pedagogjik ja japin nxënësit me nevoja të veçanta

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Ndihmon gjatë orës	33	30,8 %
Përgjigje jo adekuate/përzier me kompetencat e aistentit personal	31	29 %
Përvetësimi i materialit shkollor/përmbajtjeve mësimore	16	14,9 %
Përvetësimi i qëllimeve	8	7,5 %
I ndihmon mësimdhënësit	5	4,7 %
Ndihmon në aktivitetet jashtëmësimore	4	3,7 %
Orët individuale/Punon individualisht	4	3,7 %
Zhvillimi i të folurit	3	2,8 %
Jep ndihmë joadekuate për nxënësin/asistenti personal	3	2,8 %
Gjithsej	**107**	

Në pasqyrën tabelare përfshihen përgjigjet e mësimdhënësve nga 78 shkolla fillore në të cilat janë të përfshira asistentë pedagogjik (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë) për përkrahjen dhe ndihmën e nxënësit me pengesë.

Nga gjithsej 107 përgjigje, 29 % nuk janë adekuate.

Përqindja më e madhe e mësimdhënësve (30,8 %) janë përgjigjur se asistenti pedagogjik është i përfshirë në punën e drejtëpërdrejtë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore gjatë kohës së orëve në përvetësimin e qëllimeve dhe përmbajtjeve mësimore.

SHEMBUJ:

- *„Përcjellja e rregullt e arritjes gjatë orës, ndihma, përkrahja, motivimi, angazhimi, komunikimi etj."*
- *„I ndihmon nxënësit që ta përcjell mësimin, e shoqëron në disa orë, përcjell informata deri te prindërit dhe komunikon me mësimdhënësit dhe shërbimin profesional. Merr pjesë në përpilimin e PAI dhe ndihmon në përpilimin e materialit didaktik (fleta pune dhe teste në bashkëpunim me mësimdhënësit)."*
- *„Sqaron, ndihmon, punon me nxënësin, mësojnë së bashku për përgatitjen e testeve dhe hartimeve me shkrim."*
- *„Detyra e tij është që ti ndihmoj nxënësit që më leht ti mbaroj detyrat dhe të përgjigjet në kërkesat e caktuara, ta përcjell përparimin, të bashkëpunoj me mësimdhënësin dhe të punojë sipas udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi, mund të jep propozime dhe ide për përmirësimin e suksesit, por nuk e vlerëson nxënësin, e motivon dhe udhëzon nxënësin në orë, e përcjell socializimin e tij, si dhe pavarësinë e tij dhe kujdesin për veten."*
- *„Asistenti arsimor nuk merr pjesë në orët, ndihmon në përvetësimin e materialit sipas mundësive dhe aftësive të nxënësit."*

Vetëm 4,7 % e mësimdhënësve janë përgjigjur se asistenti pedagogjik i ndihmon, i jep përkrahje mësimdhënësit, 3,7 % e mësimdhënësve janë përgjigjur se asistenti pedagogjik punon individualisht me nxënësin dhe kjo punë është kryesisht si trajtim rehabilitues ndërsa 2,8 % kanë theksuar se asistenti pedagogjik realizon aktivitete që janë të natyrshme për punën e asistentit personal.

SHEMBUJ:

- *„Gjatë orëve më hollsisht e saron atë që nuk mundet ta shohë, i dikton plan nga tabela, i ndihmon që të vijë më leht deri te mjetet, të lëvit nëpër shkollë."*
- *„Ndihmon në lëvizjen nga kabineti në kabinet, përkrahja arsimore gjatë orëve dhe pranimin dhe përcjelljen e nxënësve me aftësi të kufizuara."*

Mësimdhënësit e kanë vlerësuar bashkëpunimin me aistentët pedagogjik në këtë mënyrë:

- *„Interaksioni i cili siguron funksionimin e planit individual arsimor."*
- *„Si shoqërim meqë ata persona nuk janë të kualifikuar për nxënësit me aftësi të kufizuara."*

- *„Komunikimi, se si ti lehtësohen punët e nxënësit, çka ndodh me atë gjatë orëve mësimore, si përparon dhe sesi bashkëpunon gjatë kohës së orëve."*
- *„Ia tregoj qëllimin e përmbajtjeve mësimore që duhet kryer atë orë dhe i jap sqarim për të njejtën që të mundet të punojë me nxënësin."*
- *„Para orëve e njoh me qëllimet që duhet ti realizojmë me nxënësin në orë. I jap fletë pune me detyra sipas të cilëve punohet gjatë orës, duke zgjedhur metodën më të leht për përvetësimin e materialit. Kontrolli im është në secilin moment të lirë të punës me nxënësit tjerë. Shpeshherë bashkëpunojmë edhe ditën paraprake madje asistenti përpilon fletë pune dhe mban mjete ndihmëse dhe visuale për punën me nxënësin me aftësi të kufizuara.*
- *„Bashkëpunimi në përpilimin e planit individual arsimor është më i thjeshtë sepse marr udhëzime nga asistenti i cili e njeh nxënësin më gjatë kohë se unë si mësimdhënës. Asistenti vazhdimisht kërkon udhëzime, aktivitete dhe sqarim për qëllimet e mësimit. Gjatë aktiviteteve individuale, kur ka nevojë për nxitje, udhëzim, motivim të nxënësit apo ndarje të plotë të nxënësit, asistenti pedagogjik na ndihmon ne mësimdhënësve a me këtë edhe nxënësit."*

Tabela 37: Përgjigjet e mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor për realizimin më të sukseshëm të arsimit inkluziv në shkolla

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Trajnime adekuate/seminare	230	31,1 %
Përfshierje më e madhe e personave/bashkëpunëtorëve profesional në shkolla	174	23,5 %
Përfshierja e asistentëve personal dhe pedagogjik	96	13 %
Pajisja e shkollave me resurse/pajisje adekuate (materialet didaktike, literatura, teknologjia asistive)	92	12,4 %
Të përkufizohen nxënësit që duhet të mësojnë në shkollat e rregullta kryesisht të veçanta	57	7,7 %
Përforcimi i bashkëpunimit me prindërit	38	5,1 %
Ulja e numrit të nxënësve në paralelet ku janë të përfshirë nxënësit me NVA	27	3,6 %
Përkrahja e Byrosë së zhvillimit të arsimit, të përpilojë PAI të unifikuar dhe ta rregulloj vlerësimin e nxënësve që punojnë sipas PAI	25	3,3 %
Gjithsej	**739**	

Në pasqyrën tabelare përfshihen përgjigjet e 739 mësimdhënësve të mësimit klasor dhe mësimit lëndor që kanë të bëjnë me propozimet për realizimin e sukseshëm të arsimit inkluziv në shkolla.

Përqindja më e madhe e mësimdhënësve ose 31,1 % janë përgjigjur se u nevojiten trajnime/seminare adekuate. Një numër dukshëm i tyre 23,5 % supozojnë se realizim më i sukseshëm i arsimit inkluziv nevojitet që të ket inkuadrim më të madh të bashkëpunëtorëve/personave profesional në shkolla dhe 13%, përfshierje të asistentëve dhe personave pedagogjik. Mësimdhënësit mendojnë se nuk janë të trajnuar sa duhet që të punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Propozojnë trajnime të detyrueshme për të gjithë mësimdhënësit, përfshierjen e defektologëve, angazhimin e asistentëve në mësim. Të bëhet një kufi rigoroz që nxënësit të munden të posedojnë mësim të rregullt, ndërsa cilët të udhëzohen në shkollat e veçanta.

NË KONTEKST TË KËSAJ JANË MENDIMET VIJUESE TË MËSIMDHËNËSVE TË ANKETUAR:

- *„Unë personalisht mendoj se duhet bërë një kufi të caktuar se cilët fëmijë mund të ndjekin mësim në paralelet e zakonshme, ndërsa cilët duhet të ndjekin mësim në paralelet speciale. Madje ndodh që fëmija me aftësi të kufizuara të jetë agresiv, shpesh herë të qajë dhe të bërtasë në orë dhe të tregojë disa mënyra tjera joadekuate të sjelljes. Ndodh që nxënësit tjerë të mos munden të përcjellin mësimin cilësor nga këto arsye. Ndodh shpeshherë, kryesisht për çdo ditë, prindërit e fëmijëve tjerë të reagojnë fuqishëm. Ndodh përderisa janë më të vegjël të frikohen nga fëmija me aftësi të kufizuar, veçanërisht nëse fëmija shpeshherë bërtet, qanë dhe është agresiv. Kemi ne nxënës të tillë në shkollën tonë.''*
- *„Për këto fëmijë me aftësi të kufizuar nevojiten persona profesional dhe kompetentë të cilët do t'iu ndihmojnë nxënësve dhe mësimdhënësve në kryerjen normale të detyrave arsimore dhe profesionale. Supozoj se me trajnimet as që mundet mësimdhënësi ta merr rolin e defektologut, e as do të jetë ajo komplet dhe e tërësishme për nxënësit e tillë. Në një klasë ku ka nxënës të talentuar dhe me prirje apo nxënës me aftësi të kufizuara, nuk është i mundshëm përkushtimi i plotë dhe pune asme njërët palë, e as me tjetrën. Të gjendet formë tjetër e realizimit!"*
- *„Personalisht mendoj se arsimi inkluziv i kufizon nxënësit me aftësi të kufizuara ndërsa nuk ju ndihmon. Përvoja ime tregon se më tepër dëm sesa dobi te fëmijët me nevoja të veçanat me zbatimin e inkluzionit. Më tepër arritje dhe shkathtësi do të kishin arrit nëse në paralelen në të cilën do të ketë vetëm nxënës me aftësi të kufizuara dhe me ata të punojnë kryesisht defektologë e jo mësimdhënës lëndor. Kështu që janë lënë në mëshirë dhe pamëshirë e organizimit sistematik të shkollës, mundësitë e prindërve dhe vetëdija e mësimdhënësit lëndor. Duhet të riorganizohet qasja ndaj nxënësve me nevoja të veçanta arsimore që të jenë pjesë e procesit arsimor, ndërsa jo vetëm për keqardhje dëmi kolateral.''*

- *„Defektologu të jetë i pranishëm në orë dhe të punojë bashkërisht me fëmijën në bashkëpunim me mësimdhënësin. Nëse ka më tepër fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, defektologu të bëjë orar në nivel javor, në cilën orë me cilin fëmijë do të punojë. Defektologu te ketë qenë pjesëmarrës së paku 20 orë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë një javë (gjysëm orari të punës)."*
- *„Nëse mësimdhënësi vlerëson se ka nevojë për asistent personal, detyrimisht ti sigurohet. Kjo është praktikë në disa vende të Evropës. Asistenti të jetë mundësisht defektolog, meqë ata janë të trajnuar për punën e fëmijëve me nevoja të veçanata arsimore. Unë nuk besoj se disa trajnime me nga disa orë, mësimdhënësi klasor bëhet kompetent për punën e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Bashkëpunimi reciprok ndërmjet mësimdhënësit dhe asistentit në secilën pikpamje do të kontribuojë që në të vërtet të arrihen rezultatet dhe vërtet t'ju ndihmohet fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore''.*
- *„Të realizohen më tepër trajnime primare madje ato të avancuara për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, të thjeshtësohet „papirologjia" e mësimdhënësit me qëllim që realisht ti përkushtohet punës me nxënës, të përpilohen standarde të veçanta dhe kritere për vlerësimin e Byrosë së zhvillimit të arsimit, të aftësohet mësimdhënësi për vlerësimin e përgjithshëm të atyre nxënësve dhe kontrollimin e njohurive të tyre."*
- *„Trajnime të detyrueshme për të gjithë mësimdhënësit. Trajnimet mos të jenë të karakterit të përgjithshëm, sepse lloji i ndryshëm i nevojave kërkon qasje të ndryshme (psh. Trajnim për punën*

4. TË DHËNAT E MARRA PËRMES ANKETIMIT TË BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL (PEDAGOG, PSIKOLOG DHE DEFEKTOLOG) NË SHKOLLAT FILLORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

EKZEMPLAR

Ekzemplarin e përbëjnë gjithsej 335 bashkëpunëtor profesional në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prej tyre 141 janë pedagogë, 130 psikolog dhe 64 defektolog (edukatorë special dhe rehabilitues).

Tabela 38:
Gjendja numerike e bashkëpunëtorëve profesional (pedagogë, psikologë, dhe defektologë) të cilët e kanë plotësuar pyetësorin

Bashkëpunëtori profesional		Pedagogu		Psikologu		Defektologu	
Број	335	141	42,1 %	130	38,8 %	64	19,1 %

Në tabelë është paraqitur gjendja numerike e bashkëpunëtorëve profesional (pedagogë, psikologë dhe defektologë) të cilët janë përgjigjur në pyetësor. Gjithsej janë përgjigjur 335 bashkëpunëtor profesional (pedagog, psikologë dhe defektolog) të cilët janë përgjigjur në pyetësor. Gjithsej janë përgjigjur 335 bashkëpunëtor profesional prej të cilëve 141 apo 42,1 % janë pedagogë, 130 apo 38,8 % me psikologë dhe 64 apo 19,1% janë defektolog (edukatorë special dhe rehabilitues). Madje, vërehet se përfshierja e defektologëve në shkolla është dyfish më i vogël në krahasim me bashkëpunëtorët tjerë profesional (pedagogë dhe psikolog). Një përfshierje e tillë është e pritur meqë roli i defektologëve si bashkëpunëtor profesional në shkollat e rregullta aktualizohet në dekadën e fundit, me inicimin e të gjithë nxitjeve inkluzive të mëdha me të cilat ballafaqohen shkollat ku janë të inkluzuar nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Tabela 39: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional – pedagogë sa i përket rolit të tyre në përpilimin e planit arsimor individual

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Vendosja/definimi/rishqyrtimi i qëllimeve në PAI	60	40,3 %
Konsultimet dhe dhënia e këshillave të mësimdhënësve për zgjedhjen e formave adekuate, metodave, strategjive, detyrave, aktiviteteve dhe mjetet për punën e nxënësve	35	23,5 %
Përcjellja e planifikimeve ditore dhe përparimi i nxënësve	17	11,4 %
Nuk kam përvojë	15	10,1 %
Bashkëpunimi me prindërit	10	6,7 %
Nuk janë përgjigjur	12	8 %
Gjithsej	**149**	

Në pasqyrën tabelare shihet se pjesa më e madhe e bashkëpunëtorëve profesional – pedagogët apo 40,3 % janë të qëndrimit se roli i tyre në përpilimin e planit individual arsimor është në vendosjen, definimin apo rishqyrtimin e qëllimeve në planin individual arsimor. Për konsultimin dhe dhënien e këshillave të mësimdhënësve, për zgjedhjen e formave adekuate, metodave, strategjive, detyrave, aktiviteteve dhe mjetet për punën me nxënësit janë përcaktuar 23,5 % e pedagogëve, përderisa 11,4 % mendojnë se roli i tyre në përpilimin e planit arsimor individual në përcjelljen e planifikimeve ditore dhe përparimin e nxënësve, ndërsa 6,7 % janë përcaktuar në bashkëpunim me prindërit 10,1% pedagogë janë përgjigjur se nuk kanë përvoj në përpilimin e planit individual arsimor dhe 8 % nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Një pjesë e deklarimeve të pedagogëve sa i përket rolit të tyre në përpilimin e planit arsimor individual:

- *„Gjatë përpilimit të planit arsimor individual bëhen konsultime dhe koordinim me ekipin inkluziv në shkollë dhe bashkëristh bazohen mësimdhënësit ndaj përqindjes dhe planifikimit të nevojave, metodave, formave, mjeteve dhe teknikave të cilat do të jenë adekuat me aftësitë e nxënësit."*
- *„Bashkëpunimi konsultues me mësimdhënësin për përcaktimin e qëllimeve dhe detyrave të cilat mund t'i përvetësojë nxënësi me nevoja të veçanta arsimore. Përcaktimi se cilët lëndë do të shqyrtohen sipas planit individual etj. Përcjellja e arritjeve të nxënësit sipas planit individual arsimor. Përcjellja e planifikimeve ditore për nxënësin sipas planit individual arsimor ".*
- *„Së pari bëhet detektimi i nevojave të nxënësit, kryesisht lloji i përkrahjes që i nevojitet nxënësit në mjedisin shkollor. Dhënia e udhëzimeve dhe zgjedhja e metodave dhe aktiviteteve për punën me nxënësin; zgjedhja e përmbajtjeve konkrete dhe të thjeshta (duke i respektuar parimet e punës, nga*

më lehtë në më vështirë, nga e njohura ndaj të panjohurës, klasifikimi etj.), të kuptueshme për nxënësin dhe të ndërlidhur me jetën dhe përvojën e tij të përditshme; përcaktimi i korrnizës kohore për aktivitetet e caktuara; përkrahja e mësimdhënësit; zhvillimi i ndjenjës së sigurisë dhe besimit; komunikimi i vazhdueshëm; informimi i përbashkët për gjendjet e posakrijuara etj."

➔ *„Mundohem që gjatë planifikimit mësimdhënësi të ketë parasysh se do të ketë nevoj për individualizim dhe diferencim; gjatë planifikimit të aktiviteteve të mbahet llogari për inkluzionin e të gjithë nxënësve në përputhje me aftësitë e tyre; të zbatohen teknika dhe metoda të ndryshme për punë, të nxitet kreativiteti, të përmirësohet jeta individuale etj."*

Tabela 40: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional – psikologëve sa i përket rolit të tyre në përpilimin e planit arsimor individual (PAI)

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Përqindja e zhvillimit socio – emocional kognitiv të nxënësve	40	27,4 %
Përkrahja e mësimdhënësve përmes trajnimeve, përpilimi i materialeve se cilat metoda, forma dhe teknika si dhe mjetet t'i përdorin	28	19,2 %
Definimi i qëllimeve dhe rezultatet në PAI	21	14,4 %
Përkrahja individuale e nxënësve	21	14,4 %
Përkrahja e prindërve	10	6,8 %
Krijimi i klimës së pranimit të nxënësve (tejkalimi i pengesave)	10	6,8 %
Nuk janë përgjigjur	8	5,5 %
Nuk kam përvojë	8	5,5 %
Gjithsej	**146**	

Në paraqitjen tabelare shihet se pjesa më e madhe e bashkëpunëtorëve profesional – psikologë d.m.th. 27,4 %, mendojnë se roli në përpilimin e planit arsimor individual është në përqindje të zhvillimit socio – emocional dhe kognitiv të nxënësve. Për përkrahjen e mësimdhënësve përmes trajnimeve, përpilimeve të materaileve për atë se cilat metoda, forma, teknika dhe mjete t'i përdorin janë përcaktuar 19,2 % e psikologëve, përderisa 14,4 % mendojnë se roli i tyre në përpilimin e planit arsimor individual është në definimin e qëllimeve dhe rezultateve të planit individual arsimor dhe përkrahja indidivuale e nxënësve. 6,8 % janë përcaktuar për përkrahjen e prindërve dhe krijimin e klimës së pranimit të nxënësve (tejkalimi i pengesave). 5,5 % nga psikologët janë përgjigjur se nuk kanë përvojë në përpilimin e planit individual arsimor dhe njejtë aq nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Një pjesë e deklarimeve të psikologëve në lidhje me rolin e tyre në përpilimin e planit arsimor individual:

- *„Edukimi i mësimdhënësve për përcaktimin e nevojave të caktuara arsimore të nxënësve vështirësitë e të cilëve paraqiten për shkak të pengesës, për planifikimin e mësimit dhe vendosja e qëllimeve dhe arritjeve të qarta, për mënyrën e studimit, për përcjelljen e arritjeve, për riaftësimin e procesit të mësimit dhe përcjelljen e llojeve të ndryshme të pengesës që nxisin vështirësi në mësim."*
- *„Ndryshimi diagnostik i zhvillimit kognitiv, social, emocional te nxënësi."*
- *,,Vlerësimi diagnostik i zhvillimit kognitiv, emocional dhe social të nxënësit.''*
- *„Propozimi i strategjive individuale për mësim dhe studim."*
- *„Ndihma e prindërve të nxënësve për përparimin e njohurive për mënyrat e nevojshme të përkrahjes së fëmijëve në shkollë dhe në shtëpi."*
- *„Biseda me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit – përqindja e gjendjes aktuale, vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit, forcat e tij dhe anët e dobta, udhëzimet për punën në kushtet shtëpiake etj."*

Tabela 41: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional – defektologët sa i përket rolit të tyre në përpilimin e planit arsimor individual

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Ngre një iniciativë për pëpilimin e PAI	64	17,4 %
Përqindja e mundësive të nxënësve	64	17,4 %
Përshtatja e qëllimeve nga programet mësimore	64	17,4 %
Përkrahja e mësimdhënësve në realizimin e PAI	64	17,4 %
Revidimi i PAI gjatë vitit	63	17,1 %
Përcjellja e përparimit të nxënësve	27	7,4 %
Kordinimi me ekipin shkollor inkluziv	21	5,7 %
Gjithsej	**367**	

- *„Përpilimi i materialit edukativ për mësimdhënësit dhe prindërit për karakteristikat e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, si dhe ato me vështirësi specifike në mësim (disleksia, disgrafia, diskalkulia, ADHD), si dhe përpilimi i udhëzimeve të përgjithshme për punën me këto nxënës."*
- *„Përpilimi i planit të nxënësit për aftësimin e nxënësit për zbatimin e metodave dhe teknikave të mësimit efikas (udhëzimet për mësimin e sukseshëm)."*
- *„Planifikimi i përfshirjes së nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore me qëllim zhvillimin e anëve të fuqishme."*
- *„Përcjellja e përparimit të nxënësit (fletë evidentuese)."*
- *„Psikologu merr pjesë në përpilimin e planit arsimor individual në pjesën e zhvillimit socio – emocional dhe kognitiv të nxënësit, me çka paraprin përqindja e potencialeve të nxënësit në pjesën e adaptimit social, pjekurisë emocionale dhe stabilitetit emocional, përqindja e funksionimit kognitiv (vëmendja, koncentrimi, potencialet intelektuale, përqindja e mendimit sipas formës, përmbajtjes etj)".*

Në pasqyrën tabelare është e mundshme përfshierja karaktersitike proporcionale e disa përgjigjeve të defektologëve të cilët kanë të bëjnë me rolin e tyre në përpilimin e planit arsimor individual. Kryesisht me 17,4 % janë të përfshirë përgjigjet: përqindja e mundësive të nxënësit; përshtatja e qëllimeve të programit mësimor; përkrahja e mësimdhënësve në realizimin e planit arsimor individual; rishqyrtimi i planit arsimor individual gjatë vitit dhe përcjellja e përparimit të nxënësve. 7,4 % e defektologëve mendojnë se roli i tyre në përpilimin e planit arsimor individual është në koordinim të ekipit shkollor inkluziv dhe 5,7 % në gritjen e iniciativës për përpilimin e planit arsimor individual.

Një pjesë e përgjigjeve të defektologëve sa i përket rolit të tyre në përpilimin e planit arsimor individual:

- *„Sipas propozimit të prindit dhe mësimdhënësit inicoj mbledhje të planit individual arsimor"*
- *„E udhëheq mbledhjen për përpilimin e planit arsimor individual."*
- *„I koordinoj anëtarët e ekipit inkluziv të nxënësit."*
- *„Jap mendim personal për definimin e anëve të forta dhe të dobta të nxënësit dhe nëse ka nevoj marr pjesë në diferencimin e qëllimeve."*
- *„Kam punë konsultuese dhe këshilldhënëse gjatë procesit të përpilimit të planit arsimor individual dhe jam në kontakt të vazhdueshëm me mësimdhënësit dhe prindërit."*
- *„Me fillimin e secilit vit shkollor përmes vizitave të orëve ndërsa vetë mësimdhënësit klasor dhe lëndor i orientojnë dhe pasiqë nxënësi do të detektohet, së pari e mbykqyri bashkërisht me ekipin inkluziv nevojën e veçanatë arsimore, e vlerësojë nivelin e tij të aftësive funksionale të cilat janë relevante për vetë procesin arsimor dhe në koordinim me të gjithë anëtarët e ekipit inkluziv, ndërsa veçanarisht me*

Tabela 42: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional – pedagogëve sa i përket punës së tyre për realizimin e planit arsimor individual

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Përcjellja e nxënësit gjatë orës	40	25 %
Takime konsultuese me mësimdhënësit/mbykqyrje në planifikimin e tyre	39	24,4 %
Konsultime me defektologun/me ekipin inkluziv	24	15 %
Takimi me prindërit	20	12,5 %
Përgjigje të padefinuara/të vazhdueshme, përcjelli vazhdimisht	15	9,4 %
Nuk kam përvoj	10	6,2 %
Nuk janë përgjigjur	12	7,5 %
Gjithsej	**160**	

mësimdhënësin e tij, e përpiloj planin individual arsimor. Përcaktoj se cilët qëllime do të realizohen përmes cilëve aktivitete, metoda, teknika, forma të punës, me cilët mjete visuale, vallë do të përdoret teknologjia asistive etj. Përcaktoj se çfarë lloji të përkrahjes individuale do të nevojitet, prej kujt, kur dhe me çfarë intervali."

- *„Roli im në përpilimin e planit arsimor individual është që të bëj përqindjen e mundësive dhe aftësive të nxënësve. Madje, bashkërisht me mësimdhënësin e shqyrtojmë programin mësimor dhe parashohim se në cilët pjesë qëllimet e parapara duhet të zvoglohen që të mundet nxënësi të arrijë sukses."*
- *„Koordinimi ndërmjet të gjithë anëtarëve të ekipit inkluziv, përcjellja dhe observimi i nxënësit, bashkëpunimi me prinëdrit, me mësimdhënësit (mësimdhënësit klasor dhe lëndor) sipas nevojës konsultimi me institucionet kompetente adekuate."*

Në pasqyrën tabelare shihet se një pjesë më e madhe e bashkëpunëtorëve profesional – pedagogë, kryesisht 25 %, janë të mendimit se roli i tyre në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual është në përcjelljen e nxënësit gjatë orës. Për takimet konsultuese me mësimdhënësit/mbykqyrje në planifikimet e tyre janë përcaktuar 24,4 % të pedagogëve, përderisa15 % mendojnë se roli i tyre në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual është në konsultimin me defektologun/me ekipin inkluziv shkollor, ndërsa 6,2 % janë përcaktuar me prindërit. 12,5 % e pedagogëve kanë dhënë përgjigje të padefinuara/në kontinuitet, përçdo ditë përcjelli, 9,4 % pedagogë janë përgjigjur se nuk kanë përvoj në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual dhe 7,5 % nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Tabel 43: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional – psikologët sa i përket rolit të tyre në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Vizita e orëve/vëzhgimi i nxënësit	44	33,1 %
Biseda me mësimdhënësit/shqyrtimi i PAI	38	28,6 %
Puna individuale me nxënësin	15	11,3 %
Biseda me prindërit	15	11,3 %
Analiza/përcjellja e përparimit	5	3,7 %
Nuk janë përgjigjur	8	6 %
Nuk kam përvoj	8	6 %
Gjithsej	**133**	

Një pjesë e deklaratave të pedagogëve sa i përket rolit të tyre në përcjelljen e realizimit të PAI:

- *„Gjatë vizitës së orëve i përcjelli aktivitetet të cilat kërkohen nga nxënësi me nevoja të veçanta arsimore, vallë është ajo në mbështetjen e përgatitjes ditore, cilat janë qëllimet e caktuara për nxënësin dhe arritjet e qëllimeve gjatë orës, të caktuara nga mësimdhënësi."*
- *„Përcjellja e orëve te nxënësi me nevoja të veçanta arsimore. Përcjellja e arritjeve përmes dokumentacionit pedagogjik, hsqyrtimi i testeve, fletat e punës, hartimet me shkrim etj. Dhe konsultimet me mësimdhënësit dhe defektologu në shkollë."*
- *„Përmes vizitës së orës, mbykqyrjes në realizimin e planifikimit, vëzhgim në planifikimet ditore, përpilimi i protokollit adekuat për evidentimin e arritjeve të nxënësve dhe ndarja me anëtarët e ekipit, përcjellja e vazhdueshme e realizimit të planit arsimor individual."*
- *„Përcjellja dhe vëzhgimi i orëve të caktuara mësimore, përcjellja e drejtpërdrejtë e metodave dhe formave që përdoren në punën me nxënësin dhe përshtatjen e tyre, përcjellje e tërthortë e realizimit përmes vëzhgimit në evidencën pedagogjike, si dhe përmes raporteve për punën me këta nxënës nga mësimdhënësit."*
- *„Mbykëqyrje në punimet e nxënësve nga lëndë të caktuara mësimore ku kontrollohet, se vallë fëmija i ka kuptuar përmbajtjet e nevojshme. Bisedë me mësimdhënësit për përparimin e nxënësve, për gjendjet e reja të krijuara."*

Roli i psikologut në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual:

Në pasqyrën tabelare shihet se një pjesë më e madhe e bashkëpunëtorëve profesional – psikologë kryesisht 33,1 %, janë të mendimit se roli i tyre në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual është përmes vizitës së orëve/vëzhgimit të nxënësit. Për bisedën me nxënësit/rishikimi i PAI janë përcaktuar 28,6 % e psikologëve, përderisa nga 11,3% mendojnë se roli i tyre në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual me nxënësit dhe biseda me

prindërit 3,7 % nga psikologët janë deklaruar për analizën e përparimit të nxënësit dhe 6% e psikologëve janë përgjigjur se nuk kanë përvoj në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual edhe njejtë ashtu nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Një pjesë e deklaratës së psikologëve sa i përket rolit të tyre në përpilimin e planit arsimor individual:

- *„Drejtpërdrejt përmes observimit dhe përcjelljes së mësimit dhe tërthorazi përmes analizës së njohurive të fituara nga mësimdhënësit dhe prindërit, përcjellja formative e mësimit dhe arritjeve, vlerësimi përshkrues, analiza e raporteve nga evaluimi, përcjellja dhe analiza e treguesve, në portfoliot e nxënësve."*
- *„Observimi i nxënësit gjatë orës dhe gjatë kohës së realizimit të disa aktiviteteve, me atë se vallë dhe si planifikohen aktivitetet e nxënësve, si është raporti mësimdhënës – nxënës, nxënës – nxënës, kryesisht ndaj detyrave dhe materialeve që i fiton, si komunikon me tjerët, sa është përshtatja e tyre, vallë mundet në mënyrë të pavarur t'i kryej detyrat''*
- *„Përcillen dhe krahasohen qëllimet e parapara sipas planit individual arsimor me theks në qëllimet specifike i cili realizim duhet ta paraqes përparimin te nxënësi."*
- *„Bashkëpunimi dhe komunikimi aktiv me asistentët personal dhe pedagogjik të nxënësit si dhe me mësimdhënësit të cilët i ligjerojnë, me qëllim vëzhgimin e anëve të caktuara të mira dhe jo sa duhet mirë në realizimin e planit arsimor individual si dhe përmirësimin e përparimit të nxënësit."*
- *„Me marrëveshje, sipas planit arsimor individual përfshierja e drejtëpërdrejtë në realizimin e qëllimeve të caktuara specifike nga plani arsimor individual me qëllim, përparim më të mirë të nxënësit (puna individuale e motivimit, komunikimi, modifikimi i sjelljes, problemet emotive dhe adaptimi i nxënësit në paralele)."*
- *„Sipas nevojës kryhet shqyrtimi i planit individual arsimor."*

Tabela 44: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional – defektologëve sa i përket rolit të tyre në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual

Kategoritë e përgjigjes	Numri	Përqindja
Vizita e orëve/vëzhgimi i nxënësit	20	30,3 %
Konsultimet/bashkëpunimi me mësimdhënësin/përcjellja e raporteve sipas formularëve të përpiluar paraprakishtl	19	28,8 %
Puna individuale me nxënësin	18	27,3 %
Biseda me prindërit	9	13,6 %
Gjithsej	**66**	

- *„konsultime me mësimdhënësin rreth përparimit, vlerësimit të arritjeve përmes orëve dhe punës (përkrahjes) individuale me nxënësin për përforcimin e vetëbesimit dhe kapacitetit të tij."*
- *„Përcjellja dhe vëzhgimi i orëve të caktuara mësimore, përcjellja e drejtpërdrejtë e realizimit të përmbajtjeve dhe aktiviteteve të parapara, përcjellje e drejtpërdrejtë e metodave dhe formave që përdoren në punën me nxënësin dhe përshtatjen e tij, përcjelljen indirekte të realizimit përmes vëzhgimit në evidencën pedagogjike dhe dokumentacionin si dhe përmes raporteve për punën me këto nxënës nga mësimdhënësit."*
- *„Mbykëqyrje në punimet e nxënësve nga lëndë të caktuara mësimore ku kontrollohet, se vallë fëmija i ka kuptuar përmbajtjet e nevojshme. Bisedë me mësimdhënësit për përparimin e nxënësve, për gjendjet e reja të krijuara, bisedë më prindërit"*

Në paraqitjen tabelare vërehet se përqindja më e madhe e defektologëve kryesisht 30,3% janë përgjigjur se roli i tyre në përcjelljen e realizimit të planit arsimor individual është përmes vizitës/vëzhgimit të orës së nxënësit. 28,8 % prej tyre se rolin e tyre me konsultues/bashkëpunimi me mësimdhënësin/përcjellja e raporteve sipas formularëve të përpiluar 27,3 % - puna individuale me nxënësin dhe 13,6 % - bisedë me prindin.

Një pjesë e deklaratës së defektologëve sa i përket rolit të tyre në përpilimin e planit arsimor individual:

- *„Komunikim i vazhdueshëm me mësimdhënësin, prindin, nxënësin."*
- *„Revizioni i planit arsimor individual, në tre muaj."*
- *„Vazhdimisht jam në kontakt me mësimdhënësit dhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimore edhe ajo përmes orës, si dhe gjatë pushimeve, aktiviteteve jashtëmësimore, aktivitetet e lira të nxënësve, ekskursionet dhe bëj vrojtim në orë me përcjelljen e përgatitjes ditore të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, ndihmoj në përpilimin e testeve për vlerlësim, çek lista, zgjedhje dhe përpilim të mjeteve mësimore''*
- *„Sipas nevojës asistoj si në vijimin e aktiviteteve mësimore, ashtu edhe në të gjithë aktivitetet jashtëmësimore. Me mësimdhënësin, ndërsa mundohemi edhe me prindërit pas secilës temë të kaluar, kemi qasje të cilat nga qëllimet e parapara janë realizuar me analizë të fletave evidentuese të nxënësit për secilin trimujorsh, si edhe për punimet e nxënësve, që të shqyrtojmë se si nxënësi përparon në secilin zhvillim dhe në arritjen e njohurive të parapara."*
- *Të gjithë aktivitetet e theksuara janë në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesional dhe mësimdhënësit:*
- *Evaluimi i planit individual arsimor si dhe revizioni nëse është caktuar puna.*
- *Përpilimi i formularëve për raportet e mësimdhënësve për realizimin e mësimit.*
- *Udhëheqja e portfolios së nxënësit me kopje të të gjithë planeve arsimore individuale, evaluimi i planeve individuale arsimore, fleta për përcjelljen e nxënësit dhe punimet e nxënësve, të cilët e karakterizojnë përparimin e tij.*
- *Analiza e njohurive të fituara dhe vërtetimi i përparimit të nxënësit sipas portfolios.*

- *Përgatitja e procedurës për përpilim dhe përcjelljen e planit arsimor individual, si dhe procedura tjera të nevojshme për definimin e mënyrës së punës së nxënësve me nevoja të ndryshme arsimore (me kërkesë të Inspektoriatit shtetëror për arsim).*
- *Observimi dhe përcjellja e mësimit të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, në paralele.*
- *Përkrahja individuale e nxënësit me nevoja të veçanata arsimore gjatë kohës së mësimit (paralelisht me mësimdhënësin), në përshtatje me nevojën e caktuar.*

Nga pasqyra tabelare mund të konstatohet se në cilët segmente të procesit edukativo arsimor, bashkëpunëtorët profesional (pedagogu, psikologu dhe defektologu) janë më tepër të përfshirë në dhënien e përkrahjes individuale të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Është konstatuar se të gjithë bashkëpunëtorët profesional (pedagogu, psikologu dhe defektologu) në përqindjen më të madhe (26,3 % për pedagogun, 29,1 % për psikologun dhe 33 % për defektologun) përkrahjen individuale të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore e japin gjatë orës. Gjatë pushimit nxënësit me nevoja të veçanta arsimore përkrahje më të madhe marrin nga psikologu. Gjatë orës, aktivitetet jashtëmësimore dhe aktivitetet e lira të nxënësve përkrahje më të madhe marrin nga defektologu dhe gjatë kohës së mësimit plotësues, përkrahjen më të madhe e marrin nga pedagogu.

Tabela 45: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional (pedagog, psikolog dhe defektolog) për dhënien e përkrahjes individuale të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore varësisht nga segmentet e ndryshme të procesit edukativ - arsimor

Bashkëpunë-tori profesional	Gjatë orës	Gjatë pushimit	Gjatë aktivite-teve jashtëmë-simore	Gjatë kohës së aktivite-teve të lira të nxënësve	Gjatë kohës së mësimit plotë-sues
Pedagogu	26,3 %	18,6 %	22,3 %	16,5 %	16,2 %
Psikologu	29,1 %	21,9 %	21,1 %	12,8 %	15,1 %
Defektologu	33 %	16,7 %	22,4 %	16,8 %	11,2 %

Një pjesë e përgjigjeve që kanë të bëjnë me periudhën e përkrahjes së dhënies individuale të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nga ana e bashkëpunëtorëve profesional (pedagogu, psikologu dhe defektologu)

Pedagogu përkrahjen individuale nxënësit ja jep në atë mënyrë **që i jep udhëzime** sesi të mësoj, se si ta mbaj vëmendjen, ndërsa gjatë orës i ndihmon t'i kuptojë kërkesat e dhëna nga mësimdhënësi për zgjidhjen e detyrave etj.

,,Me nxënësin punohet sipas marrëveshjes paraprake për mësimdhënësin, varësisht nga pesha e temës me të cilën duhet të punohet gjatë orës''

- *„Shpesh herë punohet gjatë orës kur është përpiluar fleta mësimore e mësimdhënësit, por edhe në hapësirat e shërbimit profesional kur ka nevojë nga manipulime të caktuara."*
- *„Realizojë marrëveshje këshillëdhënëse me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore për zhvillimin e vetëbesimit të tij dhe përparimin e socializimit të tij, e mësoj për mënyrat e përvetësimit të materialit mësimor, bëhet të ushtruarit e përmbajtjeve mësimore nga matematika dhe shkrim – leximi gjuhësor."*
- *„Mësimi individual dhe ndihma e nxënësve gjatë shkrim – leximit dhe përvetësimit të teknikës së leximit, nocionet themelore matematikore si dhe operacionet, duke përdorur metoda adekuate dhe teknika. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive të caktuara. Ndihma dhe përkrahja e nxënësit gjatë socializimit në paralele dhe inkluzioni, së bashku me nxënësit tjerë në të gjithë lëmit e procesit edukativo - arsimor."*
- *„Identifikimi i interesave specifike, përkrahja dhe përfshierja në realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore të nxënësit në shkollë."*
- *„Bashkëpunimi me prindërit e tyre me qëllim ndihmë dhe përkrahje të nxënësve për tejkalimin e situatave të caktuara konkrete."*
- *Psikologu punon me këshilla ndaj nxënësit në pjesën e përforcimit të motivimit dhe vetëbesimit të nxënësit, ndërtimin e fotografisë pozitive për vete dhe qëndrim pozitiv ndaj mjedisit të shkollës, tejkalimi i vështirësive emocionale, përkrahja në zgjedhjen dhe zbatimin e teknikave për mësim adekuat të mundësive të nxënësve.*
- *„Varësisht nga vështirësitë e nxënësit, përkrahja individuale ka të bëjë me ushtrimet konkrete të planifikuara në pjesën e zhvillimit kognitiv, emocional dhe social të nxënësve."*
- *„Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore kanë nevojë për përkrahje të nxënësve – moshatarëve tjerë me qëllim zhvillimin e vetëdijes dhe destigmatizimin, pranimin e nxënësve me vështirësi dhe përkrahje reciproke."*
- *„Përdorimi i instrumenteve për përqindjen e mbamendjes, koncentrimit, motivimit dhe kreativitetit."*
- *„Nxitja, zhvillimi dhe përmirësimi i disa aftësive dhe interesave me përdorimin e materialeve edukative dhe manipuluese."*
- *„Shpeshherë përkrahja ime ka të bëjë me përqindjen se sa kohë mund ta përcjell mësimdhënësi, sa kohë mund të jetë i fokusuar në aktivitetin konkret, në cilësinë e koncentrimit, për sa kohë*

manifestohet lodhja, sa kohë i duhet të përfshihet në aktivitet tjetër dhe si e ka sjelljen nga momenti kur nuk mundet të përcjell mësim. Me rëndësi të veçantë është të bëhet përqindja se sa kohë nxënësi mund të përcjell mësimin dhe mos ta prish sigurinë e fëmijëve tjerë''

- *„Gjithashtu jap përkrahje gjatë përvetësimit të rregullave të sjelljes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe socializimin e tyre."*
- *„Në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë përmes mësimdhënësit. Drejtëpërdrejtë, intervente apo përkrahje individuale më afatgjate. Realizimi i aktiviteteve. Plani i përpiluar i përbashkët me ekipin e bashkëpunëtorëve profesional dhe plani personal për përkrahjen individuale të nxënësit. Ndihmë në përmirësimin e vështirësive specifike në disa fusha: vëmendja dhe koncentrimi, percepcionet, motorika, emocionet dhe marrëdhëniet sociale, funksionet kognitive (puna ekipore me pedagogun dhe defektologun dhe aktiviteti individual). Përcillet shkalla e kryerjes së detyrave të parashtruara, aftësitë e arritura dhe shkathtësië gjatë zbatimit të asaj që është mësuar në aktivitetet dhe situatat e përditshme, aftësitë dhe shkathtësitë e arritura, aftësitë dhe shkathtësitë e arritura gjatë zbatimit të asaj që është mësuar në aktivitetet dhe situatat e përditshme, shprehit e arritura të punës (raporti ndaj punës, mjedisi i punës, individët e mjedisit dhe detyrat e parashtruara, bashkëpunimi dhe pjesëmarrja gjatë procesit të mësimit).''*

Defektologu shpesh herë punon me riaftësimin psikomotorik, integrimin senzor, zhvillimin e të folurit dhe të shprehurit me gojë, ndihmë në socializimin e nxënësit, gjatë orës në kuptimin e udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi, zgjidhja e testeve etj.

- *,,Së pari bëj vlerësimin e defektit të nxënësit me qëllim të kem fotografi të qartë për funksionimin momental të nxënësit dhe në cilën fushë duhet t'i mundësohet përkrahja adekuate. Në pajtim me nevojat e nxënësit realizoj ushtrime psikomotorike dhe stimuluese, ushtrime për motorikën e rregullt dhe të përafërt, zotërimi i tërësisë trupore, lateralizimi, grafomotorika, ndihma në përvetsimin e përmbajtjeve mësimore, me ndihmën e fletave të adaptuara mësimore, lojëra edukative, teknologjia asistive....''*
- *„Konsultohem me mësimdhënësit që të shikojmë se ku është ndihma më e nevojshme dhe përkrahja e nxënësit dhe ndihmoj individualisht, aq sa kam mundësi, nëse nxënësi ka vështirësi në përjetimin e skemës trupore, koordinimin psikomotorik atëherë fokusohem në ushtrimet për riedukimin psikomotor si dhe përjetimin e tërësisë trupore."*
- *„Në hapsirë të posaçme (dhomë me senzor) punohet me fëmijën, me zbatimin e një numri të madh të mjeteve mësimore si dhe mjeteve ndihmëse me të cilat fëmija vjen në kontakt dhe më leht i kupton nocionet. Punohet individualisht me një apo me dy fëmijë. Me nxënësin bëhen ushtrime për riedukimin psikomotor, ushtrime për linearen dhe grafomotorikën, orientim në hapësirë dhe kohë, lateralizimi dhe njohja e pjesëve të trupit, bëhen teknikat e leximit dhe të shkruarit dhe përpunohen të gjithë ato përmbajtje mësimore të cilat nxënësit i përvetsojnë më vështirë."*
- *„Përkrahja dhe ndihma e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore realizohet*

përmes trajtimeve logopedike me nevoja të veçanta për riedukimin psikomotor, korrigjimin e të folurit, dhe tejkalimin e pengesave në zhvillimin dhe funksionimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore."

- *„Jap propozime për modifikimin dhe adaptimin në mësim dhe hapësirë. Ndihmoj gjatë orientimit profesional dhe zgjedhjen e profesioneve adekuate për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Kujdesem dhe ndihmoj për përfshierjen adekuate të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në aktivitetet e bashkësive të nxënësve dhe në përgjithsi në ,,jetën dhe punën e shkollës."*
- *„Përcaktoj nevojën për servis shtes për përkrahje."*

Përqindja më e madhe e pedagogëve, kryesisht 29,6 %, dhe nga psikologët, kryesisht 35,4 % e përcjellin nxënësin gjatë orës, por nuk përfshihen në ndihmën dhe përkrahjen e drejtpërdrejtë. Për dallim nga ata, një pjesë më e madhe e defektologëve 40 % janë deklaruar gjatë kohës së orës punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore paralelisht me mësimdhënësit i cili realizon mësim me nxënësit tjerë. Një mënyrë e tillë e përfshierjes është dukshëm në një masë të madhe prezente te pedagogët 16,5 % te psikologët 19,2 %. **Se punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore së bashku me mësimdhënësin në pjesën e orës kur nxënësit tjerë punojnë në mënyrë të pavarur, janë deklaruar** 27,6 % e pedagogëve 20 % e psikologëve dhe 22,7 % e defektologëve.

Nëse bëhet krahasimi ndërmjet pedagogut, psikologut dhe defektologut në lidhje me përgjigjen që nuk punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë orës, do të konstatohet se përqindja më e madhe janë të përfshirë psikologët 20,8 %, mandej pedagogët 17,9 % dhe me një përqindje të vogël janë të përfshirë defektologët apo 10,7 % që është dyfish më i vogël krahasuar me pedagogun dhe psikologun.

Tabela 46: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional (pedagogë, psikologë, dhe defektologë) për mënyrat e përfshierjes në dhënien e ndihmës dhe përkrahjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore gjatë orës

Bashkëpunëtori profesional	Punoj me nxënësin me NVA paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë	Punoj me nxënësin me NVA së bashku me mësimdhënësin në pjesën e orës kur tjerët nxënës punojnë në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë	E përcjelli nxënësin, por nuk përfshihem në ndihmën e drejtëpërdrejtë dhe pëprkrahjen e nxënësit	Nuk punoj me nxënësin me NVA gjatë orës	Pa përgjigje
Pedagogu	16,5 %	27,6 %	29,6 %	17,9 %	8,3 %
Psikologu	19,2 %	20 %	35,4 %	20,8 %	4,6 %
Defektologu	40 %	22,7 %	24 %	10,7 %	2,7 %

Në bazë të analizës së bërë mund të konstatohet se defektologët si bashkëpunëtor profesional janë të përfshirë në punën e drejtëpërdrejtë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë orës paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësimin me nxënësit tjerë, që inicon dilemë shikuar nga aspekti i inkluzionit. **Vallë një qasje e tillë në punë kur defektologu dhe mësimdhënësi punojnë paralelisht me nxënës të ndryshëm, përkatësisht mësimdhënësi me nxënësit me zhvillim tipik ndërsa defektologu me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, paraqet inkluzion të dukshëm apo ndarje të fshehtë të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore?**

Përqindja më e madhe e pedagogëve - 26 % dhe psikologët- 25,9 %, gjatë kohës së realizimit të aktiviteteve jashtëmësimore e përcjellin nxënësin, por nuk përfshihen në ndihmën dhe përkrahjen e drejtëpërdrejtë. Për dallim prej tyre një pjesë e madhe e defektologëve - 44,7 % janë deklaruar se gjatë kohës së aktiviteteve jashtëmësimore punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë.Një mënyrë e tillë e përfshierjes është dyfish më e vogël te pedagogët - 21,3 % dhe te psikologët - 25,2 %. Për përfshierjen në dhënien e ndihmës dhe përkrahjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore së bashku me mësimdhënësin në pjesën e aktiviteteve jashtëmësimore kur nxënësit tjerë punojnë në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë, janë deklaruar 25,3 % e pedagogëve, 17,5 % e psikologëve dhe 19,7 % e defektologëve.

Nëse bëhet krahasimi ndërmjet pedagogut, psikologut dhe defektologut duke e pasur parasysh përgjigjen se nuk punojnë me nxënësit me nevoja të veçanata arsimore gjatë kohës së aktiviteteve jashtëmësimore, do të konstatohet se në përqindje më të madhe janë të përfshiër psikologët- 22,9 %,

Tabela 47: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional (pedagogë, psikologë dhe defektologë) për mënyra e përfshierjes në dhënien e ndihmës dhe përkrahjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore gjatë kohës së aktiviteteve jashtëmësimore

Bashkëpunëtori profesional	Punoj me nxënësin me NVA paralelisht me mësim-dhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë	Punoj me nxënësin me NVA së bashku me mësim-dhënësin në pjesën e orës kur tjerët nxënës puno-jnë në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë	E përcjelli nxënësin, por nuk përfshihem në ndihmën e drejtëpërdrejtë dhe pëprkrah-jen e nxënësit	Nuk punoj me nxënësin me NVA gjatë akti-viteteve jash-tëmësimore	Pa përgjigje
Pedagogu	21,3 %	25,3 %	26 %	19,3 %	8 %
Psikologu	25,2 %	17,5 %	25,9 %	22,9 %	8,4 %
Defektologu	44,7 %	19,7 %	21 %	14,5 %	0 %

mandej pedagogët - 19,3 % dhe me përqindje më të vogël janë të përfshirë defektologë - 14,5 %.

Në bazë të analizës së bërë mund të konstatohet se defektologët si bashkëpunëtor profesional janë më tepër të përfshirë në punën e drejtëpërdrejtë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë kohës së aktiviteteve jashtëmësimore. Ata punojnë më tepër me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon aktivitete jashtëmësimore me nxënësit tjerë dhe për dallim nga pedagogu dhe psikologu, defektologët në përqindje më të vogël janë deklaruar se vetëm e përcjellin nxënësin, por nuk përfshihen në ndihmën e drejtëpërdrejtë dhe në përkrahjen e nxënësit, që shkon në shtojcën e qëndrimit të shprehur paraprak: **Defektologët si bashkëpunëtor profesional janë më tepër të përfshirë në punën e drejtëpërdrejtë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë kohës së aktiviteteve jashtëmësimore.**

Karaktersitikë për këtë paraqitje tabelare është defektologu si përqindje më e madhe - 50 %, psikologu - 43 % dhe pedagogu - 34,8 % janë deklaruar se nuk punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore gjatë mësimit shtues. Për përgjigjen ,,punoj me nxënësin me nevoja të veçanata arsimore paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësimin shtues me nxënësit tjerë'' janë deklaruar 8,9 % të pedagogëve, 9,3 % të psikologëve dhe dyfish më tepër - 20,8 % defektologët.

Në bazë të analizës së bërë mund të konstatohet se një pjesë më e madhe e defektologëve nuk punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore gjatë mësimit shtues. Ata më tepër punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësimin shtues me nxënësit tjerë.

Tabela 48: Përgjigjet e bashkëpunëtorëve profesional (pedagogët, psikologët dhe defektologët) për mënyrat e përfshierjes në dhënien e ndihmës dhe përkrahjes së nxënësve me nevoja të ndryshme arsimore gjatë mësimit shtues

Bashkëpunëtori profesional	Punoj me nxënësin me NVA paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë	Punoj me nxënësin me NVA së bashku me mësimdhënësin në pjesën e orës kur tjerët nxënës punojnë në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë	E përcjelli nxënësin, por nuk përfshihem në ndihmën e drejtëpërdrejtë dhe pëprkrahjen e nxënësit	Nuk punoj me nxënësin me NVA gjatë aktiviteteve jashtëmësimore	Pa përgjigje
Pedagogu	8,9 %	16,3 %	26,7 %	34,8 %	13,3 %
Psikologu	9,3 %	11,5 %	28 %	43 %	7,9 %
Defektologu	20,8 %	12,5 %	12,5 %	50 %	4,1 %

Kjo gjendje del nga fakti që mësimi shtues planifikohet dhe realizohet për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të cilët kanë aftësi mbimesatare (nxënës të talentuar dhe me prirje, e cila përfshierje është 31,28 % nga të gjithë nxënësit me NVA dhe të cilët në përgjithësi i kanë realizuar qëllimet e planifikuara të programit mësimor për lëmin adekuat, i kanë arritur rezultatet e pritura nga mësimi dhe për ata një lloj i tillë i përkrahjes nga bashkëpunëtorët profesional është më pak i nevojshëm, në krahasim me nxënësit me vështirësi në mësim e cila përqindje sillet 20,77 % dhe nxënësit me pengesa të cilët sipas përqindjes janë të përfshirë me 5,81 % nga të gjithë nxënësit me nevoja të veçanata arsimore.

Në bazë të analizës së bërë të të dhënave të fituara nga anketimi i bashkëpunëtorëve profesional (pedagogë, psikolog dhe defektolog) nga shkollat fillore sa i përket rolit të tyre në përpilimin dhe përcjelljen e planit individual arsimor dhe në dhënien e përkrahjes individuale dhe përkrahje për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore vërtetohet **hipoteza 9**:

,,Përkrahja individuale, të cilën nxënësit me nevoja të veçanta arsimore e marrin nga bashkëpunëtorët profesional (pedagogë, psikolog dhe defektolog) në të gjithë segmentet e procesit edukativë arsimor (gjatë orës, pushimit, aktiviteteve jashtëmësimore, aktiviteteve të lira, mësimi plotësues) me kuantitetit dallohet varësisht nga kompetencat e bashkëpunëtorëve profesional''.

Në raport me bashkëpunimin të cilin bashkëpunëtorët profesional e kanë me asistentët personal, vetëm 23 pedagogë janë përgjigjur se kanë pasur bashkëpunim me asistentët personal. Bashkëpunimi, kryesisht është në pjesën e konsultimit dhe shkëmbimit të përvojave për planifikimin dhe realizimin e qëllimeve mësimore.

Një pjesë e përgjigjeve të pedagogëve, të cilët kanë realizuar bashkëpunim me aistentët personal:

- *„Me asistentitn personal bashkëpunojmë në drejtim të dhënies së informatave për asistimin adekuat të nxënësit gjatë kohës së qëndrimit të tij në shkollë, si gjatë orëve ashtu edhe për sigurinë e kushteve për lëvizje pa pengesa në hapësirat e shkollës dhe gjatë kohës së aktiviteteve jashtëshkollore. Në mënyrë plotësuese përfshihet edhe prindi."*
- *„Njohja e asistentëve personal me karaktersitikat dhe mundësitë e nxënësit dhe konsultimet për përparimin dhe sjelljen e tij gjatë orës."*

Vetëm 17 psikologë kanë theksuar se kanë pasur bashkëpunim me aistentë personal. Bashkëpunimi është në pjesën e dhënies së informatave të lidhura me problemin e natyrës socio - emocionale.

Një pjesë e përgjigjeve të psikologëve të cilët kanë realizuar bashkëpunim me asistentët personal:

- *„Nëse nxënësi ka asistent personal bashkëpunojë me atë për shkak të socializimit të nxënësit në paralele, përgatitja e nxënësve tjerë për pranimin e tij, zgjidhja e problemeve nga natyra emocionale me nxënësin, udhëzimi i asistentit personal rreth aktiviteteve konkrete që nxënësit mund ti bëjë gjatë mësimit."*
- *„Bashkëpunimi do të duhet të zhvillohet në nivel më të lartë nga e deritanishmja, përmes përfshierjes më të angazhuar nga ana a tyre dhe përdorimi i ushëzimeve nga trajnimet që i kanë realizuar, përpunimi i raporteve mujore për përcjelljen e nxënësve...."*

Për bashkëpunimin e realizuar me asistentët personal janë deklaruar 18 defektologë. Nëse asistentët janë prindër, atëherë bashkëpunimi është në drejtim të shkëmbimit të informatave për përparimin e fëmijës. Me asistentët personal tjerë, defektologu luan rol të mentorimit të punës së tyre, kryesisht i jepen udhëzime se si ta përcjellin planin individual arsimor të nxënësit.

Një pjesë e përgjigjeve të defektologëve, të cilët kanë realizuar bashkëpunim me asistentët personal:

- *"Po, marrim informatë kthyese për përparimin e nxënësit, japim kahje dhe udhëzime adekuate për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në pajtim me planin individual arsimor, si dhe udhëzime dhe kahje për metodat dhe teknikat e punës."*
- *„Kemi një asistent të tillë edhe atë prind. Përafërsisht është real dhe objektiv, ashtu që shumë na ndihmon gjatë përpilimit të planit individual arsimor, ndihmë dhe përkrahje të vazhdueshme të mësimdhënësit gjatë punës me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore. Kontaktojm kur ka nevojë, veçanërisht kur përpilohet plani arsimor individual, kur bëjmë revizion të të njëjtit dhe në vazhdimësi nëse ka nevojë për adaptim të disa mjeteve dhe mjeteve ndihmëse. Bashkëpunojmë dhe më informon, gjithashtu, nëse ndodhin ndryshime dhe devijime në gjendjen shëndetësore të nxënësit për aktivitetet jashtëmësimit etj."*
- *„Me asistentët personal kam bashkëpunim solid. Me vetë emërimin e tij për asistent personal të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore menjëherë iu jap kahje dhe udhëzime për punë me nxënësin. I njoftoj me pengesat e nxënësit dhe karakteristikat e tij specifike, rolin e tij në shkollë, organizimin e përfshirjes në shkollën tonë, i njoftoj me resurset për punë me nxënësin. I mësojë si të krijojnë komunikim dhe bashkëpunim të mirë me nxënësit, Mësimdhënësit dhe prindërit e nxënësit, si dhe me prindërit tjerë. I njoftoj me planin arsimor individual të nxënësit. Me të kam konsultime të vazhdueshme profesionale me qëllim të përparimit arsimor, zhvillimit individual dhe përfshirjes së drejtë me nxënësit në klasë dhe në mjedisin shkollorë."*

Nga paraqitja tabelare shihet se nga të gjitha mundësitë e ofruara, më shumë bashkëpuntorë profesional (22,3 % defektologë, 15,8 % pedagogë dhe 15,5 % psikologë) janë deklaruar se ka bashkpunim të ndërsjellë dhe këmbim të informatave

me asistentët pedagogjik. Duke krahasuar me bashkpunëtorët profesional, të cilët kanë theksuar se detyrat e punës iu përsëriten, më së shumti me përgjigje të këtillë janë deklaruar defektologët 8,5 %, te pedagogët kjo përqindje është 1,8 % dhe 3,9 % te psikologët. Dukuria e tillë është si rezultat i gjendjes aktuale me angazhimin e asistentëtve personal dhe pedagogjik në ndihmë dhe përkrahje të nxënësëve me nevoja të veçanta pa definim të standardeve dhe kompetencace paraprakisht.

Në bazë të analizës së bërë të të dhënave të fituara nga anketimi i bashkëpunëtorëve profesional (pedagogë, psikologë dhe defektologë) nga shkollat fillore në raport me bashkpunimin që e kanë me asistentët personal dhe arsimoë (pedagogjik), vërtetohet **hipoteza 10:**

,,Bashkpunimin që bashkëpunëtorët profesional (pedagogët, psikologët dhe defektologët) e kanë me asistentët personal dhe pedagogjik (arsimor) në mënyrë sasiore dallohen varësishtë nga kompetencat e veçanta të bashkpunëtorëve profesional".

Tabela 49: Përgjigjet e bashkpunëtorëve profesional (pedagogëve, psikologëve dhe defektologëve) për bashkëpunimin me asistentët pedagogjik (arsimor)

Kategoritë e përgjigjes	Pedagogu	Psikologu	Defektologu
Detyrat e punës na përsëriten	1,8 %	3,9 %	8,5 %
Realizuam detyra dhe aktivitete të ndryshme të nxënësëve me NVA	4,7 %	7,1 %	6,4 %
Nuk kemi kompetenca qartë të definuara	2,4 %	1,3 %	2,1 %
Punojmë bashkë sipas planit të përbashkët të përgatitur të aktiviteteve	4,7 %	3,9 %	5,3 %
Punojmë sipas planit individual të përgatitur të aktiviteteve	5,8 %	5,8 %	10,6 %
Ka bashkëpunim të ndërsjell dhe transfer të informatave	15,8 %	15,5 %	22,3 %
Punojmë në fusha të ndryshme të punës edukative arsimore	2,9 %	6,5 %	0 %
Nuk kemi asistent pedagogjik	24 %	16,2 %	8,5 %
Nuk kanë përgjigje	38 %	39,6 %	36,1 %

PJESA IV
VËREJTET PËRFUNDIMTARE DHE REKOMANDIMET

1. VËREJTET PËRFUNDIMTARE

Nga analiza cilësore e sasiore dhe interpretimi i rezultateve të fituara dalin më tepër përfundime të cilat janë të rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë të arsimit inkluziv në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë e të dhënave të përgjithshme të fituara mund të konstatohet se është vërtetuar hipoteza e përgjithshme e hulumtimit: **„Kuadri eduktiv - arsimor në shkollat fillore të rregullta mendon se resurset e nevojshme (kadrovike dhe organizative) për përforcimin e kapaciteteve për arsim inkluziv janë me cilësi dhe me jocilësi deficitare, kurse realizimin e punës edukative-arsimore me nxënësit me neovoja të veçanta e rëndojnë më shumë faktorë dhe shkaktarë".**

1.1. Nga analiza e bërë e dokumenteve ligjore dhe strategjike-arsimore në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe analizës së bërë të literaturës profesionale kompatibile të problemit hulumtues, vërtetohet konstatimit se në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullativa e konceptit të inkluzionit arsimor të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore bazohen në përvojat pozitive botërore dhe në dokumentet ndërkombëtare kryesore dhe konventave që kanë të bëjnë me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, të përshtatura në kontekstin tonë nacional dhe janë pjesë integrale e Ligjit për arsim fillor.

1.2. Analiza e të dhënave të nxënësëve të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në grupin lëndor tregon se në përqindje më të madhe ose 9,11 % janë përfshijë nxënësit e dalluar dhe të talentuar, derisa përfaqësimi i nxënësëve me vështirësi në mësim është 4,58 %, që është shumë më e vogël në krahasim me grupin klasor, ku përqindja e nxënësëve me vështirësi në mësim është 8,27 %. **Ky dallim ka të bëjë, para se gjithash me procesin e adaptimit të nxënësve në klasat fillestare, kryesisht bëhet fjalë për vështirësi të përkohshme.**

Nëse bëhet krahasim i përqindjes me pengesë me medim dhe vështrim që është 1,28 % dhe përqindja e nxënësëve për të cilët pregatitet plan arsimor idividual që është 1,40 %, do të konstatohet se edhe në grupin lëndor plani individual arsimor pregatitet edhe për nxënësit që nuk kanë udhëzim dhe mendim.

Të dhënat për nxënësit e klasës së I deri V që mësojnë në gjuhën shqipe tregojnë se gjendja është e ngjashme, kryesisht se përqindja më e madhe 7,53 % janë përfaqësuar nxënësit e dalluar dhe të talentuar. Nxënësit me vështirësi në mësime janë me 4,46 % përfaqësim. Nëse bëhet krahasim me përqindjen e nxënësëve me vështirësi me udhëzim dhe medim, që është 0,74 % dhe përqindja e nxënësve për të cilët përgatitet plan arsimor individual - 1,56 %, do të konstatohet e njëjta si dhe për fëmijët që mësojnë në gjuhën maqedonase në grupin klasor, kryesisht se plani arsimor individual pregatitet edhe për nxënësit që nuk kanë udhëzim dhe mendim.

Nga analiza përmbledhëse e të dhënave për përqindjen e nxënësëve të cilët mësojnë në gjuhën maqedonase në grupin klasor dhe lëndor shihet në mësimin e përgjithshëm nga klasa I deri në klasën IX me përqindje më të lartë ose 16,22 % janë përfaqësuar nxënësit e talentuar dhe të dalluar kurse, përfaqësimi i nxënësëve me vështirësi në mësim është 12,85 %.

Në raport me përqindjen e gjendjes së nxënësve romëë që mësojnë në gjuhën maqedonase në grupin klasor dhe lëndor përfaqësimi është 24,64 %, nga të cilët me vështirësi në mësim janë 4,36 %, kurse me pengesa është 0,55 %.

Nga analiza e bërë e këtyre parametrave mund të konstatohet se numri i nxënësëve romëë me vështirësi në mësime (4,36 %) krahasuar me numrin e përgjithshëm të nxënësve me vështirësi që mësojnë në gjuhën maqedonase në grupin klasor dhe lëndor (12,85 %) është përafërsisht një e treta.

Nëse bëhet krahasim me numrin e nxënësve romëë me pengesa në mësim që është 55 % me numrin e përgjithshëm të nxënësëve me pengesa që është 4.21, mund të konstatohet se përfaqësimi i romëëve me pengesa në mësim që mësojnë në gjuhën maqedonase në grupin klasor dhe lëndor, është përafërsisht 9 herë më i vogël.

Nga analiza e të dhënave për përqindjen e nxënësëve që mësojnë në gjuhën shqipe në grupin lëndor, konstatimi është me përqindje të lartë prej 7,53 % janë përfaqësuar nxënësit e talentuar dhe të dalluar, përqindje që është identike me nxënësit në grupin klasor në gjuhën shqipe. Nxënësit me vështirësi në mësim janë me 3,46 % të përfaqësuar. Nëse bëhet krahasim me përqindjen e nxënësve me pengesa me vështrim dhe mendim i cili është 0,63 % dhe përqindja e nxënësëve për të cilët përgatitet plan arsimor individual ose 0,93 %, do të vërtetohet konstatimi i njëjtë sikur edhe për nxënësit që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor, kryesisht se plani arsimor individual përgatitet edhe

për nxënësit të cilët nuk kanë udhëzim dhe mendim. Nga analiza përmbledhëse e të dhënave për përqindjen e nxënësve që mësojnë në gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor vërehet se mësimi i përgjithshën nga klasa I deri në klasën IX me përqindje më të madhe ose 15,06 % janë përfaqësuar nxënësit e talentuar dhe të dalluar, derisa përfaqësimi i nxënësëve me vështirësi në mësim është 7,92 %. Përfaqësimi i nxënësve të talentuar dhe të dalluar që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor është pothuajse identik, por dallimi vërehet në përfaqësimin e nxënësve me vështirësi në mësim ku 12,85% janë përfaqësuar në paralelet në gjuhën maqedonase në raport me 7,92 % në paralelet në gjuhën shqipe. Ky dallim ka të bëjë para se gjithash me përfaqësimin e ndryshëm të nxënësëve romëë në paralelet me mësim në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe. Përfaqësimi në paralelet me mësim në gjuhën maqedonase është 24,64 %, kurse në paralelet me mësim në gjuhën shqipe është vetëm 1,14 %.

Në raport me gjendjen në përqindje të nxënësve romë që mësojnë në gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor përfaqësimi është 1,14 % nga të cilët me vështirësi janë 0,14 %, kurse me pengesa ajo përqindje është 0,06 %.

Në bazë të analizës së bërë të këtyre parametrave mund të konstatohet se përqindja e nxënësve romëë me vështirësi në mësim që është 0,14 %, krahasuar me përqindjen e përgjithshme të nxënësve me vështirësi në mësim që mësojnë në gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor (7,92 %), është e madhe. Ky dallim ka të bëjë përfaqësimin e vogël të nxënësëve romë që mësojnë në gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor, ose 1,14 %.

Nëse bëhet analizë e përqindjes së nxënësëve romëë me vështirësi në mësim (0,14 %) me numrin e përgjithshëm të nxënësve romë që ndjekin mësim në gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor, që është 1,14 %, mund të konstatohet se dallimi është 9 herë më i vogël në raport me nxënësit romë me pengesa në mësim. Ky raport i parametrave është identik edhe te nxënësit romëë me pengesa që mësojnë në gjuhën maqedonase në grupin klasor dhe lëndor. Duke pasur parasysh përfaqësimin e vogël të nxënësëve romë që mësojnë në gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor, këto rezultate dhe raporte nuk kanë relevancë në sjelljen e çfardo konkluzioni.

Nga analiza përmbledhëse e të dhënave për gjendjen në përqindje të nxënësve që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqupe në grupin klasor dhe lëndor vërehet se mësimi i përgjithshëm nga klasa I deri në klasën IX me përqindje më të madhe ose 31,28 % janë përfaqësuar nxënësit e talentuar dhe të dalluar, kurse përfaqësimi i nxënësve me vështirësi në mësim është 20,77 %. Në raport me gjendejn në përqindje të nxënësve romë që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor përfaqësimi është 25,78% nga të cilët me vështirësi në mësim janë

4,50%, kurse me pengesa ajo përqindje është 0,61 %.

Nëse bëhet krahasim i përqindjes së nxënësve me pengesa me vështrim dhe mendim që është 4,41 % dhe përqindja e nxënësve për të cilët përgatitet plan individual arsimor - 5,90 %, do të vërtetohet konstatimi sikur edhe për nxënësit që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në grupin klasor dhe lëndor, kryesisht se plani arsimor individual përgatitet edhe për nxënësit që nuk kanë udhëzim dhe mendim. **Në bazë të analizës së përgjithshme të të dhënave del se gjendja numerike e nxënësëve me pengesa, me vështirësi në mësim dhe nxënësve të dalluar, sipas paraleleve dhe përkatësisë nacionale në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut është interpretuar në mënyra të ndryshme.**

1.3. Ekipi inkluziv i shkollës në 83, 1 % të shkollave kanë përgatitur program për punën e vet, 67,6 % kanë përgatit plan aksionar për punën e ekipit shkollor inkluziv,71,7 % janë deklaruar se ekipi inkluziv i shkollës ka përpunuar procedur dhe formular për përgatitjen e planit *arsimor* individual". Drejtorët e shkollave të cilët janë deklaruar se ekipi shkollor inkluziv nuk ka përgatitur procedurë dhe formular për përgatitjen e planit arsimor individual, në përqindje të madhe ose 34,6 % kanë dhënë arsyetim se nuk janë trajnuar për aktivitet të këtillë; 30,8 % për shkak të mospasjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore; 18,5 % se deri paradokohe nuk kanë pasur ekip inkluziv të shkollës; 8,6 % se arsyeja është mos posedimit të shërbimit komplet të bashkpunëtorëve profesional dhe 7,4 % kanë dhënë arsyetim se shkolla është në procedurë të përgatitjes së procedurës dhe formularit për përgatitjen e planit arsimor indivudal. Përqindje e madhe e shkollave ose 68,9 % kanë procedure për ndjekjen e përparimit/rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor individual**.** Këto të dhëna janë dëshmi për vërtetimin e **hipotezës 4:**

„Ekipet inkluzive shkollore në më tepër shkolla fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë përgatitur akte interne, procedura dhe protokolle për punën e vet (programe, plane aksionare për punën e vet, procedura dhe formular për përgatitjen e planit individual arsimor për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe procedurë për ndjekejn e përparimit/ rezultateve të nxënësit që punon sipas planit arsimor indivudal".

1.4. Gjysma e drejtorëve të anketuar nëpër shkolla ose 50,4 % janë përgjigjur se mësimdhënësit e grupit klasor janë të aftë të përgatisin plan arsimor individual. Më pak se gjysma e drejtorëve të anketuar ose 47,7 %, janë përgjigjur se mësimdhënësit e grupit lëndor janë të aftë të përgatitin plan arsimor indivudal.

Më tepër se gjysma e të anketuarëve ose 52,2 % mendojnë se Mësimdhënësit e grupit lëndor janë të aftë t'i përdorin metodat e diferencimit. Konstatim i përgjithshëm, dhe njëherit edhe **hipoteza 5 është**:

„Mësimdhënësit e shkollave fillore në pjesë të madhe nuk janë të trajnuar për përgatitjen dhe ndjekjen e planeve induviduale arsimore, aplikimin e diferencimit, përshtatjen e kushteve, metodave dhe aktiviteteve për nevojat e nxënësëve me pengesa dhe përcjelljen e të arriturave të tyre".

1.5. Nga gjithësej 235 drejtorë të shkollave fillore që iu përgjijgën pyetjeve për kyçjen e asistentëve personal në ndihmë dhe përkrahje të nxënësit, 181 ose 77 % u përgjigjën se nuk kanë asisten personal, kurse 54 ose 23 % janë përgjigjur afirmativisht .

Gjithsejt 54 shkolla fillore kanë paraqitur se për ndihmë dhe përkrahje të nxënësëve me nevoja të veçanta arsimore kanë asistentë personal; 21 shkolla kanë nga 1 asistent; 19 shkolla nga 2; tre shkolla kanë nga 3 asistentë personal; 3 shkolla kanë nga 4 asistentë; një shkollë ka 5 asistentë; një shkollë ka 6 asistent dhe dy shkolla kanë paraqitur nga 9 asistentë. Shkollat ose më konkretisht drejtorët e shkollave janë deklaruar se 94,8% nga asistentët e kyçur (persona që nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmë dhe përkrahje të nxënësëve nuk janë në lidhje farefisnore me nxënësin, kundejt 5,2 % të cilët janë në lidhje farefisnore me personin me nevoja të veçanta arsimore**. Në raport me profesionin e asistentëve personal vërehet diapazon i madh i porfesioneve** nga të cilët përqindje më e madhe ose 34,8 % janë të përfaqësuar defektologët, 17,9 % janë me profesione të shkollimit të mesëm profesional, 17,8 % janë psikologë, 10,7 % janë mësimdhënës klasor. Me përqindje më të vogël janë përfaqësuar: punëtor social, pedagog, mësimdhënës lëndor, edukator, filolog, filozof, administratë publike, sociolog, nënë, gjyshe dhe motër.

Në raport me posedimin e çertifikatës për trajnimin e ndjekur 74,8 % janë përgjigjur se posedojnë çertifikat dhe 25,2 % se kanë çertifikat për ndjekjen e trajnimit për asistentë personal. Për atë prej kujt janë angazhuar ose financuar asistentët personal, 38,3 % e drejtorëve e kanë potencuar familjen, kurse 61,7 % komunën.

Përgjigjet e drejtorëve në raport me aktivitet në të cilat janë të kyçur asistentët personal janë si vijonë: 92,2 % se asistentët personal i ndihmojnë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në kryerjen e detyrave gjatë orëve, 80 % se i ndihmojnë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në kryerjen e detyrave në aktivitet jashtë mësimit, 76,5 % se u ndihmojnë nxënësëve me nevoja të veçanta arsimore në kryerjen e detyrave në kryerjen mësimin plotësues, 69,5 % nga drejtorët e shkollave se asistentët personal u ndihmojnë nxënësëve me nevoja të veçanta, në kryerjen e aktiviteteve fizike dhe të uljes dhe me përfaqësim më të vogël ose 59,1 % se asistentët personal i ndohmojn nxënësit në mbajtjen e higjienës personale.

Nga këto tregues konstatohet se asistentët personal pjesëmarrje më të madhe në ndihmën e nxënësëve me nevoja të veçanta arsimore kanë në realizimin e

detyrave gjatë orës mësimore që tregon se asistentët personal në masë të madhe hyn në kompetencat e asistentëtve pedagogjik, kryesisht e marrin rolin e tyre në këtë aktivitet shumë të rëndësishëm gjatë orës. Nëse merret parasysh edhe profesioni i asistentëve personale, kryesisht se 17,9 % e tyre jana me shkollë të mesme profesionale, atëherë vëndoset në pikpytje adekuatshmëria e përkrahjes që ua japin nxënësëve me nevoja të veçanta arsimore në procesin e mësimit, me çka vërtetohet **hipoteza e shtatë e veçantë**:

,,Asistentët pedagogjik dhe personal nuk kanë kompetenca të ndara në përkrahjen që ua japin nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

1.6. 93 % e drejtorëve të shkollave janë të mendimit se çdo asistent pedagogjik duhet të punoj vetëm me një nxënës dhe 7% e tyre janë të mendimit se çdo asisten pedagogjik duhet të punoj me 2 nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Në raport me periudhën kohore të orës në të cilën asistenti pedagogjik punon me nxënësin me nevoja të veçanta, 84 % e drejtorëve të shkollave janë deklaruar se ajo është në vazhdimsi gjatë tërë orës, kurse vetëm 16% se asistenti pedagogjik inkuadrohet kohë pas kohe në varësisht nga nevoja.

Në raport me mënyrën në të cilën mësimdhënësi dhe asistenti pedagogjik punojnë gjatë orës, 54,3 % e drejtorëve të shkollave përgjigjen se mësimdhënësi punon me të gjithë nxënësit, kurse asistenti pedagogjik përfshihet me përkrahje të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në bazë të planit të përcaktuar për realizimin e orës që paraprakisht e kanë bërë së bashku; 28,3 % janë përgjigjur se mësimdhënësi punon me të gjithë nxënësit (duke e kyçur edhe nxënësin me nevoja të veçanta arsimore), kurse asistenti pedagogjik përfshihet kohë pas kohe dhe i ndihmon nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe 8% e drejtorëve u përgjigjën se asistenti pedagogjik punon me nxënësin me nevoja të veçanta, kurse mësimdhënësi paralelishtë punon me nxënësit tjerë, pa asnjë marrëveshje paraprake për mënyrën në të cilën do të zhvillohet mësimi.

Në raport me atë se cili profil është më adekuat për punën si asistent pedagogjik,

34 % e drejtorëve të shkollave janë deklaruar se profili më adekuat është defektologu; 21,4 % mendojnë se është pedagogu; 20,2% janë të mendimit se profil më adekuat është psikologu; 17,6 % janë përcaktuar për profilin e mësimdhënësit dhe vetëm 6,5 % e drejtorëve të shkollave mendojnë se më adekuat për asistent pedagogjik është prinid i nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Nga paraqitje tabelare mund të konstatohet se 41,8 % e drejtorëve të shkollave janë të qëndrimit për funkcionim më të mirë të ekipit shkollor inkluziv janë të nevojshme trajnime për kuadrin edukativo-arsimor; 18,7% mendojnë se është e nevojshme punësimi i defektologëve; 11,2 % e drejtorëve janë të qëndrimit se është i nevojshëm përforcimi i

bashkpunimit me pridërit; 8,8 % mendojnë se me mbledhje më të shpeshta, komunikim, bashkpunim dhe këmbim të informatave mund të kontribuohet për funksionim më të mirë të ekipit inkluziv të shkollës; 6% preferojnë sigurimin e instrumenteve adekuate për punë të ekipit; 5,2 % theksin e vendosin në rregullativën ligjore të punës së ekipit inkluziv shkollor dhe bashkëpunimin me institucionet kompetente dhe 3,2 % drejtorëve të shkollave mendojnë se për funksionim të mirë të ekipit inkluziv shkollor duhet të punësohen asistent.

Nga paraqitja tabelare mund të konstatohet se 49,3 % e drjtorëve të shkollave janë të qëndrimit se për realizim më të suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollat e tyre janë të nevojshme trajime për kuadrin edukativo-arsimor; 18 % mendojnë se është e nevojshme ekipimi i i ekipit shkollor inkluziv me bashkpuntor profesional (sidomos defektolog); 11,2 % e drejtorëve janë të qëndrimit se duhet të sigurohen mjete didaktike; 10,2 % mendojnë se bashkpunimi me prindërit mund të ndikojë në realizimin e suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollën e tyre; 5,4 % preferojnë regullimin me ligj të punës së ekipit inkluziv shkollor; 3,9 % theksin e vendosin në punësimin e asistentëve dhe 1,9 % e drejtorëve të shkollave mendojnë se për realizimin e suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollën e tyre është i nevojshëm bashkpunimi me institucionet kompetente.

Nga gjithsejt 739 mësimdhënës në pyetjen për rolin e tyre në përgatitjen e planit individual arsimor janë përgjigjur 679 arsimtarë, kurse 68 prej tyre nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Nga përmbajtja dhe kuptimi i përgjigjeve vërehet se mësimdhënësit përgjigjet e tyre i japin në drejtim të asaj me kë e përgatitin planin individual arsimor, në vend të rolit të vet në përgatitjen e planit individual arsimor .

Gjatë kësaj 13,4 % e arsimtarëve janë përgjigjur se nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore, kryesisht se nuk kanë marë pjesë në përpilimin e planit arsimor individual, 7,3 % janë përgjigjur se plotësisht dhe pavarsisht me rol kyç përpilojnë plan individual arsimor, 8,1 % janë deklaruar se planin individual arsimor e përgatisin në bashkpunim me defektologun, kurse 7,4% përgatitin planin individual arsimor në bashkëpunim me shërbimin profesional të shkollës (psikolog, pedagog, defektolog). Përqindje e vogël e mësimdhënësve 3,8 % janë përgjigjur se planin individual arsimor e përpilojnë në bashkpunim me ekipin shkollor inkluziv, 1,9 % përgatitin plan arsimor individual në bashkëpunim me aktivin e arsimtarëve dhe 1,4 % e mësimdhënësve në konsultim me prindin.

Vetëm 21,9 % e arsimtarëve kanë dhënë përgjigje adekuate në pyetje, kryesisht, e kuptojnë rolin e tyre në procesin e përpilimit të planit individual arsimor.

Përqindje e lartë e tyre- 25,6 % kanë dhënë përgjigje joadekuate në pyetjen. Nga analiza e përgjigjeve bëhet e qartë se mësimdhënësit nuk e kuptojnë esencën e planit arsimor

individual, si dhe rolin e tyre në përgatitjen e të njëjtit.

Nga gjithsej 739 mësimdhënës, 654 janë përgjigjur në pyetjen për rolin në ndekjen e realizimit të planit arsimor individual, kurse 85 mësimdhënës nuk janë deklaruar për këtë pyetje.

Nga përgjigjet vërehet se mësimdhënësit janë fokusuar në sqarimin e intervalit kohor të ndjekjes (si psh. ,,ndjek në nivel të orës" ose" çdo ditë ndjek") por jo edhe në mënyrat si atë e bëjnë.

Përqindje më e lartë (39,1 %) kanë të bëjnë me përgjigjet joadekuate që tregojnë se mësimdhënësit nuk e njohin mirë procesin e ndjekjes/monitorimit.

Shumë e vogël është përqindja e mësimdhënësve që kanë dhënë përgjijge konkrete, si psh.: Mbajtja e listave (çek dhe analitike); testet; detyrat e shtëpisë; shënimet e anegdotave; pyetje me gojë; aktivitete praktike, si dhe evaluimi dhe revizioni i PAI (vlerësim formativ dhe sumativ); mbledhje e dëshmive në portfolio; bërjen e raportit.

Nga mësimdhënësit janë marrë gjithsej 1561 përgjigje që kanë të bëjnë me përdorimin e diferencimit në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Nga rezultatet e fituara mund të konstatohet se mësimdhënësit aplikojnë diferencim në të gjitha segmentet e procesit arsimor, varësishtë nevojave, mundësive dhe llojit apo shkallës së pengesës ose vështirësisë me të cilat ballafaqohet nxënësi me nevoja të veçanta arsimore në procesin e mësimnxënies. Diferencimin e qëllimeve dhe rezultateve të pritura e bëjnë 2,2 % e mësimdhënësve, të përmbajtjes 1,4 %, të materialeve mësimore 0,6 %, të detyrave dhe pyetjeve 3,8 %, mjeteve të dukshme 1,4%, të testeve 1 %, të fletave mësimore 2 %, të kohës dhe hapsirës 0,4 %, të kritereve për vlerësim 0,6 %.

Nga format e diferencuara të punës përqindje më të madhe ose 11,9 % e mësimdhënësve janë deklaruar se e përdorin formën individuale ose formën e individualizuar të punës me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Aplikimin e punës në grupe të vogla e realizojnë 3,4 % e mësimdhënësve, kurse punën në çifte 2,9 % e mësimdhënësve.

Nga analiza e përmbajtjes së përgjigjeve mund të konstatohet se pjesë e madhe e arsimtarëve nuk bëjnë dallimin në mes qasjes individuale dhe të individualizuar në punën konkrete të mësimdhënësit dhe nxënësit.

Në raport me metodat mësimore, mësimdhënësit janë deklaruar se zbatimi i metodave të ndryshme të cilat janë drejtpërdrejtë të lidhuar me mundësit individuale, aftësit dhe nevojat e fëmijut me nevoja të veçanta arsimore. Me përqindje më të madhe ose 5,6 % është e përfaqësuar metoda ilustrative, kurse për nuancë më të vogël ose 55 % metodën demonstrative. Me 5,2 % është i përfaqësuar metoda e bisedës, kurse 4,5 % e mësimdhënësve

aplikojnë aktivitetet e lojës. Mësimdhënësit më së paku e aplikojnë metodën e klasifikimit 1 %, metodën e lëvdatës 0,5%, metodën e shprehejes me shkrim dhe metodën përshkruese me 0.6 % përfshirje, metodën e njohjes 0,4 % dhe muzikë 0,2 %. Mësimdhënësit në përqindje të vogël ose 0,3 %, aplikojnë edhe teknika adekuate në qasjen e punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Përqindje e lartë prej 8 % e përgjigjeve të mësimdhënësve nuk korrespondojnë me pyetjen e parashtruar për përdorimin e diferencimit në punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, që tregon se ata nuk e njohin mjaftueshëm dhe nuk e zbatojnë diferencimin në punën e drejtpërdrejtë me këta nxënës.

Në raport me adaptimin e kushteve, metodave dhe aktiviteteve të nevojave të nxënësëve me pengesa, që ata i praktikojnë në mësim, janë fituar gjithsej 764 përgjigje të mësimdhënësve. Nga përgjigjet e fituara vërehet se përqindje më e lartë e tyre ose 14,8 % nuk kanë punuar me nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Përqindje e lartë janë përqindje joadekuate (13,6 %), që tregon se mësimdhënësit jo mjaftueshëm ose në mënyrë jo adekuate i adaptojnë kushtet, metodat dhe aktivitetet në nevojat e nxënësëve me pengesa.

Përqindje e vogël, e mësimdhënësve 4% theksin e vendosin në vështirësit me të cilat ballafaqohen gjatë adaptimit të kushteve, metodave dhe aktiviteteve në nevojat e nxënësëve me pengesa.

Adaptimi i aktiviteteve sipas mundësive dhe aftësive të nxënësëve me nevoja të veçanta arsimore aplikojnë 11 % e mësimdhënësve të anketuar, kurse sipas nevojave të nxënësëve me nevoja të veçanta arsimore adaptim bëjnë 9,8 % e mësimdhënësve të anketuar.

Nga përgjigjet e dhëna vërehet se mësimdhënësit nuk bëjnë dallim të qartë në mes metodave dhe formave të punës, si dhe midis aktiviteteve dhe mjeteve mbykqyrëse dhe materijaleve didaktike.

Nga gjithsej 739 mësimdhënës të grupit klasor dhe lëndor, vetëm 17 nuk kanë dhënë përgjigje për mënyrën se si i ndjekin të arriturat e nxënësëve me nevoja të veçanta arsimore, kurse 14.1 % janë përgjigjur se nuk kanë nxënës të tillë. Çek listat (shkallë të vlersimit, lista me pikë) dhe përgjijget me gojë dhe me shkrim praktikojnë 13,5 % e mësimdhënësve, kurse përmes informatave kthyese për të arriturat e nxënësëve me nevoja të veçanta arsimore i ndjekin 13,4% e mësimdhënësve. Testet e adaptuara për ndjekje të të arriturave, aplikojnë 10,7%, lista të individualizuara mësimore 5,5 %, sipas qëllimeve të zvogluara 5,3 %, përmes përcjelljes në çdo orë 5,1 %, përmes mbykqirjes së vizatimeve dhe punimeve të nxënësëve 4.7%, përmes protfolios së nxënësit 3,6 % dhe përmes vetë vlerësimit 3,4 % e mësimdhënësve e bëjnë përcjelljen e të arriturave të nxënësëve me nevoja të veçanta.

Nga e paraqitura mund të konkludohet se mënyra më e përfaqësuar e përcjelljes së rezultateve të nxënësëve me nevoja të

veçanta që mësimdhënësit i praktikojnë në mësim janë çek listat (shkalla e vlerësimit, lista me poena), përgjigje me gojë dhe me shkrim dhe përgjigje kthyese me gojë.

Në bazë të rezultateve të fituara që kanë të bëjnë me qëndrimet e arsimtarëve të grupit klasor dhe lëndor në raport me përpilimin e planit individual arsimor, aplikimin e diferencimit, adaptimin e kushteve, metodave dhe aktiviteteve në nevojat e nxënësit me pengesa dhe përcjelljen e të arriturave të tyre, analizën dhe interpretimin e tyre, mund të konstatohet se vërtetohet **hipoteza e pestë** e veçantë:

Mësimdhënësit në shkollat fillore në pjesë të madhe nuk janë të trajnuar për përgatitjen dhe përcjelljen e planit arsimor individual, aplikimin e diferencimit, adaptimin e kushteve, metodave dhe aktiviteteve në nevojat e nxënësëve me pengesa dhe përcjellja e të arriturave të tyre.

Nga gjithsej 739 mësimdhënës të grupit klasor dhe lëndor, një përqindje e madhe ose 1,1 % mendojnë se përkrahjen që e marrin për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore nga pedagogu është konsultativ, 15,7 % mendojnë se është adekuate, 9,5 % janë deklaruar për bisedën si lloj i përkrahjes, 6,4% marrin përkrahje në planifikimin e mësimit dhe 5,1 % se përkrahjen e pedagogut e marrin gjatë përpilimit të planit arsimor. Disa nga mësimdhënësit ose 10,7 % kanë pohuar se nuk kanë pedagog në shkollë, 8,1 % se nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta dhe 7,4 % se nuk marrin përkrahje nga pedagogu në punën me nxënësin me nevoja të veçanta.

Përqindje më të vogël e mësimdhënësve ose 4,7 % janë të qëndrimit se përkrahja që e marrin nga pedagogu është gjatë përpilimit të materialit didaktik, 3,6 % përmes vizitës në orë, 3,5 % u përgjigjën se pedagogu e merr nxënësin dhe në mënyrë individuale punon me të, 2,4 % janë deklaruar se përkrahjen që e marrin nga pedagogu është minimale dhe 1,6 % e mësimdhënësve janë të mendimit se përkrahjen që e marrin nga pedagogu në raport me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore është vetëm morale.

Nga gjithsej 739 mësimdhënës të grupit klasor dhe lëndor përqindje më e lartë ose 26,9 % mendojnë se përkrahjen që e marrin për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore nga psikologu është adekuate, 22,5 % mendojnë se është konsultative, 6,7 % janë të mendimit se përkrahjen nga psikologu e marrin gjatë përpilimit të planit arsimor individual dhe 6,6% janë deklaruar për përkrahjen emocionale të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Një pjesë e madhe ose 8,7 % e mësimdhënësve janë deklaruar se nuk kanë psikolog në shkollë, 8,1 % se nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe 6,7 % nuk e kanë përkrahjen e psikologut në punën me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore. Një përqindje më e vogël e mësimdhënësve ose 3,9 % konstatojnë se përkrahja të cilën e marrin nga psikologu është në trajnimet interne për përafrimin e tematikës, 3,6 % në procesin e socializimit të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, 3,2 % janë përgjigjur se psikologu iu ndihmon në procesin e testimit të nxënësve dhe 2,7% e mësimdhënësve janë

të mendimit se përkrahjen të cilën e marrin nga psikologu i përket ndjekjes së realizimit të qëllimeve të parashtruara. Pjesa dërmuese e tyre janë deklaruar se përkrahjen e marrin para orëve.

Prej gjithsej 739 mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor një përqindje më e madhe ose 35,8 % janë deklaruar se nuk kanë defektolog në shkollë. 16,2 % mendojnë se përkrahjen të cilën marrin për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore nga defektologu është në përpunimin dhe ndjekjen e planit arsimor individual, 9,1 % e mësimdhënësve janë deklaruar se përkrahjen që e marrin nga defektologu i përket karakterit konsultativ, 8,8 % e mësimdhënësve marrin përkrahjen nga defektologu në punën individuale me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore, ndërsa 8,5 % janë deklaruar se përkrahjen të cilën e marrin nga defektologu është përkatëse. 8,1 % e mësimdhënësve nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore. 7 % e mësimdhënësve bashkëpunim me defektologun në pjesën e përpunimit të materialit, 4,3 % në përshtatjen e nxënësve dhe 2 % e mësimdhënësve janë deklaruar se nuk kanë mbështetjen e defektologut në shkollë.

Pjesa më e madhe e mësimdhënësve janë deklaruar se përkrahjen e marrin para orëve të mësimit. Sa i përket llojit të trajnimeve të cilat i kanë ndjekur mësimdhënësit e mësimit klasor dhe lëndor gjatë tre viteve të kaluara, për përforcimin e kompetencave personale për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, gjithsej janë marrë 746 përgjigje.

Trajnimet e organizuara nga Byroja e zhvillimit të arsimit në bashkëpunim me Qendrën maqedonase për arsim qytetar dhe me përkrahjen e UNICEF-it, kanë ndjekur një përqindje e madhe e mësimdhënësve ose 18,6%. Ato janë të strukturuara në disa module: Moduli 1 „Vizioni, teoria dhe koncepti"; Moduli 2 „Puna e përbashkët për krijimin e shkollave inkluzive"; Moduli 3 „Mjediset që e ndihmojnë mësimnxënien e individualizuar"; Moduli 4 „Vlerësimi formativ te nxënësit me vështirësi në mësimnxënie"; Moduli 5 „Mësimi i diferencuar në klasat inkluzive"; dhe Moduli 6 „Përkrahja individuale e nxënësve me vështirësi në mësimnxënie". Shpërndarjet të cilat i kanë bërë mësimdhënësit (16,6 %) kanë të bëjnë pikërisht me përmbajtjet e këtyre moduleve.

Përqindje e madhe e mësimdhënësve 45,8 % janë përgjigjur se nuk kanë ndjekur trajnim gjatë tre viteve të fundit me çka vërtetohet hipoteza ndihmëse 3:

,,Një numër i madh i mësimdhënësve në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk kanë ndjekur trajnime për përforcimin e kompetencave personale për punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, përkatësisht nuk janë trajnuar sa duhet për përgatitjen dhe ndjekjen e planit arsimor individual, zbatimin e diferencimit në mësim, përshtatjen e kushteve, metodave dhe aktiviteteve me nevojat e nxënësve me pengesa dhe ndjekjen e arritjeve të tyre''.

Prej gjithsej 137 përgjigjeve të mësimdhënësve prej 90 shkollave fillore ku përfshihen asistentët personal (persona

të cilët nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmë dhe përkrahje të nxënësit me pengesa, 25,5 % janë jopërkatëse.

Përqindja më e madhe e mësimdhënësve (59,9 %) detyrat e punës të asistentit personal i identifikojnë me detyrat e punës të asistentit pedagogjik.

Vetëm një përqindje e vogël ose 14,6 % e mësimdhënësve janë përgjigjur se asistentët personal janë përfshirë në realizimin e obligimeve të përditshmërisë/përkrahjen e nxënësit në përmbushjen e nevojave fizike/personale, përkatësisht i vënë në dukje detyrat e punës të cilat përshtaten me profilin ,,asistent personal".

Prej gjithsej 107 përgjigjeve të mësimdhënësve prej 78 shkollave fillore në të cilat ka asistentë pedagogjik (persona që nuk janë të punësuar në shkollë) për ndihmë dhe përkrahje të nxënësit me pengesa, 29 % janë joadekuate.

Përqindja më e madhe e mësimdhënësve (30,8 %) janë përgjigjur se asistenti pedagogjik është i përfshirë në punën e drejtpërdrejtë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore gjatë orëve në përvetësimin e qëllimeve dhe përmbajtjeve mësimore.

Vetëm 4,7 % e mësimdhënësve janë përgjigjur se asistenti pedagogjik i ndihmon/i jep përkrahje mësimdhënësit, 3,7 % e mësimdhënësve janë përgjigjur se asistentët pedagogjik punojnë individualisht me nxënësin dhe kjo punë është kryesisht si trajtim rehabilitues, ndërsa 2,8 % kanë theksuar se asistenti pedagogjik realizon aktivitete të cilat janë në përbërje të asistentit personal.

Nga përgjigjet e 739 mësimdhënësve të mësimit klasor dhe lëndor, të cilët kanë të bëjnë me propozimet për një realizim më të suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollë, përqindja më e madhe ose 31,1 % janë përgjigjur se iu nevojiten trajnime/seminare përkatëse. Një pjesë e rëndësishme prej tyre 23,5 % konsiderojnë se për një realizim më të suksesshëm të arsimit inkluziv nevojitet përfshierja më e madhe e personave/bashkëpunëtorëve profesional, si dhe përfshirja e asistentëve personal dhe pedagogjik -13 %. Mësimdhënësit mendojnë se nuk janë të trajnuar aq sa duhet që të punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta. Propozojnë trajnime të detyrueshme për të gjithë mësimdhënësit, përfshirjen e defektologëve, angazhimin e asistentëve në mësim, të bëhet një kufizim rigoroz se cilët nxënës mund të ndjekin mësimin e rregullt, dhe cilët nxënës të udhëzohen në shkollat speciale.

Prej gjithsej 335 bashkëpunëtorëve profesional (pedagogë, psikologë dhe defektologë) të cilët iu janë përgjigjur pyetësorit, 141 ose 42,1 % janë pedagogë, 130 ose 38,8 % janë psikologë dhe 64 ose 19,1 % janë defektologë (edukatorë dhe rehabilitorë special). Pas kësaj vërehet se përfshirja e defektologëve në shkolla dyfish është më e vogël në krahasim me bashkëpunëtorët tjerë profesional

(pedagogë dhe psikologë). Përfshirja e tillë është e pritur sepse roli i defektologut si bashkëpunëtor profesional në shkollat e rregullta aktualizohet në dekadën e fundit me iniciativë në qasjet inkluzive me të cilat përballen shkollat ku janë të përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Pjesa më e madhe e bashkëpunëtorëve profesional - pedagogët 40,3 %, janë të mendimit se roli i tyre në përgatitjen e planit arsimor individual qëndron në parashtrimin, definimin ose shqyrtimin e qëllimeve në planin arsimor individual.

Për konsultime dhe dhënien e këshillave mësimdhënësve për përzgjedhjen e formave përkatëse, metodave, strategjive, detyrave, aktiviteteve dhe mjeteve për punë me nxënësit janë përcaktuar 23,5 % e pedagogëve, ndërsa 11,4 % mendojnë se roli i tyre në përgatitjen e planit arsimor individual është parësor në ndjekjen e planifikimeve ditore dhe përparimin e nxënësit, ndërsa 6,7 % janë përcaktuar për bashkëpunimin me prindin. 10,1 % pedagogë janë përgjigjur se nuk kanë përvojë në përgatitjen e planit arsimor individual dhe 8 % nuk iu janë përgjigjur kësaj pyetje.

Pjesa më e madhe e bashkëpunëtorëve profesional - psikologë, dmth., 27,4 % janë të mendimit se roli i tyre në përgatitjen e planit arsimor individual është në vlerësimin e zhvillimit socioemocional dhe kognitiv të nxënësve. Përkrahja e mësimdhënësve, përmes trajnimeve, përpilimeve të materialeve për atë se cilat metoda, forma, teknika dhe mjete t'i përdorin, janë përcaktuar 19,2 % e psikologëve, ndërsa 14,4 % mendojnë se roli i tyre në përgatitjen e planit arsimor individual është në definimin e qëllimeve dhe rezultateve të planit arsimor individual dhe përkrahja individuale e nxënësve. 6,8 % janë përcaktuar për përkrahjen e prindërve dhe krijimin e klimës së pranimit të nxënësve (tejkalimin e rrezistencës). 5,5 % e psikologëve janë përgjigjur se nuk kanë përvojë në përgatitjen e planit arsimor individual dhe një numër i njëjtë nuk iu janë përgjigjur pyetjes.

Karakteristike është përfshirja proporcionale e përgjigjeve të ndryshme të defektologëve të cilët kanë të bëjnë me rolin e tyre në përgatitjen e planit arsimor individual. Në fakt, me 17,4 % përfshihen përgjigjet: vlerësimi i mundësive të nxënësit; përshtatja e qëllimeve të programeve mësimore; përkrahja e mësimdhënësve në realizimin e planit arsimor individual; shqyrtimi i planit arsimor individual gjatë vitit dhe ndjekja e përparimit të nxënësve. 7,4 % e defektologëve janë të mendimit se roli i tyre në përgatitjen e planit arsimor individual është në bashkërenditje me ekipin inkluziv të shkollës dhe 5,7 % në ngritjen e iniciativës për përpilimin e planit arsimor individual.

Një numër i madh i bashkëpunëtorëve profesional – pedagogëve, dmth., 25 % janë të mendimit se roli i tyre në ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual është në ndjekjen e nxënësit gjatë orëve të mësimit.

Për takime konsultuese me mësimdhënësit/mbikëqyrje në planifikimet e tyre janë

përcaktuar 24,4 % e pedagogëve, ndërsa 15 % mendojnë se roli i tyre në ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual është në konsultim me defektologun/me ekipin inkluziv të shkollës, ndërsa 6,2 % janë përcaktuar për takimet me prindërit. 12,5 % e pedagogëve kanë dhënë përgjigje të padefinuara/vazhdimisht, për çdo ditë bëj ndjekjen, 9,4 % pedagogë janë përgjigjur se nuk kanë përvojë në ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual dhe 7,5 % nuk iu janë përgjigjur kësaj pyetje.

Një pjesë e madhe e bashkëpunëtorëve profesional- psikologë, dmth., 33,1 % janë të mendimit se roli i tyre në ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual është gjatë vizitave në orë/ mbikëqyrja e nxënësit. Për bisedat me mësimdhënësit/shqyrtimi i planeve arsimore individuale janë përcaktuar 28,6 % e psikologëve, ndërsa 11,3 % mendojnë se roli i tyre në ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual qëndron në punën individuale me nxënësin dhe bisedat me prindërit. 3,7 % e psikologëve janë deklaruar për analizën/ndjekjen e përparimit të nxënësit dhe 6 % e psikologëve janë përgjigjur se nuk kanë përvojë në ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual dhe po aq nuk iu janë përgjigjur kësaj pyetje.

Përqindja më e madhe e defektologëve, dmth., 30,3 % mendojnë se roli i tyre në ndjekjen e realizimit të planit arsimor individual është përmes vizitës së orëve/mbikëqyrjes së nxënësit. 28,8 % e defektologëve janë të mendimit se roli i tyre në ndjekjen e realizimit e planit arsimor individual është përmes konsultimeve/bashkëpunimit me mësimdhënësin/ndjekjen e raporteve sipas formularëve të përgatitur paraprakisht, 27,3 % në punën individuale me nxënësin dhe 13,6 % në bisedat me prindërit.

Konstatimi është se të gjithë bash-këpunëtorët profesional (pedagog, psikolog dhe defektolog) në përqindje më të madhe (26,3 % për pedagog, 29,1 % për psikolog dhe 33 % për defektolog) përkrahjen individuale ndaj nxënësve me nevoja të veçanta arsimore ua japin gjatë orës. Gjatë pushimit nxënësit me nevoja të veçanta arsimore përkrahjen më të madhe e marrin nga psikologu, gjatë orës, në aktivitetet jashtëmësimore dhe gjatë aktiviteteve të lira të nxnësve përkrahje më të madhe marrin nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nga pedagogu. Një pjesë e përgjigjeve që kanë të bëjnë në periudhën e dhënies së përkrahjes individuale të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nga bashkëpunëtori profesional (pedagog, psikolog dhe defektolog).

Pedagogu përkrahjen individuale ua jep nxënësve në atë mënyrë me të cilën iu jep udhëzime si të mësojnë, si të mbajnë vëmendjen, ndërsa gjatë orës iu ndihmon për të kuptuar kërkesat e dhëna nga mësimdhënësi, në zgjidhjen e detyrave dhe ngjashëm.

Psikologu punon në mënyrë adekuate me nxënësin në pjesën e përforcimit të motivimit dhe vetëbesimit të nxënësit, ndërtimit të imazhit pozitiv për veten dhe qëndrim pozitiv ndaj mjedisit shkollor, tejkalimin

e vështirësive emocionale, përkrahjes në përzgjedhjen dhe aplikimin e teknikave për mësim në përputhje me mundësitë e nxënësit.

Defektologu më së shumti punon në reduktimin psikomotorik, integrimin senzorik, zhvillimin e të folurit dhe shprehjes gojore, ndihë në socializimin e nxënësit gjatë orës në kuptimin e udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi, zgjidhja e testeve etj.

Konstatimi është se përqindja më e madhe është i pedagogëve, dmth., 29,6 %, edhe psikologët, dmth.,35,4 % gjatë orës e ndjekin nxënësin, por nuk përfshihen në ndihmën dhe përkrahjen e drejtpërdrejtë. Për dallim prej tyre një numër i madh i defektologëve -40 % janë deklaruar se gjatë orës punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë. Mënyra e tillë e përfshirjes është dukshëm më pak e pranishme te pedagogët - 16,5 % dhe te psikologët - 19,2 % se punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore, së bashku me mësimdhënësin në pjesën e orës ku nxënësit tjerë punojnë pavarësisht në detyrën e dhënë, janë deklaruar 27,6 % e pedagogëve, 20 % e psikologëve dhe 22,7 % e defektologëve.

Në qoftë se bëhet krahasimi ndërmjet pedagogut, psikologut dhe defektologut në lidhje me mendimin e deklaruar se ata nuk punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë orës, do të konstatohet se në përqindje më të madhe janë përfshirë psikologët - 20,8 %, pastaj pedagogët me 17,9 % dhe me përqindje më të vogël janë përfshirë defektologët ose 10,7 %, që është dy herë më pak krahasuar me pedagogun dhe psikologun.

Në bazë të analizës së bërë mund të konstatojmë se defektologët si bashkëpunëtorë profesional janë të përfshirë në punën e drejtpërdrejtë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë orës paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë, e që inicon dilemën shikuar nga aspekti i inkluzionit. Vallë qasja e këtillë e punës ku defektologu dhe mësimdhënësi punojnë paralelisht me nxënës të ndryshëm, përkatësisht mësimdhënësi me nxënësit me zhvillim tipik, ndërsa defektologu me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, paraqet inkluzion ose ndarjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore?

Konstatimi është se përqindja më e madhe e pedagogëve - 26 % dhe psikologët - 25,9 %, gjatë realizimit të aktiviteteve jashtëmësimore e ndjekin nxënësin, por nuk përfshihen në ndihmën dhe përkrahjen e drejtpërdrejtë. Për dallim prej tyre një numër i madh i defektologëve - 44,7 % janë deklaruar se gjatë aktiviteteve jashtëmësimore punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë. Mënyra e tillë e përfshirjes është dy herë më e vogël te pedagogët - 21,3 % dhe te psikologët - 25,2 %. Për mënyrën e përfshirjes në dhënien

e ndihmës dhe përkrahjes ndaj nxënësit me nevoja të veçanta arsimore së bashku me mësimdhënësin në pjesën e aktiviteteve jashtëmësimore kur nxënësit tjerë punojnë në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë, janë deklaruar 25,3 % e pedagogëve, 17,5 % e psikologëve dhe 19,7 % e defektologëve.

Në qoftë se bëhet krahasimi ndërmjet pedagogut, psikologut dhe defektologut në raport me mendimin e dhënë se nuk punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë aktiviteteve jashtëmësimore, do të konstatohet se në përqindje më të madhe janë përfshirë psikologët - 22,9 %, pastaj pedagogët me 19,3 % dhe me përqindje më të vogël përfshihen defektologët me 14,5 %.

Në bazë të analizës së bërë mund të konstatohet se defektologët si bashkëpunëtorë profesional janë më të përfshirë në punën e drejtpërdrejtë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë aktiviteteve jashtëmësimore. Ata më së shumti punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon aktivitetet jashtëmësimore me nxënësit tjerë dhe për dallim nga pedagogu dhe psikologu, defektologët në përqindje më të vogël janë deklaruar se vetëm e ndjekin nxënësin, por nuk përfshihen në ndihmën dhe përkrahjen e drejtpërdrejtë të nxënësit, e cila ka të bëjë me deklarimin e mendimit paraprak se: defektologët si bashkëpunëtorë profesional më shumë janë të përfshirë në punën e drejtpërdrejtë me nxënësit me nevoja të posaçme arsimore gjatë aktiviteteve jashtë mësimore.

Karakteristike për këtë paraqitje tabelare senjë numër i madh i defektologëve ose 50%, psikologëve - 43 % dhe pedagogët - 34,8 % janë deklaruar se nuk punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore gjatë mësimit shtues. Për qëndrimin, „punoj me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore, paralelisht me mësimdhënësin i cili realizon mësimin shtues me nxënësit tjerë" janë deklaruar 8,9% e pedagogëve, 9,3 % e psikologëve dhe dy herë më shumë - 20,8 % defektologët.

Në bazë të analizës së bërë mund të konstatohet se një numër i madh i defektologëve nuk punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore gjatë mësimit shtues**.** Ato më së shumti punojnë me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore me mësimdhënësin i cili realizon mësimin shtues me nxënësit tjerë.

Kjo gjendje del nga fakti që mësimi shtues planifikohet dhe realizohet për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të cilët kanë aftësi mbi mesataren (nxënësit e talentuar dhe me prirje, përfshirja e të cilëve arrinë 31,28 % nga gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore) dhe të cilët në përgjithësi i kanë realizuar qëllimet e planifikuara të programit mësimor për fushën adekuate, i kanë arritur rezultatet e pritura nga mësimi dhe për ata ky lloj i përkrahjes nga bashkëpunëtorët profesional është më pak i nevojshëm në krahasim me nxënësit me vështirësi në mësimnxënie përqindja e së cilës arrin 20,77 % dhe nxënësit me pengesa të cilët në përqindje përfshihen me 5,81 %

nga të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Në bazë të analizës së bërë dhe interpretimit të indikatorëve të marrë nga anketimi i bashkëpunëtorëve profesional (pedagogë, psikologë dhe defektologë) të shkollave fillore, në raport me rolin e tyre në përgatitjen dhe ndjekjen e planit arsimor individual dhe në dhënien e përkrahjes individuale të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore vërtetohet **hipoteza 9:**

„Përkrahja individuale të cilën nxënësit me nevoja të veçanta arsimore e marrin nga bashkëpunëtorët profesional (pedagogët, psikologët dhe defektologët) në të gjitha segmentet e procesit edukativo-arsimor (gjatë orës, pushimit, aktiviteteve jashtëmësimore, aktiviteteve të lira të nxënësit, mësimit plotësues) në mënyrë sasiore dallohet varësisht nga kompetencat e posaçme të bashkëpunëtorëve profesional".

Në raport me bashkëpunimin të cilin bashkëpunëtorët profesional e kanë me asistentët personal, vetëm 23 pedagogë janë përgjigjur se kanë pasur bashkëpunim me asistentin personal. Bashkëpunimi, kryesisht, ka të bëjë me konsultimet dhe shkëmbimin e përvojave për planifikimin dhe realizimin e qëllimeve mësimore. Vetëm 17 psikologë janë deklaruar se kanë pasur bashkëpunim me asistentë personal. Bashkëpunimi ka të bëjë me shkëmbimin e informataveqë kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve të natyrës socio-emocionale. Për bashkëpunimin e realizuar me asistentët personal janë deklaruar 18 defektologë. Në qoftë se asistentë janë prindërit, atëherë bashkëpunimi qëndron në shkëmbimine informatave për përparimin e fëmijës. Me asistentët tjerë personal defektologu luan rolin e mentorimit të punës së tyre, përkatësisht iu jep udhëzime si ta ndjekin planin arsimor individual të nxënësit.

Nga të gjitha mundësitë e ofruara, më shumë bashkëpunëtorë profesional (22,3% defektologë, 15,8 % pedagogë dhe 15,5% psikologë) janë deklaruar se ekziston bashkëpunim reciprok dhe përcjellja e informatave me asistentët pedagogjik. Bashkëpunëtorët profesional të cilët janë deklaruar se detyrat e punës iu përsëriten, më së shumti janë defektologët - 8,5 %, pedagogët - 1,8 % dhe 3,9 % psikologët. Dukuria e këtillë ka të bëjë me gjendjen aktuale me angazhimin e asistentëve personal dhe asistentëve pedagogjik në ndihmën dhe përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore pa standarde dhe kompetenca paraprakisht të definuara.

2. REKOMANDIMET DHE SUGJERIMET PËR IMPLEMENTIMIN E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI

Për një zhvillim më të shpejtë dhe të përgjithshëm të arsimit inkluziv nevojitet qasje gjithpërfshirëse e sistemit, sigurimi i resurseve për avancimin e arsimit inkluziv dhe ndryshimi i kulturës institucionale, politikës dhe përvojës nga institucionet kompetente.

Për këtë qëllim nevojitet:

➔ Analiza dhe revizioni i rregullativës së përgjithshme ligjore dhe politikave për arsimin inkluziv dhe harmonizimi i tyre me nenin 24 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Pengesa.

- Përgatitja e strategjisë për arsimin inkluziv në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

➔ Përkrahja në përmirësimin e rregullativës për inkluzion përmes përgatitjes të akteve ligjore dhe nënligjore pa barriera dhe përkufizime në bazë të llojit dhe shkallës së pengesës.

➔ Përgatitja e standardeve e arritjeve të nxënësve dhe realizimi i aktiviteteve për vlerësimin e arritjeve të nxënësve të cilët mësojnë sipas planit arsimor individual.

➔ Përkrahja ndaj të gjitha shkollave të bëhen inkluzive për pranimin e përgjithshëm e të gjithë nxënësve dhe sigurimin e burimeve të domosdoshme për realizimin e pandërprerë e të gjitha aktiviteteve edukative-arsimore, detyrave dhe qëllimeve.

- Kompletimi i ekipeve inkluzive në shkolla me bashkëpunëtorët profesional të nevojshëm (pedagog, psikolog dhe defektolog).
- Angazhimi i asistentëve pedagogjik për ndihmë plotësuese dhe përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në zëtërimin e përmbajtjeve mësimore dhe aftësimin e njohurive dhe shkathtësive.
- Përkrahja plotësuese e asistentëve personal.
- Përgatitja e kompetencave themelore profesionale dhe standardeve për profilin e asistentit pedagogjik dhe asistentit personal.
- Heqja e barrierave fizike në përputhje me nevojat e nxënësve me pengesa.
- Përshtatja dhe pajisja e nxënësve me mjetet ndihmëse dhe vizuale, të cilat janë në funksion te të gjithë nxënësit, kryesisht edhe të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

➔ Përkrahja e nxënësve për të fituar dituri, shkathtësi dhe kompetenca përmes njohjes së mundësive, afiniteteve, predispozicioneve, aftësive, kapaciteteve dhe pritjeve/rezultateve, si dhe respektimin e dallimeve, përkatësisht të gjithë nxënësit të ndjehen të vlerësuar, të përfshirë dhe të respektuar.

- Definimi i procedurave për përkrahjen e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.
- Kriteret dhe procedurat për përgatitjen e planit arsimor individual.

➔ Përkrahja e mësimdhënësve për zgjerimin dhe thellimin e njohurive të fituara dhe aftësive për arsimin inkluziv (të bëjnë përshtatje të domosdoshme

gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimit, bashkëpunimit, interaksionit etj.).

- Organizimi i trajnimeve dedikuese me përmbajtje inkluzive.
- Përpilimi i doracakëve të specializuar dhe tematik për punë me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

➔ Përkrahja e prindërve si participues të drejtpërdrejtë në procesin inkluziv të fëmijëve të tyre.

- Organizimi i trajnimeve të dedikuara për përkrahjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Përpilimi i doracakut për njohjen me të drejtat dhe shërbimet të cilat ofrohen në sistemin e mbrojtjes sociale, shëndetësore dhe arsimit.

➔ Përkrahja e bashkëpunimit ndërsektorial dhe ndërinstitucional në edukimin fid-bek dhe qarkullimi i informatave, ideve dhe zgjidhjeve në drejtim të zhvillimit të plotë të arsimit inkluziv.

- Operacionalizimi i bashkëpunimit i kopshteve parashkollore me shkollat fillore dhe të mesme, si dhe shkollave të mesme me tregun e punës, përmes ndërtimit të sistemit të rrjetëzimit, me intencë për ndjekjen e vazhdueshme të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe orientimi i tyre profesional.
- Përkrahje e vazhdueshme përmes të gjitha niveleve arsimore deri te efektizimi i plotë si persona të dobishëm të bashkësisë.

➔ Përforcimi i vetëdijes për rëndësinë dhe nevojën e avancimit të arsimit inkluziv përmes analizave, hulumtimeve, fushatave, debateve, diskutimeve në panele dhe formave tjera të afirmimit.

- Përgatitja e analizave për nevojat dhe sfidat e inicuara në procesin e arsimit inkluziv.
- Organizimi dhe realizimi i diskutimeve në panele për nevojat dhe sfidat e inicuara në procesin e arsimit inkluziv.
- Organizimi dhe realizimi i diskutimeve i debateve për nevojat dhe sfidat e inicuara në procesin e arsimit inkluziv.
- Organizimi dhe realizimi i diskutimeve të fushatave për përkrahjen e arsimit inkluziv.
- Planifikimi dhe realizimi i hulumtimeve shkencore për nevojat, sfidat dhe zhvillimin e arsimit inkluziv.

➔ Pasurimi i vazhdueshëm i burimeve: njerëzore, materiale dhe financiare në drejtim të zhvillimit dhe përforcimit të inkluzionit dhe përmbushja e sfidave dhe nevojat e veçanta e të gjithë nxënësve.

- Përforcimi i kapaciteteve me mësimdhënësit kompetent, bashkëpunëtorët profesional dhe edukatorët.
- Përforcimi i infrastrukturës, rrregullimi i brendshëm dhe pajisja e institucioneve arsimore.
- Përkrahja financiare e aktiviteteve të inkluzionit.

PJESA V

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Qeveria e RMV, Trupi nacional koordinues për të drejtat e barabarta me invaliditet në RMV: Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me invaliditet 2010-2018
2. Udhëzues për punën e ekipit inkluziv të shkollës, Byroja e zhvillimit të arsimit, 2017
3. Ligji i Byrosë së zhvillimit të arsimit, tekst i konsoliduar („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/2006; 142/2008; 148/2009,69/2013, 120/2013,148/2013,41/2014 dhe 30/2016)
4. Ligji për inspektimin e arsimit, tekst i konsoliduar („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " " nr. 52/2005, 81/2008, 148/2009, 57/2010, 51/2011, 24/2013, 137/2013, 164/2013, 41/2014, 33/2015,145/2015 dhe 30/2016)
5. Ligji për mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme, tekst i konsoliduar („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017)
6. Ligji për arsimin fillor, „ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015,145/2015, 30/2016,127/2016 и 67/2017, neni 51, paragrafi 2
7. Ligji për arsimin e mesëm, tekst i konsoliduar („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017)
8. Ligji për Akademinë e mësimdhënësve, „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/2015 dhe 192/2015
9. Ligji për Shërbimin pedagogjik, „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.18/2011 dhe 41/2014
10. Ligji për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm, „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/2008, 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012,24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015 dhe 217/2015
11. Ligji për standardin e nxënësit, „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/2005, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013 dhe 41/2014
12. Raporti nga hulumtimi i gjendjes së arsimit inkluziv në fillim të realizimit të programit, si pjesë e kornizës të Shkollës sipas përmasës së fëmijës, është përgatitur me përkrahjen teknike dhe financiare të UNICEF-it
13. Deklarata nga Salamanka, UNESKO, 1994
14. Indikatorët për cilësinë e punës së shkollave, Rregullore për kompetencat kryesore profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme sipas lëmive, „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/15
15. Jaçova Z., Samarxhiska-Panova L., Leshkovski I., Ivanovska M., Doracak për projektin „Inkluzioni i fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta në Republikën e Maqedonisë", Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2002
16. Konventa për të Dejtat e Fëmijës, 1989
17. Drejt arsimit inkluziv, Raporti nga hulumtimi i realizuar për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor të rregullt, Shkup, qershor 2016
18. Lameva B., Studimi për vlerësimin e përparimit: Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim, bazuar në standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim, Zyra e UNICEF-it, Shkup, 2014
19. Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë: 2005-2015/ [hartuar nga grupi nacional i ekspertëve, kryesues Tale Keramitçioski]. – Shkup, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, 2005
20. Strategjia nacionale për deinstitucializimin në sistemin e mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë (2008-2018)

21. Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me invaliditet (SHQYRTUAR) 2010-2018

22. Politikat arsimore për nxënësit nën rrezik edhe për ata me nevoja të veçanta në Evropën Verilindore, Organizimi për bashkëpunim ekonomikn dhe zhvillim (OECD) 2007, fq. 30,31,33

23. Kompetencat themelore profesionale dhe standardet për bashkëpunëtorët profesional, Qendra maqedonase për arsim qytetar, 2016

24. Rregullore për kompetencat themelore profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme, 2015

25. Strategjia për arsim 2018-2025, Ministria e Arsimit dhe Shkencës

26. Ubavka Butleska... etj., Doracak për ndjekjen e punës dhe planifikimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Qendra maqedonase për arsim qytetar, Shkup, 2016

27. Deklarata universale për të drejtat e njeriut („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 57/93)

28. Xhonston K., Miriç S., Lazarus Sh., Arsimi inkluziv në kuadër të shkollës sipas përmasës së fëmijës. Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2010

LINQET E SHFRYTËZUARA

http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf

http://www.unesco.org/education/pdf/11_93.pdf

http://www.unicef.org/magic/media/documents/CRC_macedonian_language_version.pdf

http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.PDF

http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf

http://www.univerzalna-deklaracija-za-pravata-na-covekot.pdf

http://bro.gov.mk/?q=mk/obrazovanie-za-deca-so-posebni-potrebi

http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/pravilnicidetska/programa_rano_ucenje_posebni.pdf

http://dpi.mon.gov.mk/images/pravilnici/IKRU-MAK.pdf

https://www.researchgate.net/publication/289912842_Special_Education_Today_in_Sweden

https://www.european-agency.org/country-information/sweden

https://www.perfar.eu/policy/education/sweden

http://www.enil.eu/wp-content/uploads/2012/07/Intellectual-Disability-in-Europe.pdf

https://www.swselpa.org/

https://www.spsm.se/om-oss/english/the-swedish-education-system/laws-and-rights-in-swedish-schools/special-needs-education-sne-in-sweden/

https://www.european-agency.org/country-information/sweden/teacher-education-for-inclusive-education

https://www.stralsakerhetsmyndigheten.se/contentassets/df6cef3740634d1aa45f5d1e9d2a3e70/201621-the-effect-of-a-glaciation-on-east-central-sweden-case-studies-on-present-glaciers-and-analyses-of-landform-data

https://www.skolverket.se/andra-sprak-other-languages/english-engelska

https://www.european-agency.org/country-information/uk-england/legislation-and-policy

https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2002/32/contents

https://www.teachers.org.uk/files/active/0/costs_of_inclus-pt1.pdf

https://educationendowmentfoundation.org.uk/projects-and-evaluation/projects/achievement-for-all/

https://www.gov.uk/early-years-foundation-stage

https://www.gov.uk/guidance/key-stage-1-assessments

https://www.gov.uk/government/organisations/ofsted

https://www.european-agency.org/country-information/italy

https://www.senato.it/documenti/repository/istituzione/costituzione_inglese.pdf

https://www.uni-frankfurt.de/53397339/Inclusion-Italy.pdf

https://www.researchgate.net/publication/279961505_Inclusive_education_in_Italy_description_and_reflections_on_full_inclusio

https://www.uni-frankfurt.de/53397339/Inclusion-Italy.pdf

https://www.researchgate.net/publication/267742875_WISC-IV_Intellectual_Profiles_in_Italian_Children_With_Specific_Learning_Disorder_and_Related_Impairments_in_Reading_Written_Expression_and_Mathematics

https://books.google.mk/books?id=zhsRDQAAQBAJ&pg=PA192&lpg=PA192&dq=presidential+decree+%2880/2013%29+in+Italy&source=bl&ots=-X_XEZ3VVR&sig=ACfU3U0vUD-E2nk2CuxQ0wc-Gnqo2fsStQ&hl=mk&sa=X&ved=2ahUKEwiE97aw6IPgAhUID0wKHRJJDl8Q6AEwAnoECAcQAQ#v=onepage&q=presidential%20decree%2-0%2880%2F2013%29%20in%20Italy&f=false.

https://www.european-agency.org/country-information/croatia

https://www.european-agency.org/country-information/croatia

http://www.skolskiportal.edu.me/Inkluzivno%20obrazovanje/Strategija%20inkluzivnog%20obrazovanja%202019-2025.pdf

http://www.zzs.gov.me/naslovna/inkluyivno/naslovna_inkluzivno_podrska_inkluzivnom_obrazovanj/

http://www.skolskiportal.edu.me/Pages/Inkluzivnoobrazovanje.aspx

https://www.unicef.org/serbia/inkluzivno-obrazovanje

http://gmr.uis.unesco.org/ViewTable.aspx

https://www.iserbia.rs/studentska/kakvo-je-stvarno-stanje-inkluzije-u-obrazovanju-4886

http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-24-06-34-40/zakoni

http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf

http://dpi.mon.gov.mk/index.php/regulations/pravilnici/119-2016-01-26-12-38-42http://www.mon.gov.mk/images/Osnovni_profesionalni_kompetencii_MON.pdf

PJESA VI
SHTOJCAT

Shtojca 1:

PYETËSOR PËR DREJTORIN E SHKOLLËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Sektori i hulumtimit në arsim

PYETËSOR PËR DREJTORIN E SHKOLLËN

Pyetësorin e plotëson drejtori në bashkëpunim me shërbimin profesional në shkollë.

Shkolla Fillore:_____

Komuna:_____

Qyteti:_____

I/e nderuar,

Byroja e zhvillimit të arsimit realizon hulumtim në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim që të shqyrtohet gjendja momentale në raport me arsimin inkluziv të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe të jepen rekomandime konkrete për përmirësimin e saj.

Të dhënat nga shkolla juaj do të shfrytëzohen kryesisht për qëllimet e këtij hulumtimi.

Ju falënderohemi për bashkëpunimin!

EKIPI INKLUZIV SHKOLLOR (EISH)

1. Cakto anëtarët e EISH duke rrethuar numrin përkatës:

1) Drejtori

2) Psikologu

3) Pedagogu

4) Defektologu

5) Mësimdhënës/ mësimdhënësit (gjithsej mësimdhënës): _____

6) Prind/prindët (gjithsej prindër) : _____

7) Tjetër, shkruaj cilët : _____

2. A ka pasur program pune të përpiluar për ekipin inkluziv të shkollës?

1) Po

2) Jo

3. A është përpiluar Plani aksional?

1) Po

2) Jo

PLANI ARSIMOR INDIVIDUAL (PAI)

4. Vallë EISH ka përpiluar procedurë dhe formular për përgatitjen e Planit arsimor individual (PAI)?

1) Po

2) Jo, arsyeto pse:

5. Vallë EISH ka përpiluar procedurë për ndjekjen (monitorimin) e përparimit/rezultateve të nxënësit që punon sipas Planit arsimor individual (PAI)?

1) Po

2) Jo, arsyeto pse:

6. Sa përqind e mësimdhënësve në mësimin klasor mund të përpilojnë PAI?

_____ %

7. Sa përqind e mësimdhënësve në mësimin lëndor mund të përpilojnë PAI?

_____ %

8. Sa përqind e mësimdhënësve në mësimin klasor mund të përdorin metodat e diferencimit?

_____ %

9. Sa përqind e mësimdhënësve në mësimin lëndor mund të përdorin metodat e diferencimit?

_____ %

10. PASQYRA E NUMRIT TË NXËNËSVE SIPAS GJUHËS MËSIMORE

Në bazë të gjuhës me të cilën realizohet mësimi në shkollë, Ju lutemi t'i shkruani të dhënat në vijim:

GJUHË MAQEDONASE	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Numri i nxënësve									
Numri i nxënësve romë									
Numri i nxënësve me vështirësi në mësim									
Numri i nxënësve romë me vështirësi në mësim									
Numri i nxënësve të talentuar dhe me prirje									
Numri i nxënësve romë të talentuar dhe me prirje									
Numri i nxënësve me pengesa (paaftësi)									
Numri i nxënësve me pengesa me udhëzim dhe mendim									
Numri i nxënësve romë me pengesa (paaftësi)									
Numri i nxënësve romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim									
Numri i nxënësve për të cilët përgatitet PAI									
Numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet PAI									

GJUHË SHQIPE	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Numri i nxënësve									
Numri i nxënësve romë									
Numri i nxënësve me vështirësi në mësim									
Numri i nxënësve romë me vështirësi në mësim									
Numri i nxënësve të talentuar dhe me prirje									
Numri i nxënësve romë të talentuar dhe me prirje									
Numri i nxënësve me pengesa									
Numri i nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim									
Numri i nxënësve romë me pengesa									
Numri i nxënësve romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim									
Numri i nxënësve për të cilët përgatitet PAI									
Numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet PAI									

GJUHË TJETËR: (shkruaj cila _____	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Numri i nxënësve									
Numri i nxënësve romë									
Numri i nxënësve me vështirësi në mësim									
Numri i nxënësve romë me vështirësi në mësim									
Numri i nxënësve të talentuar dhe me prirje									
Numri i nxënësve romë të talentuar dhe me prirje									
Numri i nxënësve me pengesa									
Numri i nxënësve me pengesa, me udhëzim dhe mendim									
Numri i nxënësve romë me pengesa									
Numri i nxënësve romë me pengesa, me udhëzim dhe mendim									
Numri i nxënësve për të cilët përgatitet PAI									
Numri i nxënësve romë për të cilët përgatitet PAI									

PERSONA PËR NDIHMË DHE PËRKRAHJE

11. Vallë për ndihmë dhe përkrahjen e nxënësit janë përfshirë asistentë personal (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë)?

1) Po

2) Jo

12. Nëse jeni përgjigjur me PO, Ju lutemi ta plotësoni tabelën në vijim:

Asistent personal	Vallë ka lidhje farefisnore me nxënësin? Nëse „Po" shkruaj cilën: nëna, babai, tutori, gjyshja, gjyshi, etj.	Çfarë profesioni ka asistenti personal?	Ka certifikatë nga trajnimi i ndjekur nga MASH? (Po ose Jo)	Kush e angazhoi asistentin personal? (MASH, (MPPS, komuna, familja, me vetëiniciativë, tjetër)	Kush e financoi punën e asistentit personal? (MASH, (MPPS, komuna, familja, me vetëiniciativë, tjetër)
Personi 1					
Personi 2					
Personi 3					
Personi 4					
Personi 5					
Personi 6					
Personi 7					

13. Shkruaj X në cilat aktivitete janë përfshirë asistentët personal (në bazë të radhitjes në tabelën e sipërme: Personi 1, Personi 2 etj.)

Asistent personal	I ndihmon nxënësit me NVA në kryerjen e detyrave gjatë orëve	I ndihmon nxënësit me NVA në kryerjen e detyrave në aktivitet jashtë mësimore	I ndihmon nxënësit me NVA në kryerjen e detyrave në mësimin shtues/plotësues	I ndihmon nxënësit me NVA në kryerjen e aktiviteteve ndenjas dhe fizike	I ndihmon nxënësit me NVA në mirëmbajtjen e higjienës personale	Në aktivitete tjera, shkruaj cilat:
Personi 1						
Personi 2						
Personi 3						
Personi 4						
Personi 5						
Personi 6						
Personi 7						

14. Vallë për ndihmë dhe përkrahjen e nxënësit janë përfshirë asistentët pedagogjik (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë?

1) Po

2) Jo

15. Nëse jeni përgjigjur me PO, Ju lutemi ta plotësoni tabelën në vijim:

Asistent pedagogjik	Shkalla e arsimit (i mesëm, i lartë, tjetër)	Profesioni i asistentit pedagogjik	Ka certifikatë nga trajnimi i ndjekur nga MASH (Po, Jo)	Kush e angazhoi asistentin pedagogjik? (MASH, komuna, familja, me vetëiniciativë, tjetër)	Kush e financon asistentin pedagogjik? (MASH, komuna, familja, tjetër)
Personi 1					
Personi 2					
Personi 3					
Personi 4					
Personi 5					
Personi 6					
Personi 7					

16. Shkruaj X në cilat aktivitete janë përfshirë asistentët pedagogjik (në bazë të radhitjes në tabelën e sipërme: Personi 1, Personi 2 etj.):

Asistenti pedagogjik	Merr pjesë në punët administrative-teknike në shkollë	Merr pjesë në punën e Ekipit inkluziv për nxënës	Bashkëpunon me mësimdhënësin në planifikimin dhe realizimin e mësimit, përgatitjen dhe monitorimin e PAI	Bashkëpunon me shërbimin profesional	I ndihmon nxënësit me NVA gjatë mësimit	Ndihmon në përfshirjen e nxënësit në aktivitetet e përbashkëta me nxënësit tjerë dhe në aktivitetet jashtë mësimore	I ndihmon nxënësit me NVA në tejkalimin e barrierave gjuhësore	Bashkëpunimi me prindërit/ tutorët e nxënësve me NVA	Bashkëpunimi me bashkësinë lokale
Personi 1									
Personi 2									
Personi 3									
Personi 4									
Personi 5									
Personi 6									
Personi 7									

17. Vallë asistenti pedagogjik njëkohësisht realizon edhe aktivitete të asistentit personal?

1) Po

2) Jo

18. Me sa nxënës me NVA punon njëkohësisht një asistent pedagogjik gjatë orës?

1) Me një nxënës me NVA.

2) Me dy nxënës me NVA.

3) Me të gjithë nxënësit me NVA në paralele, sa: _____

4) Nuk ka asistent pedagogjik në shkollë.

19. Në cilën periudhë kohore të orës asistenti pedagogjik punon me nxënësin me NVA?

1) Vazhdimisht gjatë gjithë orës.

2) Inkuadrohet përkohësisht varësisht nga nevoja.

20. Në çfarë mënyre mësimdhënësi dhe asistenti pedagogjik punojnë gjatë orës? (përzgjidhni vetëm një përgjigje)

1) Asistenti pedagogjik punon me nxënësin me NVA, ndërsa mësimdhënësi paralelisht punon me nxënësit tjerë, pa marrëveshje paraprake për mënyrën në të cilën do të realizohet mësimi.

2) Mësimdhënësi punon me të gjithë nxënësit (duke përfshirë edhe nxënësin me NVA), ndërsa asistenti pedagogjik përfshihet përkohësisht dhe i ndihmon nxënësit me NVA.

3) Mësimdhënësi punon me të gjithë nxënësit, ndërsa asistenti pedagogjik inkuadrohet me përkrahje të nxënësit me NVA në bazë të planit (marrëveshjes) paraprake për realizimin e orës që e kanë bërë bashkërisht.

21. Kush sipas Juve është profil përkatës për punë si asistent pedagogjik? (mund të caktoni më shumë përgjigje)

1) Pedagogu
2) Psikologu
3) Defektologu
4) Mësimdhënësi
5) Prindi
6) Tjerë

22. Çka duhet të përmirësohet në funksionimin e ekipit inkluziv të shkollës?

23. Cilat resurse janë të nevojshme për realizimin më të suksesshëm të arsimit inkluziv në shkollën tuaj?

Shtojca 2:

PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËSIN

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT\

Sektori i hulumtimit në arsim

PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËSIN

Shkolla fillore:_____

Komuna:_____

Qyteti_____

Të nderuar,

Byroja e zhvillimit të arsimit realizon hulumtim në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim që të shihet gjendja momentale sa i përket arsimit inkluziv të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe të jepen rekomandime konkrete për përmirësimin e saj.

Në pyetësor përfshihen pyetje të cilave duhet përgjigjur duke rrethuar, kryesisht duke dhënë komente, mendime dhe sugjerime. Informatat e marra do të shfrytëzohen kryesisht për qëllimet e këtij hulumtimi.

Ju falënderohemi për bashkëpunimin!

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Pyetësorin e plotëson:

1) Mësimdhënësi i grupit klasor

2) Mësimdhënësi i mësimit lëndor

1. **Shkalla e arsimit::**

1) arsimi sipëror

2) magjistër

3) doktor shkence

4) tjetër:_____

2. **Përvoja e punës:**

1) deri 10 vjet

2) deri 20 vjet

3) deri 30 vjet

1) mbi 30 vjet

3. **Gjinia:**

1) mashkullore

2) femrore

4. **Përshkruani rolin tuaj në përpilimin e planit arsimor individual (PAI):**

_____

_____

_____

5. **Përshkruani rolin tuaj në përcjelljen e realizimit të PAI:**

_____

_____

_____

6. Çfarë metoda të diferencimit përdorni në punën me nxënësit me NVA?

7. Si i përshtatni kushtet, metodat dhe aktivitetet e nevojave të nxënësve me pengesë?

8. Në cilën mënyrë i përcjellni të arriturat e nxënësve me NVA?

9. Çfarë lloji të përkrahjes merrni nga bashkëpunëtorët profesional në shkollë për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA)?

Bashkëpunëtori profesional	Lloji i përkrahjes:	Shënoni kur keni përkrahje (para orës, gjatë orës, pas orës)
1) Pedagogu		
2) Psikologu		
3) Defektologu		

10. Vallë në ndihmën dhe përkrahjen e nxënësit, janë të përfshirë asistentë personal, (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë)?

1) Po

2) Jo

11. Nëse u përgjigjët me PO, Ju lutemi të sqaroni rolin e asistentit individual në punën me nxënësin NVA:

12. Vallë në ndihmën dhe përkrahjen e nxënësit, janë të përfshirë asistentë pedagogjik (persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë)?

1) Po

2) Jo

13. Nëse u përgjigjët me PO, Ju lutemi të sqaroni rolin e asistentit pedagogjik në punën me nxënësin me NVA:

14. Si është bashkëpunimi Juaj me asistentin personal?

15. Si është bashkëpunimi Juaj me asistentin pedagogjik?

Shtojca 3:

PYETËSOR PËR PEDAGOGUN/PSIKOLOGUN/DEFEKTOLOGUN

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Sektori i hulumtimit në arsim

PYETËSOR PËR PEDAGOGUN/PSIKOLOGUN/DEFEKTOLOGUN

Shkolla fillore:_____

Komuna:_____

Qyteti_____

Të nderuar,

Byroja e zhvillimit të arsimit realizon hulumtim në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim që të shihet gjendja momentale në lidhje me arsimin inkluziv të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe të jepen rekomandime konkrete për përmirësimin e saj.

Në pyetësor përfshihen pyetje të cilave duhet përgjigjur duke rrethuar, kryesisht duke dhënë komente, mendime dhe sugjerime. Informatat e marra do të shfrytëzohen kryesisht për qëllimet e këtij hulumtimi.

Ju falënderohemi për bashkëpunimin!

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Pyetësorin e plotëson:

1) Pedagogu

1) Psikologu

1) Defektologu

1. Shkalla e arsimit:

3) arsimi sipëror

4) magjistër

5) doktor shkence

1) tjetër:_____

2. Përvoja e punës:

4) deri 10 vjet

5) deri 20 vjet

6) deri 30 vjet

7) mbi 30 vjet

3. Gjinia:

1) mashkullore

2) femrore

4. Kush merr pjesë në përpilimin e PAI të nxënësit? (mund të theksoni disa përgjigje)

1) Mësimdhënësi

2) Defektologu

3) Psikologu

4) Pedagogu

5) Prindi

1) Tjerë:_____

5. **Kush merr pjesë në përcjelljen e realizimit të PAI? (mund të theksoni disa përgjigje)**

1) Mësimdhënësi
2) Defektologu
3) Psikologu
4) Pedagogu
5) Prindi
1) Tjerë _____

6. **Përshkruani rolin Tuaj në përpilimin e PAI:**

_____

_____

_____

7. **Përshkruani rolin Tuaj në përcjelljen e realizimit të PAI:**

_____

_____

8. **Kur dhe si jepni përkrahje individuale nxënësit me NVA (mund të theksoni disa përgjigje)**

Periudha e dhënies së ndihmës dhe përkrahjes individuale të nxënësit	Ndihma individuale dhe përkrahja
1) Gjatë orës	
2) Gjatë pushimit	
3) Gjatë aktiviteteve jashtëmësimore	
4) Gjatë kohës së aktiviteteve të lira të nxënësve	
5) Gjatë mësimit plotësues	
6) Tjetër:	

9. Si inkuadroheni në ndihmën dhe përkrahjen e nxënësit me NVA gjatë orës?

1) Punoj me nxënësin me NVA paralel me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë.
2) Punoj me nxënësin me NVA bashkë me mësimdhënësin në pjesën e orës kur nxënësit tjerë punojnë në mënyrë të pavarur për detyrën e dhënë.
3) E përcjelli nxënësin por nuk përfshihem në ndihmën dhe përkrahjen indirekte të nxënësit.
4) Nuk punojë me nxënësin me NVA gjatë orës.

10. Si inkuadroheni në ndihmë dhe përkrahje të nxënësit me NVA gjatë kohës së aktiviteteve jashtëshkollore?

1. Punoj me nxënësin me NVA paralel me mësimdhënësin i cili realizon aktivitete jashtëmë-simore me nxënësit tjerë.
2. Punoj me nxënësin me NVA bashkë me mësimdhënësin kur nxënësit tjerë punojnë në mënyrë të pavarur.
3. E përcjelli nxënësin por nuk përfshihem në ndihmën indirekte dhe përkrahjen e nxënësit.
4. Nuk punojë me nxënësin me NVA gjatë orës së aktiviteteve jashtëmësimore.

11. Si inkuadroheni në ndihmë dhe përkrahjen e nxënësit me NVA gjatë mësimit plotësues?

1. Punoj me nxënësin me NVA paralel me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë.
2. Punoj me nxënësin me NVA bashkë me mësimdhënësin në pjesën e orës kur nxënësit tjerë punojnë në mënyrë të pavarur për detyrën e dhënë.
3. E përcjelli nxënësin por nuk përfshihem në ndihmën indirekte dhe përkrahjen e nxënësit.
4. Nuk punojë me nxënësin me NVA gjatë kohës së orës plotësuese.

12. Si inkuadroheni në ndihmë dhe përkrahjen e nxënësit me NVA gjatë kohës së mësimit shtues?

1. Punoj me nxënësin me NVA paralel me mësimdhënësin i cili realizon mësim me nxënësit tjerë.

2. Punoj me nxënësin me NVA bashkë me mësimdhënësin.

3. E përcjelli nxënësin por nuk përfshihem në ndihmën dhe përkrahjen indirekte të nxënësit.

3. Nuk punojë me nxënësit me NVA gjatë orës shtuese.

13. Çfarë bashkëpunimi keni me asistentët personal (përshkirmi)

_____

_____

_____

14. Si është bashkëpunimi Juaj me asistentin pedagogjik? (mund të theksoni më shumë përgjigje)

1) Detyrat e punës na përsëriten.

2) Realizojmë detyra dhe aktivitete të ndryshme me nxënësit me NVA.

3) Nuk kemi kompetenca të kufizuara qartë.

4) Punojmë së bashku sipas planit të aktiviteteve të përbashkëta paraprakisht.

5) Punojmë sipas planit të aktiviteteve të përpiluara paraprakisht.

6) Ekziston bashkëpunim i ndërsjellë dhe transfer i informatave.

7) Punojmë në lëmi të ndryshme të punës edukative arsimore.

8) Komenti plotësues:

RECENSION

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Raporti i ofruar paraqet një punim pionier të rëndësishëm që ofron një tekst bashkëkohor, origjinal, konciz me vlerë të veçantë aplikuese. Publikimi i këtij raporti mund të shërbejë si literaturë e dobishme për profesionistët dhe për personat me invaliditet. Përcaktimi i problemit, qasja analitike e autorëve dhe zotërimi korrekt i metodologjisë, punës i japin peshë të veçantë shkencore dhe vlerë praktike.

Punimi paraqet referencë të rëndësishme bazike për studime tjera të këtij lloji, duke e marrë parasyshë faktin që në teorinë dhe praktikën maqedonase të defektologjisë ekzistojnë një numër i vogël i punimeve që e realizojnë gjendjen e tërësishme aktuale të inkluzionit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ky raport e vërteton angazhimin e njerëzve profesional në mbështetjen e iniciativave dhe aktiviteteve të udhëzuara për mbrojtjen e personave me invaliditet, sigurimi i qasjes dhe shmangien e të gjitha llojeve të pengesave me qëllim të participimit të barabartë në shoqëri.

Mund të konstatojmë se raporti kontribuon në zbardhjen e problemeve aktuale dhe shumë komplekse në kuadër të arsimit inkluziv në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe njëkohësisht paraqet burim të rëndësishëm, stimulim dhe përkrahje të hulumtimeve tjera nga fusha e edukimit dhe rehabilitimit special.

Në bazë të mendimit të theksuar më lartë, me kënaqësi i propozoj botuesit ta lejojë publikimin e këtij raporti si botim i parë i dorëshkrimit të këtij lloji.

Recenzues:

Prof. dr. Zora Jaçova